

PËRCAKTUESIT E BILANCIT TREGTAR TË MAQEDONISË

Bekim Stafai

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Halit Xhafa

Numri i fjalëve: 53,369

Tiranë, Mars 2017

ABSTRAKT

Një bilanc tregtar i balancuar është indikator i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi dhe kuptim i faktorëve që ndikojnë në të, ndihmon që të formulojmë një politikë të përshtatshme për përmirësimin e tij.

Qëllimi i studimit është të gjurmojë faktorët përcaktues të bilancit tregtar të Maqedonisë në kontekstin makroekonomik. Synimi është të shmanget faktorët që ndikojnë në mënyrë statistkisht të rëndësishme në rritjen apo uljen defiçitit të bilancit tregtar të këtij vendi. Kjo analizë do të shërbej në përcaktimin e strategjive të përshtatshme gjatë hartimit të politikave fiskale dhe monetare të cilat do të sigurojnë rritje të qëndrueshme ekonomike.

Konceptimi i problemit është realizuar mbi themelet e teorive të fushës të të gjitha kohërave si edhe në bazë të studimit të literaturës së publikuar mbi faktorët determinues të bilancit tregtar të vendeve në zhvillim. Vendet në zhvillim karakterizohen, në më të shumtën e rasteve, me defiçite të larta dhe të qëndrueshme. Ndryshoret e përfshira në studim janë: kursi real efektiv i këmbimit, rritja e PBB-së reale të Maqedonisë, rritja e PBB-së së vendeve partnere tregtare, remitancat, transfertave private, investimeve të huaja direkte, konsumi familjar, defiçiti/sufiçiti buxhetor, konsumi qeveritar dhe inflacioni.

Analiza empirike është realizuar me seritë kohore të periudhës 2003-2015 të mbledhur në baza tremujore. Analiza e serive konsiston në dy mënyra: duke përdorur analizën përshkruese të treguesve dhe trendet grafike të tyre si edhe duke përdorur metodën ARDL (Autoregressive Distributed Lag) me qëllim matjen e lidhjes afatshkurtër dhe afatgjatë midis variablave makroekonomike. Në analizën empirike janë vlerësuar dy modele për shkak të problemit të multikolinearitetit. Këto modele janë: modeli që ka të përfshirë remitancat si matës të dërgesave zyrtare të emigrantëve dhe modeli që ka të përfshirë transfertat private në vend të remitancave.

Nga vlerësimi i modeleve rezultuan se faktorët statistkisht të rëndësishëm në bilancin tregtar të Maqedonisë janë: rritja ekonomie e vendeve partnere tregtare, remitancat/transfertat private, konsumi dhe shpenzimet qeveritare.

Rritja ekonomike e vendeve partnere ndikon në përmirësimin e bilancit tregtar. Remitancat ndikojnë në përmirësimin e bilancit tregtar, transfertat private ndikojnë fillimisht pozitivisht në bilancin tregtar dhe më pas negativisht, konsumi ndikon negativisht në bilancin tregtar si në periudhën bazë ashtu edhe në periudhën me një kohë vonesë. Defiçiti buxhetor ndikon negativisht në bilancin tregtar dhe shpenzimet qeveritare ndikojnë po kështu negativisht.

Analiza e lidhjes afatgjatë rezultoi se variablat statistikisht të rëndësishme në ndikimin ndaj bilancit tregtar janë: kursi real efektiv i këmbimit (ndikimi negativ në bilancin tregtar), rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare (ndikimi pozitiv në bilancin tregtar), remitancat (ndikimi pozitiv në bilancin tregtar), konsumi familjar (ndikimi negativ në bilancin tregtar) dhe shpenzimet qeveritare (ndikimi negativ në bilancin tregtar).

Fjalë kyçe: përcaktues, bilanci tregtar, Maqedoni, ARDL

ABSTRACT

A balanced trade balance is an important indicator for future economic development of a country. Understanding factors which influence it, contribute to develop the best policy to correct it in the long run and to facilitate development of domestic economy.

Purpose of this study is to explore factors that determine balance of trade in Macedonia in order to clarify factors which statistically impact increase and decrease of trade balance. This analysis will help to develop strategies of country development and implementation of corrective monetary and fiscal policy which will develop the country economy toward European Union.

The concept of the problem is derived from all the times most important and coherent theories in the field and based on a very long literature review about the determinants of trade balance in developed and developing countries. Developing countries are characterized mostly by long term and sustainable trade deficits. The variables taken in the consideration are: real effective interest rates, domestic GDP growth, trade partners GDP growth, remittances, private transfers, foreign direct investments, household consumption, budget deficit/surplus, governmental consumption and inflation.

Empirical analysis cover the period from Q1-2003 to Q4-2015. Analysis of data consist of two methods: descriptive presentation of indicators and linear graphs and also ARDL approach of measuring short term and long term relationship among variables. In the analysis of data are presented two models for obliterating the problem of multicollinearity in dataset: the first which includes remittances as regressor but not private transfers and the second one which includes private transfers but not remittances.

Empirical evaluation of model resulted in the following determinants of trade balance of Macedonia: GDP growth of trade partners, remittances/private transfers, consumption and government expenditures.

Trade partners GDP growth positively affect trade balance, remittances have a positive effect on trade balance, and private transfers which firstly has a positive impact on trade balance but a negative effect after one time period. Consumption has negative impact on trade deficit and so have government expenditures.

Long term relationship evaluation indicates that variables which were statistically significant were real effective exchange rate (negative impact on trade balance), economic growth of trade partners (positive impact on trade balance), remittances (positive impact on trade balance), household's consumption (negative impact on trade balance) and government expenditures (negative impact on trade balance).

Key words: determinants, trade balance, Macedonia, ARDL

DEDIKIM

Familjes sime...

FALENDERIME

Realizimi i këtij studimi kërkonte një impenjim të lartë në terma të kohës dhe cilësisë së saj. Koha është burim i kufizuar, më i çmueshëm, për këdo dhe për këtë dëshiroj të falënderoj të gjithë ato që konsideruan ndarjen e kohës së tyre për të dhënë sugjerime, vërejtje dhe ide konstruktive në pasurimin e kësaj teze disertacioni.

Konkretisht:

Së pari, falënderoj Prof.Dr Halit Xhafën për gatishmërinë, dashamirësinë dhe durimin e vazhdueshëm për sugjerime dhe vërejtje me qëllim të realizimit të disertacionit në mënyrë sa më efektive dhe efikente.

Së dyti, dëshiroj të falënderoj profesorët:

Së treti, një vend të rëndësishëm në këtë proces zë familja ime. Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe dashurinë tuaj në momente të mungesës së angazhimit në çështjet familjare.

Së fundmi, dëshiroj të falënderoj miqtë dhe shoqërinë të cilët më mbështesin dhe inkurajojnë në rrugën time akademike.

Lista e shkurtimeve

ARDL-Autoregressive Distributed Lag

PBB-Prodhimi i Brendshëm Bruto

ECM-Error Correction Model (Modeli i korrektimit të gabimit)

VECM-Vector Error Correction Model

EX/IM- Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet.

RPBB%-Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto të Maqedonisë e shprehur në %

RPBBPT%-Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto në %

REER- Kursi real efektiv i këmbimit

IDH %PBB- Investimet e huaja direkte si përqindje e PBB

REM%PBB-Remitancat e dërguara nga emigrantët si përqindje e PBB

TRPR%PBB -Transfertat Private si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

C% PBB-Konsumi familjar si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

D/SBUXHETOR%-PBB Defiçiti/Sufiçiti Buxhetor si % e Prodhimit të Brendshëm Bruto

G%PBB-Shpenzimet Qeveritare si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

INF-Normal e Inflacionit të Maqedonisë e matur me CPI

OBT-Organizata Botërore e Tregtisë

ADF-Augmented Dickey–Fuller test

BE- Bashkimi European

OECD-Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

QNT(ITC)-Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë

TPI-Indeksi i Performancës Tregtare

CEFTA-Central European Free Trade Agreement

Përmbajtja

ABSTRAKT	2
Lista e shkurtimeve	8
Lista e tabelave	11
Lista e figurave	11
Kapitulli 1: Hyrje	13
1.1 Motivimi.....	14
1.2 Qëllimi, pyetjet kërkimore dhe objektivat.....	14
1.3 Hipotezat e studimit	15
1.4 Metodologjia	16
1.5 Rëndësia e kërkimit	17
1.6 Organizimi i tezës.....	17
Kapitulli 2: Tregtia e jashtme, struktura e importeve dhe eksporteve të Maqedonisë.....	19
2.1 Tregtia e jashtme e Maqedonisë.....	20
2.1.1 Ecuria e bilancit tregtar.....	20
2.1.2 Volumi tregtar sipas rajoneve ekonomike	25
2.2 Struktura e eksporteve dhe importeve	27
2.2.1 Struktura e eksporteve	27
2.2.2 Struktura e importeve	30
2.3 Politikat tregtare të Maqedonisë dhe performanca e tregtisë së jashtme	33
2.3.1 Marrëveshjet tregtare	33
2.3.2 Performanca e tregtisë së jashtme	35
2.4 Përmbledhje.....	39
Kapitulli 3: Rishikimi i literaturës	40
3.1 Kuadri teorik i përcaktuesve të bilancit tregtar	40
3.1.1 Teoritë e tregtisë së jashtme	41
3.1.2 Teoritë mbi determinantët e bilancit tregtar	55
3.2 Studime empirike mbi determinantët e bilancit tregtar	63
3.3 Evidenca empirike mbi bilancin tregtar të Maqedonisë.....	71
3.3.1 Të ardhurat kombëtare, të ardhurat e vendeve partnere tregtare dhe kursi real i këmbimit.....	71
3.3.2 Teoria e kurbës J për ndikimin e kursit të këmbimit	73
3.3.3 Investimet e huaja direkte	76

3.3.4 Remitancat dhe transfertat private	79
3.3.5 Defiçitit buxhetor dhe shpenzimet qeveritare.....	83
3.3.6 Ndikimi i krizës financiare, masat fiskale dhe monetare.....	84
3.3.7 Politika fiskale dhe monetare si përgjigje pas krizës financiare.....	86
3.3.8 Defiçiti buxhetor dhe defiçiti tregtar (twin deficits) në rastin e Maqedonisë.....	88
3.4 Përmbledhje e rishikimit të literaturës	91
Kapitulli 4: Metodologjia e kërkimit, të dhënat dhe procedurat statistikore	93
4.1 Kuadri i kërkimit	93
4.2 Të dhënat e studimit	95
4.3 Procedura statistikore	99
4.4 Kufizime dhe sugjerime për studimet e mëvonshme	104
4.5 Përmbledhje e metodologjisë	105
Kapitulli 5: Analiza empirike.....	107
5.1 Analiza përshkuese e serive, paraqitja grafike dhe lidhja statistikore	107
5.2 Testimi i stacionaritetit.....	126
5.3 Prezantimi i modelit ARDL	130
5.3.1 Modeli ARDL duke përfshirë remitancat	130
5.3.2 Vlerësimi i modelit ARDL duke përfshirë transfertat private	138
5.4 Përmbledhje e gjetjeve empirike	145
Kapitulli 6: Konkluzione dhe rekomandime	147
Referencat	152
ANEKS	163

Lista e tabelave

Table 1: Norma e ndryshimit të eksporteve dhe importeve për vitet 2003-2015	22
Table 2: Volumi tregtar sipas rajoneve të marrveshjeve të tregtisë botërore	25
Table 3: Informacion mbi variablat e studimit	95
Table 4: Shenja e pritur e ndryshoreve	97
Table 5: Treguesit statistikor përshkrues të: EX/IM, REER, RPBB, RPPPT, IHD%PBB dhe REM%PBB	107
Table 6: Treguesit statistikor përshkrues të: TRPR% PBB, C%PBB, D/SBUXHTOR%PBB, G%PBB dhe INF.....	110
Table 7: Korrelacioni i Pearson midis variablave	122
Table 8: Përmbledhje e vlerësimit të koeficientëve, rëndësisë statistikore dhe shenjës së tyre ..	145

Lista e figurave

Figure 1: Bilanci tregtar si përqindje e PBB real të Maqedonisë	20
Figure 2: Eksportet dhe importet për periudhën 2003-2015	21
Figure 3: Mbulimi i importeve nga eksportet për periudhën 2003-2015.....	24
Figure 4: Paraqitja me anë të ngjyrave në hartën e botës e vendeve të cilët importojnë produktet që eksportohen nga Maqedonia	26
Figure 5: Struktura e eksporteve të vitit 2005.....	27
Figure 6: Struktura e eksporteve të vitit 2009.....	28
Figure 7: Struktura e eksporteve në 2015	29
Figure 8: Struktura e importeve të vitit 2005.....	30
Figure 9: Struktura e importeve të vitit 2009.....	31
Figure 10: Struktura e importeve të vitit 2015.....	32
Figure 11: Indeksi i performancës tregtare të Maqedonisë.....	36
Figure 12: Grafiku që pasqyron rritjen në kërkesë globale për produktet që eksportohen nga Maqedonia.....	37
Figure 13: Rritja e ofertës kombëtare dhe kërkesës ndërkombëtare për produktet e eksportuara nga Maqedonia.....	38
Figure 14: Diagrama e modelit të ekuilibrit të përgjithshëm.....	52
Figure 15: Grafiku i EX/IM dhe REER	112
Figure 16: Grafiku i EX/IM dhe RPBB%.....	113
Figure 17: Grafiku i EX/IM dhe RPBBPT%	114
Figure 18: Grafiku i EX/IM dhe IHD	115
Figure 19: Grafiku i EX/IM dhe REM.....	116
Figure 20: Grafiku i EX/IM dhe TRPR	117

Figure 21: Grafiku i EX/IM dhe C%PBB.....	118
Figure 22: Grafiku i EX/IM dhe D/S BUXHETOR%PBB	119
Figure 23: Grafiku i EX/IM dhe G%PBB.....	120
Figure 24: Grafiku i EX/IM dhe INF	121
Figure 25: Testi i rrënjës unitare në nivelin bazë me testin ADF	126
Figure 26: Testi i rrënjës unitare në nivelin bazë me testin Phillips Perron	127
Figure 27: Testet e diferencave të para me testin ADF	128
Figure 28: Testet e diferencave të para me testin Phillips Perron.....	129
Figure 29: Grafiku i vlerave aktuale, vlerave të vlerësuara dhe mbetjeve.....	133
Figure 30: Testi i normalitetit të mbetjeve të regresionit.....	136
Figure 31: Grafiku i vlerave aktuale, vlerave të vlerësuara dhe mbetjeve të regresionit.....	141
Figure 32: Grafiku i mbetjeve të regresionit.....	143

Kapitulli 1: Hyrje

Maqedonia ka pasur një defiçit tregtar të qëndrueshëm në kohë. Kuptimi i faktorëve determinues të këtij defiçiti është çështje me rëndësi sepse pikërisht këtu do të lind baza për ngritjen e politikave të përshtatshme për balancimin e bilancit tregtar të vendit dhe sigurimin e një qëndrueshmërie ekonomike në vitet e ardhshme.

Nëpërmjet kësaj teme synohet të investigohen përcaktuesit e bilancit tregtar të Maqedonisë me qëllim ngritjen e politikave korrektuese efektive.

Bilanci tregtar i Maqedonisë është karakterizuar me defiçite tregtare për një periudhë të gjatë kohe. Defiçiti tregtar ka pasur luhatje nga 19 % në 29 % të PBB-së së vendit përkatësisht në fillim të periudhës në shqyrtim dhe në vitin 2008. Pas viteve 2008 pjesa e defiçitit tregtar ka ardhur duke u ulur deri në nivelet 20%-25 % të PBB-së. Vlera absolute e defiçitit buxhetor ka arritur maksimumin e saj në vitin 2008 me 104,225 milion denar megjithëse ky defiçit ka ardhur duke u ulur në vitet e mëvonshme deri në vitin 2015 ku vlera absolute e tij është afërsisht 91,189 milion denar ose mesatarisht 25.11 % së PBB-së.

Efektet negative të defiçitit tregtar lidhen kryesisht me ndikimin e tij në llogarinë korrente si edhe në bilancin e pagesave. Efekte negative mund të priten edhe në sektorin real ku një bilanc tregtar i balancuar mund të sillte rritje më të shpejtë të ekonomisë.

Në këto kushte është e nevojshme investigimi i faktorëve të cilët ndikojnë në këto disbalanca në tregtinë e jashtme të vendit. Në literaturë argumentohet se shkaktarët kryesor të këtij defiçiti janë: kursi i këmbimit, të ardhurat e brendshme dhe të ardhurat e vendeve partnere, investimet e huaja direkte, oferta monetare, dërgesat e emigrantëve, defiçiti buxhetor, konsumi qeveritar, niveli i inflacionit, etj.

Megjithë pikëpamjet e ndryshme për pasojat dhe faktorët përcaktues të këtij bilanci, ajo për të cilët të gjithë bien dakord është rëndësia e studimit të këtyre faktorëve në mënyrë empirike dhe marrja e masave sa më shpejtë për të drejtuar vendin drejt një ekonomie të fortë dhe të qëndrueshme në rrugën drejt integritimit në Bashkimin Europian.

1.1 Motivimi

Trajtimi i faktorëve përcaktues të bilancit tregtar është çështje e trajtuar mjaft në literaturë, megjithëse studimet për Maqedoninë janë më të kufizuara. Pikërkisht ky fakt i jep rëndësi të veçantë këtij studimi sepse është një studim i plotë, duke marrë shumë faktorë në konsideratë dhe me një databazë më të gjerë.

Së dyti, duke analizuar në mënyrë më të thelluar determinantët e bilancit tregtar si edhe kapacitetin për të përballuar këtë defiçit, do të nxjerrim përfundime dhe rekomandime të vlefshme të cilat mund të merren në konsideratë për hartimin e politikave efektive dhe balancimin e bilancit tregtar.

Së treti, ky studim konsideron jo vetëm faktorët e brendshëm si ndryshoret makroekonomike të vendit por edhe faktorë të jashtëm si rritja e PBB-së së vendeve partnere tregtare.

Së katërti, metoda e përdorur për analizën e të dhënave është një metodë e vlerësimit dinamik të efekteve, duke vlerësuar efektet afatshkurtra dhe efektet në periudhën afatgjatë të treguesve të ndryshëm të marrë në studim kundrejt bilancit tregtar të vendit.

1.2 Qëllimi, pyetjet kërkimore dhe objektivat

Qëllimi i këtij studimi është: të analizojmë bilancin tregtar të Maqedonisë dhe strukturën e tij, të matim rëndësinë dhe masën e ndikimit në të, të faktorëve makroekonomikë: kursi real efektiv i këmbimit, rritja ekonomike e vendit, rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare, investimet e huaja direkte, shpenzimet qeveritare dhe defiçiti buxhetor, remitancat/transfertat private, konsumi familjar dhe inflacioni.

Matja e rëndësisë së këtyre faktorëve makroekonomikë, në kontekstin e tregtisë së jashtme të vendit, krijon kushte për përcaktimin e politikave dhe sugjerimeve të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë dhe përshpejtimin e konvergjit të ekonomisë drejt ekonomive të Bashkimit European.

Me qëllim të realizimit të këtij qëllimi janë ngritur këto pyetje kërkimore:

1. Si ka evoluar në kohë niveli i eksporteve, importeve dhe bilanci tregtar i Maqedonisë?
2. Si ka ndryshuar struktura e eksporteve dhe importeve dhe cilat janë vendet partnere tregtare më të rëndësishme të Maqedonisë?

3. Cilët nga faktorët makroekonomikë: kursi real efektiv i këmbimit, rritja e PBB-së reale e vendit, rritja e PBB-së reale e vendeve partnere tregtare, investimeve e huaja direkte, remitancat, transfertat private, konsumi familjar, defiçitit/sufiçitit buxhetor, shpenzimet qeveritare dhe inflacioni, ndikojnë në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën 2003-2015?

Objektivat e studimit:

1. Paraqitjen e bilancit tregtar të Maqedonisë në periudhën 2003-2015.
2. Paraqitjen e vlerave absolute të eksporteve dhe importeve në vitet 2003-2015 si edhe normat e ndryshimit të tyre në vite.
3. Paraqitjen dhe ekzaminimin e ndryshimit të strukturës së importeve dhe eksporteve në 2005, 2009 dhe 2015.
4. Vlerësimin e peshave relative të tregtisë së jashtme të Maqedonisë sipas rajoneve.
5. Vlerësimin e ndikimit të variablave: kursit real efektiv të këmbimit, rritjes së PBB-së reale të vendit, rritjes së PBB-së reale të vendeve partnere tregtare, investimeve të huaja direkte, remitancat, transfertave private, konsumi familjar, defiçitit/sufiçitit buxhetor, shpenzimeve qeveritare dhe inflacionit, në bilancin tregtar të Maqedonisë për periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë.

1.3 Hipotezat e studimit

Hipotezat e ngritura në këtë studim i referohen matjes së rëndësisë statistikore dhe masës së ndikimit në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë të faktorëve makroekonomikë në bilancin tregtar. Hipotezat e ngritura janë:

H₁: Ndikimi i kursit real efektiv i këmbimit në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₂: Ndikimi i rritjes ekonomike të Maqedonisë në bilancin tregtar në afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₃: Ndikimi i rritjes ekonomike të vendeve partnere tregtare të Maqedonisë në bilancin tregtar në afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₄: Ndikimi i investimeve të huaja direkte në bilancin tregtar në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₅: Ndikimi i remitancave/transfertave¹ private në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₆: Ndikimi i konsumit familjar në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₇: Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₈: Ndikimi i defiçitit buxhetor në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

H₉: Ndikimi i inflacionit në bilancin tregtar të Maqedonisë në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë është statistikisht i rëndësishëm.

Testimi i hipotezave të mësipërme paraqitet në seksionin e analizës së të dhënave ku janë paraqitur rezultatet empirike si edhe në diskutimet ku analizohet nga ana teorike shenja dhe masa e ndikimit të secilit faktor.

1.4 Metodologjia

Disertacioni është realizuar duke bërë një kombinim të analizave cilësore dhe sasiore në mënyrë të “integruar”. Punimi sjell një literaturë të gjerë teorike dhe empirike me fokus determinantët e bilancit tregtar si në vendet me sufiçit tregtar dhe atyre me defiçit tregtar. Më pas ai sjell një vështrim të literaturës specifike mbi Maqedoninë. Analiza përshkruese të treguesve janë paraqitur me qëllim prezantimin e problemit dhe masës së tij. Analiza empirike e modelit merr në vëmendje 10 faktorë markroekonomikë, të spikatur nga literatura me rol të rëndësishëm në bilancin tregtar. Të dhënat e marra në studim i përkasin periudhës 2003-2015, të gjitha në baza 3 mujore. Ato janë gjetur në burimet më të besueshme të të dhënave të shtetit maqedonas si: Instituti i Statistikave të Maqedonisë dhe Banka Kombëtare e Republikës Maqedonase. Të dhënat për Gjermaninë dhe Greqinë u morën nga databaza e OECD-së dhe për Serbinë nga Instituti i Statistikave të Serbisë.

¹ Kemi dy modele vlerësimi duke përfshirë në njërin remitancat dhe në tjetrin transfertat private për shkak të eliminimit të efektit të multikolinearitetit në model.

1.5 Rëndësia e kërkimit

Rëndësia e këtij studimi i referohet kryesisht faktit se ky studim ka një qasje më të plotë të konceptimit të problemit duke marrë në konsideratë shumë faktorë ekonomikë në një model empirik. Në këtë model vlerësohet rëndësia specifike e secilit faktor dhe rëndësia totale e modelit.

Një tjetër pikë e rëndësishme e studimit është fakti se studimi është i orientuar drejt nxjerrjes së rekomandimeve për hartimin e politikave efektive në zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbajtjen e qëndrueshmërisë në bilancin e pagesave.

Databaza e përdorur për realizimin e studimit përfshin 13 vjet, të dhënat janë marrë në baza 3-mujore me qëllim një analizë më të detajuar të treguesve për aplikimin e modelit dinamik ARDL. Përdorimi i këtij modeli është faktor pozitiv jo vetëm sepse mund të aplikohet si për seritë të cilat janë stacionare në nivel apo edhe në diferencën e parë por edhe sepse të lejon një vlerësim si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë midis ndryshoreve.

1.6 Organizimi i tezës

Në vijim të këtij kapitulli të parë, i cili na prezantoi me qëllimin e studimit, pyetjet kërkimore, objektivat dhe rëndësinë e këtij studimi, do të shikojmë pozicionin e Maqedonisë në tregtinë e jashtme. Konkretisht në këtë kapitull do të trajtohet së pari, prezantimi i bilancit tregtar ndaj PBB-së reale të vendit, niveli i eksporteve dhe importeve në vite, norma e mbulimit të importeve nga eksportet si edhe partnerët tregtarë të Maqedonisë. Së dyti, do të prezantohet edhe struktura e eksporteve dhe importeve në 3 momente të ndryshme kohore.

Në kapitullin e tretë do të kemi rishikimin e literaturës ku do të trajtojmë: së pari teoritë e tregtisë së jashtme. Së dyti, faktorët që ndikojnë në bilancin tregtar. Së treti, gjetjet e studiuesve të tjerë për faktorët ndikues të bilancit tregtar. Së katërti, evidenca mbi përcaktuesit e bilancit tregtar të Maqedonisë, teori dhe aplikime empirike.

Në kapitullin e katërt do të trajtohet metoda e përdorur për konceptimin e problemit dhe faktorëve që duhet të studiohen në këtë kontekst. Definicionet e ndryshoreve të marra në studim dhe burimet e të dhënave. Gjithashtu këtu janë përcaktuar edhe teknikat statistikore të cilat do të përdoren për të analizuar të dhënat.

Aplikimi i modelit ekonometrik do prezantohet në kapitullin e pestë së bashku me interpretimin e gjetjeve në kontekstin e zhvillimit të ekonomisë dhe situatës financiare të Maqedonisë. Në kapitullin e fundit do të prezantohen përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga studimi.

Kapitulli 2: Tregtia e jashtme, struktura e importeve dhe eksporteve të Maqedonisë

Përpara se të zhvillojmë analizën për determinuesit e bilancit tregtar të Maqedonisë do të bëjmë një prezantim të situatës së tregtisë së jashtme. Do të prezantohet performanca e deritanishme në tregues të deficitit tregtar kundrejt PBB-së, mjedisin e tregtisë së jashtme si edhe nivelin e eksporteve dhe importeve me qëllim njohjen me trendet dhe strukturën e tyre në vite.

Fillimisht do të pasqyrohet bilanci tregtar në raport të PBB-së reale të vendit, më pas do të prezantohet ecuria e eksporteve dhe importeve në periudhën 2003-2015 ku do të evidentohen luhatjet e këtyre dy serive dhe normat e ndryshimit të tyre në vite. Po këtu do të pasqyrohet edhe grafiku me normat e mbulimit të eksporteve nga importet në këtë periudhë kohore për të evidentuar masën e problematikës si edhe për shkak se do të jetë pikërisht ky tregues i cili do të shërbejë si matës i bilancit tregtar të Maqedonisë gjatë analizës empirike.

Në vijim të kapitullit, do të vëzhgohet në periudhat 2003, 2009 dhe 2015 struktura përbërëse e eksporteve dhe importeve. Kjo për të kuptuar cilat janë produktet që aktualisht vendi eksporton dhe për të parë nëse ka vend në pjesën e importeve për përmirësimin e balancës duke shfrytëzuar burimet e pa përdorura humane të vendit duke iu referuar normës së lartë të papunësisë por edhe kapitaleve të vendit. Prezantimi i strukturës do të realizohet në këto 3 periudha: së pari viti 2003 sepse është viti i parë i marrë në studim; së dyti, viti 2009 sepse është karakterizuar nga ulje drastike, më e madhja e viteve të studiuara si pasojë e krizës financiare, si edhe viti 2015 jo vetëm si viti më korrent, por edhe sepse kemi pasur ulje të eksporteve dhe importeve pavarësisht se raporti i mbulimit është rritur.

Më pas kapitulli prezanton një përmbledhje të pozicionit të Maqedonisë në tregtinë e jashtme ku përfshihet pjesëmarrja në organizatën botërore të tregtisë, marrëveshjet tregtare efektive që vendi ka lidhur me vendet e tjera, paraqitje e hartës së destinacioneve të eksporteve, indeksi i performancës tregtare si edhe analizë të tregjeve potenciale dhe produkteve me kapacitet rritës në këto tregje.


2.1 Tregtia e jashtme e Maqedonisë

Në vijim do të pasqyrohet ecuria e bilancit tregtar të Maqedonisë ndaj PBB-së reale, eksporteve, importeve dhe normave të ndryshimit të tyre për periudhën kohore 2003-2015 për të evidentuar trendin dhe luhatjet e tij në kohë.

2.1.1 Ecuria e bilancit tregtar

Në grafikun në vijim do të paraqitet ecuria e bilancit tregtar si % nga PBB-së reale për periudhën 2003 deri në 2015.


Figure 1: Bilanci tregtar si përqindje e PBB-së reale të Maqedonisë



Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Evidentojmë se defiçiti tregtar ka pasur luhatje në intervalin 18.9 % deri në të 29% të PBB-së reale. Vlerat më të ulta janë në vitin 2008 që përkon me krizën financiare dhe vlerat më të larta të tij përkojnë në vitin 2003 që është viti i parë i marrë në studim. Në 2015 vlera e defiçitit është ulur në 11.61 % të PBB-së në 3-mujorin e dytë të vitit por kemi pasur përsëri rritje në 3-mujorin e katërt në vlerat 21.5 %. Ky nivel është mjaftueshëm i lartë për t'u diskutuar me qëllim korrektimin e tij dhe sigurimin e një niveli rritje ekonomike më të lartë.

Niveli i eksporteve dhe importeve të Maqedonisë të vlerësuar në monedhën vendase denar paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Në boshtin horizontal paraqitet periudha kohore nga 2003 në 2015 ndërsa në boshtin vertikal vlerat në ml denar të eksporteve dhe importeve.

Figure 2: Eksportet dhe importet për periudhën 2003-2015

Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Një paraqitje e informacionit të prezantuar grafikisht më sipër, do ta gjeni në formë tabele në aneksin e këtij disertacioni për informacion më të hollësishëm mbi vlerat ekzakte të secilit vit.

Në grafik evidentohej qartazi nivelet e ulta të eksporteve dhe importeve në vitet e para 2003-2004 megjithëse trendi i përgjithshëm i tyre ka qenë në rritje deri në vitin 2008 ku evidentojmë një thyerje të tyre kryesisht në pjesën e eksporteve. Efektet e krizës u dalluan më vonë kryesisht kur në 2009 shohim se kemi të bëjmë me një ulje drastike të importeve dhe eksporteve. Viti 2010 vazhdon të jetë me nivele të ulta të eksporteve dhe importeve pavarësisht se kemi pasur një rritje të lehtë të tyre nga viti 2009. Viti 2011 është shoqëruar me rritje të eksporteve dhe importeve në vlerat më të larta të të gjitha kohërave deri në atë periudhë. Ndërsa në vijim kemi pasur ulje të lehtë të nivelit të eksporteve dhe importeve për të arritur përsëri pikën kulminante në vitin 2014. Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga zyra e statistikave të shtetit maqedonas kemi një ulje të nivelit të eksporteve dhe importeve për vitin 2015.

Për të kuptuar më mirë ndryshimet në secilën seri për këto vite ne do të shohim në vijim tabelën me normat e ndryshimeve të eksporteve dhe importeve. Kjo tabelë do të na ndihmojë të kuptojmë ndryshimet e serive dhe madhësinë e këtyre luhatjeve nga një vit në tjetrin.

Table 1: Norma e ndryshimit të eksporteve dhe importeve për vitet 2003-2015

	Norma e ndryshimit të eksporteve	Norma e ndryshimit të importeve
2004	0.226	0.271
2005	0.219	0.103
2006	0.183	0.161
2007	0.407	0.407
2008	0.174	0.303
2009	(0.321)	(0.263)
2010	0.237	0.079
2011	0.336	0.284
2012	(0.103)	(0.072)
2013	0.071	0.015
2014	0.155	0.103
2015	(0.096)	(0.123)

Burimi: llogaritjet e autorit, të dhënat: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Tabela e mësipërme evidenton normën e ndryshimit të eksporteve dhe importeve gjatë periudhës 2003-2015. Norma më e lartë e rritjes së eksporteve është evidentuar në vitin 2007 ku eksportet janë rritur me 40.7 % të vlerës së eksporteve të periudhës paraardhëse. Ndërsa norma më e ulët e rritjes së tyre ka ndodhur në vitin 2013 me vetëm 7.1 % të eksporteve të periudhës paraardhëse. Eksportet kanë njohur rënien më të madhe të tyre në vitin 2009 ku ato kanë rënë me 32.1 % të periudhës paraardhëse, kjo normalisht për shkak të krizës financiare të në të cilën u përballën vendet e zhvilluara si Shtetet e Bashkuara të Amerikës por edhe Bashkimi European. Eksportet e vendit kanë njohur rënie përsëri në vitin 2012 me 10.3 % dhe në vitin 2015 me 9.6 %.


Po kështu norma më e lartë e rritjes së importeve është evidentuar në vitin 2007 me një rritje prej 40.7 %, rritje kjo në magnitudë të njëjtë me rritjen e eksporteve. Norma më e ulët e rritjes së tyre ka ndodhur në vitin 2013 me një rritje 1.5 %. Viti 2013 është i njëjtë me normën më të ulët të rritjes së eksporteve por madhësia e ndryshimit është më e ulët për importet (7.1 % me 1.5 %), pra kemi një tkurrje më të madhe të kërkesës vendase ndaj produkteve të huaja sesa tkurrja e kërkesës së vendeve partnere tregtare ndaj produkteve vendase.

Norma më e lartë e uljes së importeve ka ndodhur në 2009 me 26.3 % vit i njëjtë me uljen më të lartë të eksporteve me 32.1 %. Efekti i krizës është ndjerë më shumë në uljen e eksporteve pra tkurrje më të madhe të kërkesës së vendeve partnere ndaj produkteve tona në krahasim me tkurrjen e kërkesës së brendshme ndaj produkteve të huaja. Importet kanë njohur rënie edhe në vitin 2012 me 7.2 % dhe 2015 me 12.3 %.

Në tërësi lëvizja e importeve në rritje dhe në ulje ka ndodhur paralelisht me atë të eksporteve duke na treguar se në fakt këto ndryshime vijnë për shkak të faktorëve makroekonomikë të vendit apo vendeve partnere dhe jo që lidhen me elementët e eksportit apo importit. Ky është evidentuar edhe nga Tosheva (2016), e cila specifikon se performanca e eksporteve të vendit është kryesisht e ndikuar nga kërkesa globale dhe çmimet e produkteve të huaja të cilat kanë dinamikë të paqëndrueshme në kohët e sotme.

Një tregues i bilancit tregtar i cili përdoret shpesh në literaturë është edhe raporti i eksporteve ndaj importeve dhe interpretohet si raporti i mbulimit të importeve nga eksportet. Në vijim do të paraqitet ky tregues për periudhën e marrë në studim.

Figure 3: Mbulimi i importeve nga eksportet për periudhën 2003-2015



Burimi: Autori, të dhënat: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Niveli më i ulët i përqindjes së mbulimit të importeve nga eksportet ka ndodhur në vitin 2009 me 53.39 % dhe niveli më i lartë i këtij mbulimi është arritur në 2015 me një mbulim 70.16 %. Në tërësi shohim nga grafiku se kemi një trend rritës të normës së mbulimit por me ritme shumë të ulta. Kanë kaluar 12 vjet dhe rritja e ka qenë afërsisht 10 % dhe sipas përlogaritjeve të bëra duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël (referuar ekuacionit të derivuar të paraqitur në grafik) shohim se do të kishim një mbulim të plotë të importeve nga eksportet në vitin 2065 nëse mbulimi do të realizohej me këto ritme.

Një defiçit i qëndrueshëm në bilancin tregtar ka një sërë pasojash negative dhe pozitive në ekonomi në varësi se cilën pjesë të ekonomisë financon ky defiçit (nëse ai përdoret për konsum apo investime), apo stadi i zhvillimit të ekonomisë së vendit, etj.

2.1.2 Volumi tregtar sipas rajoneve ekonomike

Në këtë seksion do të prezantohen vendet partnere, të grupuara në baza rajonale, me të cilët kryhen transaksionet tregtare si edhe pesha specifike e secilit prej këtyre rajoneve.

Table 2: Volumi tregtar sipas rajoneve të marrëveshjeve të tregtisë botërore

Rajoni ²	Volumi tregtar			%
	Eksporte Euro	Importe Euro	Total	
Bashkimi European	3,126,254,958	3,586,026,315	6,712,281,273	68%
Vendet e Ballkanit Perëndimor	509,140,815	569,504,319	1,078,645,134	11%
Vendet e Marrëveshjes ekonomike të Azisë Paqësore	134,485,896	407,130,626	541,616,522	6%
Bashkimi për Mesdheun	72,054,332	349,011,863	421,066,195	4%
Komonuelthi i vendeve të pavarura	43,615,771	193,904,472	237,520,243	2%
Vendet Afrikane, të Karaibeve dhe të Paqësorit	12,577,951	173,010,405	185,588,356	2%
Vendet e NAFTA-s	42,464,343	100,626,582	143,090,925	1%
Marrëveshja e tregtisë së lirë Europiane	39,609,872	52,585,750	92,195,622	1%
Vendet Aziatike të Industrializuara Rishtaz	40,936,935	48,838,843	89,775,778	1%
Vende të ndryshme jo të klasifikuara si më sipër	1,526,143	83,789,685	85,315,828	1%
Vendet e Marrëveshjes Jug-lindore Aziatike	3,001,063	79,437,970	82,439,033	1%
Vendet e Marrëveshjes së Azisë Jugore për Kooperimin Rajonal	13,566,053	55,043,741	68,609,794	1%
Tregu i Përbashkët i Amerikës Jugore	3,539,320	54,222,116	57,761,436	1%
Vendet e Organizatës së Eksportimit të Petroliumit	8,456,367	23,777,985	32,234,352	0%
Organizata për kooperim ekonomik dhe zhvillim (përjashtuar BE-në)	52	24,233	24,285	0%

Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Tabela e mësipërme paraqet informacion mbi nivelin e eksporteve dhe importeve për secilin rajon të botës si edhe totalin e hapjes tregtare të vendit. Informacioni është shprehur në euro si edhe është bërë renditja sipas peshës relative të secilit rajon.


Pjesa më e madhe e tregtisë së Maqedonisë kryhet me vendet e Bashkimit European me 68 % të totalit. Në vijim një peshë të rëndësishme zënë vendet e Ballkanit Perëndimor me 11 % të totalit të tregtisë dhe vendet Aziatike dhe ato të Paqësorit me 6 % të totalit. Me vendet e marrëveshjes

² Informacioni i paraqitur është klasifikuar sipas marrëveshjeve të tregtisë që vende e botës përfshihen. Për informacion më të saktë për pjesëmarrjen në secilin grup, mund të referoheni në institutin e statistikave të shtetit maqedonas, përkatësisht në seksionin e tregtisë së jashtme.

së bashkimit Mesdhetar kryet 4 % e tregtisë dhe vendet e tjera të botës më pak se 2 % të tregtisë. Ajo që konkludohet në këtë fakt është se për shkak të afërsisë fizike Maqedonia ka një hapje të madhe ndaj Bashkimit European duke e konsideruar këtë fakt pozitiv sepse një hapje më e madhe domethënë një proces konvergjent më i lehtë dhe më i shpejtë.

Më poshtë do të pasqyrohet harta e botës ku janë të specifikuara me ngjyra të ndryshme pjesa që kanë zënë në eksportet totale të Maqedonisë secili nga vendet.

Figure 4: Paraqitja me anë të ngjyrave në hartën e botës e vendeve të cilët importojnë produktet që eksportohen nga Maqedonia



Burimi: Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (2016)

Destinacionet që zënë pjesën më të madhe të eksporteve janë Gjermania, Serbia, Bullgaria, Italia dhe Greqia. Me ngjyrë lejla janë vendet me të cilat nuk ka të dhëna për eksportet. Këto janë tregje potenciale. Në uebsite të Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë ka aplikacione të cilat mund

të shërbejnë për vlerësimin e tregjeve në rritje dhe mund të përdoren nga kompanitë për të sugjeruar aktivitetin në këto tregje.


2.2 Struktura e eksporteve dhe importeve

Në këtë pjesë të kapitullit do të paraqitet struktura e eksporteve dhe importeve të Maqedonisë në 3 periudha kohore: viti 2005, viti 2009 dhe viti 2015. Të gjitha të dhënat janë marrë nga zyra e statistikave të shtetit maqedonas dhe janë të shprehura në euro.

2.2.1 Struktura e eksporteve

Për të kuptuar produktet që vendi eksporton më tepër dhe për të vëzhguar ndryshimin në strukturë të tyre do të paraqiten grafikë në formë byreku për secilin vit për kategoritë kryesore të eksporteve të publikuara nga zyra e statistikave shtetërore.

Figure 5: Struktura e eksporteve të vitit 2005



Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë, (2016)


Grupet më të rëndësishme të eksporteve janë: produkte të fabrikuar dhe artikuj të tjerë të fabrikuar.

Nga grafiku i shpërndarjes së strukturës së eksporteve shohim se grupi më i madhi eksporteve produktet e fabrikuara zënë 33 % të totalit të tyre. Këtu futen eksporti i hekurit dhe çelikut me pjesën më të madhe, mineralet e tjera jometalike, tekstilet, produktet e drurit apo të gomës.

Grupi i dytë për nga pjesa që zë në totalin e eksporteve të vitit 2005 është grupi i materialeve artikuj të tjerë të fabrikuar me 29 % të totalit të eksporteve. Në këtë grup bëjnë pjesë veshjet, këpucët, produktet shkencore dhe profesionale, aparatet fotografike, etj.

Grupet ushqimesh dhe kafshë të gjalla, pije dhe duhan, si edhe lëndë djegëse dhe lubrifikantë të cilët zënë përkatësisht 8 % të totalit të eksporteve të vitit. Makineritë dhe pajisjet e transportit zënë 6 % të totalit dhe grupi material të papërpunuara dhe të pangrënshme zë 3 % të totalit. Kategoritë e tjera zënë një peshë më të vogël se 1 % të totalit të eksporteve.

Figure 6: Struktura e eksporteve të vitit 2009




Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Në grafik dallohet se në eksportet e vitit 2009 grupi dominohen përsëri nga produktet e fabrikuara dhe artikuj të tjerë të fabrikuar.

Grupi produkte të fabrikua zë 29 % të totalit të eksporteve me një ulje me 4 pikë përqindje në krahasim me vitin 2005. Grupi artikuj të tjerë të fabrikuar zë 28 % të totalit nga 29 % që ka qenë në 2005. Pra, kemi një ulje të peshës relative me 1 pikë përqindje. Grupi ushqime dhe kafshë të gjalla është rritur me 2 pikë përqindje nga 8 % në 10 %. Grupi pije dhe duhan është ulur me 1 pikë përqindje ndërsa grupi lëndë djegëse nuk ka ndryshuar si përqindje e totalit të eksporteve. Po kështu ka ndodhur me grupin makineri dhe pajisje transporti, i cili ka mbetur i pandryshuar në 6 %. Grupi produkte kimike dhe të ngjashme është rritur me 1 pikë përqindje. Kemi pasur rritje të peshës së grupit material të pa përpunuara dhe të pangrënshme nga 3 % në 6 %.

Figure 7: Struktura e eksporteve në 2015



Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)


Nga grafiku i mësipërm shohim se struktura e eksporteve të vendit ka ndryshuar shumë nga viti 2009 në vitin 2015. Tashmë pjesa më e madhe e eksporteve bëhet në grupin makineri dhe pajisje transporti e ndjekur nga produktet kimike dhe të ngjashme. Klasifikimi produkte të fabrikua ka vazhduar të bjerë në peshë relative nga 29 % në 18 % duke reflektuar një kërkesë në ulje të

produkteve të kësaj kategorie nga vendet ku eksportohen. Po kështu kemi një rritje të peshës së klasifikimit makineri dhe pajisje transporti nga 6 në 25 % dhe rënie të pjesës së ushqimeve dhe kafshëve të gjalla nga 10 % në 7 % të totalit.

2.2.2 Struktura e importeve


Ky seksion do të trajtojë strukturën e importeve për të kuptuar se cilët artikuj importohen me qëllim kuptimin e destinancionit të tyre dhe nëse kemi ndryshim të peshës së grupeve në kohë.

Figure 8: Struktura e importeve të vitit 2005



Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Nga informacioni i prezantuar më sipër i strukturës së importeve shohim se pjesa më e madhe e importeve të vitit 2005 përbëhet nga produkte të fabrikuara me 29 % të totalit të tyre në këtë vit. Vendi i dytë zihet nga lëndët djegëse, lubrifikantët dhe të tjera me 19 %, ndërsa makineritë dhe pajisjet e transportit zënë 18 % të totalit të importeve. Ushqimet dhe kafshët e gjalla zënë 11 % të totalit të importeve ndërsa produktet kimike e të ngjashme 10 % të totalit të importeve.


Figure 9: Struktura e importeve të vitit 2009

Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Në vitin 2009 kemi një ndryshim të lehtë në strukturën e importeve. Tashmë “produktet e fabrikua” dhe “makineritë dhe pajisjet e transportit” ndajnë të njëjtat pesha përkatësisht 24 % secila. Pjesa e importit të lëndëve djegëse është ulur në 16 % por është rritur pjesa e “produkteve kimike dhe të ngjashme me to” në nivelin 11 % nga niveli 10 % nga viti 2005. Pjesa e ushqimeve dhe kafshë të gjalla nuk ka ndryshuar në këtë periudhë dhe as pjesa e pijeve dhe duhanit, por pjesa e materialeve të papërpunuara është rritur me 1 pikë përqindje.

Në tërësi ekonomia ka ulur importin e produkteve të fabrikua dhe lëndëve djegëse dhe ka rritur importin e makinerive dhe pajisjeve të transportit. Rritja e peshës së makinerive ndaj totalit të importit është një indicie se këto shpenzime janë kapitale dhe do të shërbejnë për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së vendit.

Figure 10: Struktura e importeve të vitit 2015



Burimi: Instituti i Statistikave të Maqedonisë (2016)

Në 2015 shohim se pjesa e produkteve të fabrikua ka filluar të rritet përsëri nga 24 % në 35 % ndërkohë pjesa e makinerive dhe pajisjeve të transportit është ulur nga 24 në 20 %. Është rritur importi i produkteve kimike si medikamentet, plastika, parfumet, etj. Është ulur po kështu pjesa e produkteve ushqime dhe kafshë të gjalla, produkte të papërpunuara, etj.

2.3 Politikat tregtare të Maqedonisë dhe performanca e tregtisë së jashtme

Në këtë pjesë të punimit pasqyrohen marrëveshjet tregtare që janë aktualisht në fuqi të Maqedonisë si edhe një vlerësim të performancës së tregtisë së jashtme të vendit.

2.3.1 Marrëveshjet tregtare

Maqedonia është bërë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë që prej 4 prillit të vitit 2003 (OBT, 2016). Maqedonia aplikon aktualisht 5 marrëveshje tregtare të cilat përfshijnë 40 partnerë tregtarë: 28 vende të Bashkimit European, 4 vende të EFTA-s (European Free Trade Area), Turqinë dhe Ukrainën.

Objekti kryesor i marrëveshjeve është të inkurajojnë rritjen e tregtisë midis vendeve, rritje të investimeve të huaja direkte dhe heqjen e tarifave dhe barrierave jotarifore në tregtinë e përbashkët me qëllim arritjen e transparencës së lartë në politikat tregtare.

Marrëveshjet tregtare aktuale që ka Maqedonia me vendet e tjera janë (CEFTA, 2016):

1) Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Europës Qendrore (CEFTA 2006)

Marrëveshja CEFTA 2006 është lidhur në 19 dhjetor 2006 në Bukuresht dhe ka hyrë në fuqi në 22 nëntor 2007. Vendet të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshje janë: Republika e Maqedonisë, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Moldavia, Mali i Zi dhe Kosova. Përpos liberalizimit të të mirave, CEFTA 2006 gjithashtu siguron rritjen e kooperimit midis vendeve anëtare në këto dimensione: tregtinë e shërbimeve, prokurimin publik, investimet dhe mbrojtjen e pronës intelektuale.

2) EFTA

EFTA është një marrëveshje e përbashkët midis Republikës së Maqedonisë dhe Konfederatës Zvicerane, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Islandës dhe Leichestenit e hartuar në 19 qershor 2000 në Zyrih. Në nëntor të 2001-shit marrëveshja është ratifikuar nga parlamenti maqedonas dhe ka hyrë në fuqi në maj të këtij viti. Marrëveshja tregtare ka një qasje asimetrike në tregtinë e mallrave industrial dhe produkteve ushqimore të agrikulturës në interes të Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë produktet industriale të vendit janë të lira, pa taksa apo tarifa të eksportohen në tregjet e vendeve anëtare të EFTA-s që kanë një treg prej 12 milion individë. Nga ana tjetër për rastin e produkteve të importit nga vendet anëtare të EFTA-s për

secilin nga vendet anëtare janë vendosur periudha tranzicioni: 4, 7 dhe 9 vjeçare. Në përfundim të këtyre periudhave, shkëmbimet do të realizohen pa taksa dhe tarifa midis vendeve.

3) Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës së Maqedonisë dhe Ukrainës

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës Maqedonase dhe Ukrainës është një kuadër ligjor i cili rregullon kooperimin dypalësh midis dy vendeve dhe aplikohet që prej 10 Shtatorit të vitit 2001.

4) Marrëveshja e tregtisë së lirë midis Republikës së Maqedonisë dhe Turqisë

Edhe kjo marrëveshje tregtare rregullon marrëdhëniet tregtare midis këtyre dy vendeve dhe është në fuqi që prej shtatorit të vitit 2000.

5) Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me vendet e komunitetit europian është një kuadër ligjor i cili rregullon marrëdhënien e Maqedonisë me Bashkimin Europian. Republika e Maqedonisë ka nënshkruar këtë marrëveshje në 9 prill të vitit 2001 në Luksenburg. Marrëveshja ka hyrë në fuqi në 1 prill të vitit 2004. Seksionet e marrëveshjes rregullojnë çështjet tregtare në favor të Republikës e Maqedonisë për pjesën e produkteve industrial dhe ato ushqimore të agrikulturës. Nëpërmjet kësaj marrëveshje produktet industrial maqedonase mund të eksportohen pa taksa dhe tarifa në vendet e Bashkimit Europian dhe produktet industriale të vendeve Europiane do të liberalizohen gradualisht në një periudhë prej 10 vjetësh. Pas 10 viteve proces stabilizimi produktet e të dy palëve do të shkëmbehen pa taksa dhe tarifa.

Të gjitha marrëveshjet e mësipërme reflektojnë përpjekjet e vendit për të përmirësuar pozicionin e tij në tregtinë e jashtme, hapjen e vendit me vendet partnere dhe nxitjen e konkurrencës për prodhuesit e brendshëm. Qasja e hapjes së tregtisë është konsideruar me avantazh për vendin kryesisht në terma të benefiteve që ai ka pasur. Konkretisht (Rocheska, 2006) ka paraqitur një sërë problematikash të vendit që do të çonin në përshpejtim të procesit si: reduktimi i tarifave, implementimi i sistemit të licencave, mbështetjen financiare të agrikulturës, implementimi i ligjeve të reja në kuadër të standardizimit dhe harmonizimit të ligjeve për prodhimet e agrikulturës. Megjithatë është konstatuar se indeksi i lartë i hapjes tregtare lidhet kryesisht me nivelin e lartë të importeve dhe jo atë të eksporteve si edhe faktin se Maqedonia ka nivele të ulta të implementimit të teknologjive moderne që do të bënin produktet konkurruese në treg.

Megjithëse masat e sipërpërmendura mund të mos adresojnë problemin kryesor, atë të nivelit të ulët të eksporteve ato janë të domosdoshme për strukturimin e ekonomisë.

Në një studim të kryer nga (Mano-Bakalinov, 2016) janë analizuar efektet e liberalizimit të tregtisë në rritjen ekonomike të Maqedonisë duke përdorur të dhënat e periudhës 1993-2014 me anë të metodës ARDL. Ka rezultuar se politikat që fokusojnë liberalizimin e tregtisë dhe hapjen tregtare kanë ndikim të madh në rritjen ekonomike si në periudhën afatshkurtër dhe në atë afatgjatë.

Megjithatë është me interes të vlerësohet në terma empirikë nëse lidhja e këtyre marrëveshjeve ka përmirësuar apo përkeqësuar pozicionin e vendit në terma të tregtisë së jashtme si edhe matjen e efektivitetit të secilës prej tyre.


2.3.2 Performanca e tregtisë së jashtme

Indeksi i performancës tregtare (TPI) është një tregues i dizenuar nga Organizata Ndërkombëtare e Tregtisë me qëllim kapjen e kompleksitetit dhe natyrës multidimensionale të tregtisë. Indeksi është krijuar duke përdorur databazën më të madhe të tregtisë së botës COMTRADE, e cila mbulon rreth 180 vende, më shumë se 95 % e tregtisë botërore dhe me mbi 5,000 produkte në raportuara duke përdorur sistemin e harmonizuar.

Për secilin vend dhe për secilin sektor, TPI-ja paraqet indikatorët e profilit të përgjithshëm të një vendi, pozicionin e një vendi si edhe dekompozimin e ndryshimit të pjesës që zë vendi në tregun botëror. TPI-ja konsiston në 22 matës sasior të performancës tregtare. Me qëllim referimin në vazhdimësi, këto tregues janë paraqitur në terma absolute të cilët të kombinuar shërbejnë për rankimin e vendeve të botës. I gjithë informacioni është grupuar në tre kategori kryesore si “profile i përgjithshëm”, “performanca aktuale” dhe “dekompozimi i ndryshimit të performancës tregtare”

Figure 11: Indeksi i performancës tregtare të Maqedonisë

Trade Performance Index of The former Yugoslav Republic of Macedonia



Burimi: Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (2016)


Grafiku i mësipërm paraqet indeksin korrent për vitin 2015 të Maqedonisë si edhe ndryshimin në pjesën që zë Maqedonia në tregun botëror nga viti 2011 e deri në vitin 2015.

Nga grafiku i mësipërm shohim se ndryshimi në indeksin e pjesës që zënë eksportet në tregtinë botërore është i favorshëm për grupet “ushqim i freskët”, ushqime të procesuara, prodhimet bazë të manifakturës si edhe veshjet, produktet e lëkurës dhe ato të drurit. Produktet që kanë pasur shumë pak ndryshim janë komponentët elektronikë dhe kimikatet.

Treguesi i indeksit korrent (current index) është vlerësues i performancës korrente të tregtisë së vendit. Ai është një mesatare e thjeshtë e vlerës së eksporteve neto, eksporteve për frymë, pjesës që zënë eksportet e vendit në tregun botëror, diversifikimin e produkteve, koncentrimin e produkteve, diversifikimin e tregjeve dhe koncentrimin e tregjeve Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë(2016). Produktet e rankuara më mirë për sa i përket indeksit korrent vendi është renditur më mirë në veshje, tekstilet, komponentë elektronikë, produktet bazë të manifakturës dhe më keq në kimikatet dhe pajisjet e transportit.

Në vijim do të pasqyrohet një tjetër hartë e cila pasqyron rritjen e kërkesës globale për produktet që eksportohen nga Maqedonia.

Figure 12: Grafiku që pasqyron rritjen në kërkesë globale për produktet që eksportohen nga Maqedonia



Burimi: Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë(2016)


Grafiku ka në boshtin horizontal rritjen vjetore të eksporteve maqedonase ndaj vendeve partnere për periudhën 2011-2015. Boshti vertikal pasqyron rritjen vjetore të importeve të vendeve partnere për periudhën 2011-2015. Ngjyra e verdhë nënkupton se për këtë periudhë kohore rritja e importeve të vendeve partnere nga bota është më e madhe se rritja e importit nga Maqedonia. Me ngjyrë blu indicohet fakti se rritja e eksporteve maqedonase ndaj vendit është më e lartë se rritja e importit të vendit nga vendet e tjera.

Vende sipër vijës së kuqe reflektojnë tregje dinamike ndërsa vendet poshtë saj janë tregje në rënie. Shohim se për vendet të cilët janë në rritje si Zvicra, Rumania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës rritja e importeve nga Maqedonia ka qenë më e lartë se rritja e importeve nga bota.

Grafiku i mësipërm na ndihmon të përcaktojmë tregjet në të cilat kemi pasur rritje të kërkesës dhe mund t'i shohim si tregje potenciale për të tregtinë e produkteve që eksportohen nga Maqedonia.

Në vijim pasqyrohet një analizë matricore e produkteve të vendit. Këtu kemi të vendosura në boshtin horizontal rritjen e pjesës së eksporteve botërore të Maqedonisë dhe në atë vertikal rritja e importeve botërore për vitet 2011-2015.

Figure 13: Rritja e ofertës kombëtare dhe kërkesës ndërkombëtare për produktet e eksportuara nga Maqedonia



Burimi: Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (2016)

Tabela tregon i ndan produktet në ato që performojnë mirë në pjesën e djathtë lartë: produkte fituese në tregje që rriten “winers in growing sectors” ku përfshihen produkte kimike, makineritë elektrike dhe pajisje të tjera.

Se dyti, në produkte që kanë vështirësi në arritjen e performancave të larta të eksportit “losers in growing sectors” ku përfshihen veshjet, artikuj të hekurit dhe çelikut. Majtas posht kemi grupin e tretë “losers in declining sectors” janë produktet që nuk përformojnë mirë në tregje rënëse siç janë hekuri dhe çeliku i papërpunuar.

Së fundmi, grafiku pasqyron djathtas poshtë produkte fituese në tregje rënëse “winners” in declining sectors”. Në këto sektor përfshihen produktet që kanë performuar mirë edhe pse ka pasur rënie të kërkesës botërore për to. Këto produkte janë produktet minerale, xeherorët dhe drurët e frashrit.

2.4 Përmbledhje

Në këtë kapitull u bë njohja me treguesit e tregtisë së jashtme dhe bilancit tregtar të Maqedonisë për të pasur një pamje të qartë të problematikës por edhe të metodave për evidentimin e avantazheve të vendit me qëllim rritjen e eksporteve.

Fillimisht u prezantua treguesi i bilancit tregtar kundrejt PBB-së në vitet e marra në studim për të kuptuar se si bilanci tregtar kishte për të vënë në dukje se si ka ndryshuar kjo përqindje në kohë. Së dyti, u evidentuan partnerët kryesor tregtar duke vlerësuar volumin e tyre në fundin e periudhës së marrë në studim i klasifikuar sipas marrëveshjeve tregtare për të vënë në dukje pozicionin strategjik dhe rëndësinë e hapjes së ekonomisë ndaj vendeve të tjera. Një vëmendje iu kushtua edhe nivelit të eksporteve dhe importeve dhe normës së ndryshimit të tyre si edhe raportit të mbulimit të importeve nga eksportet.

Më pas u trajtuan ndryshimet strukturore të eksporteve dhe importeve duke evidentuar në tre pika kohore të ndryshme pjesën që grupet kryesore zinin ndaj totalit. Qëllimi ishte jo vetëm të kuptonim se cilat produkte eksportonte dhe importonte vendi por edhe nëse kishim ndryshime në kohë të tyre të cilat u evidentuan kryesisht në grupet e eksporteve për të gjitha vitet, ndërsa për importet vetëm në vitin 2009.

Së fundmi, u bë prezantimi i marrëveshjeve tregtare që aplikohen në tregtinë e jashtme të Maqedonisë me vendet e tjera dhe hedhja e idesë nëse në fakt këto marrëveshje kanë përmirësuar apo përkeqësuar pozicionin tregtar të vendit me vendet e tjera dhe cila prej tyre ka dhënë kontributin më të lartë. Po në këtë kapitull u prezantua dhe indeksi i performancës tregtare të vendit relativisht me vendet e botës si edhe disa harta ku pasqyrohet potenciali i rritjes së eksporteve sipas produkteve dhe sipas tregjeve.

Kapitulli 3: Rishikimi i literaturës

Në këtë pjesë të studimit paraqitet literatura e konsultuar për analizën e përcaktuesve të bilancit tregtar. Është filluar duke prezantuar teoritë kryesore të tregtisë ndërkombëtare në mënyrë të përmbledhur për të dhënë një pamje të përgjithshme të zhvillimit të tregtisë botërore në periudha të ndryshme kohore dhe si ka ndryshuar konceptimi i tregtisë në kohë. Në vijim janë pasqyruar teoritë kryesore të faktorëve që shpjegojnë bilancin tregtar. Në seksionin e tretë pasqyrohen studimet të cilat janë realizuar në vendet e ndryshme të botës në kuadër të analizë së faktorëve të ndryshëm në bilancin tregtar. Në seksionin e katërt janë prezantuar studime që janë realizuar më përcaktuesit e bilancit tregtar të Maqedonisë dhe efektet e treguesve të ndryshëm në stabilitetin makroekonomik dhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

3.1 Kuadri teorik i përcaktuesve të bilancit tregtar

Në botën moderne të epokës së globalizimit, të gjithë ekonomitë e vendeve të botës janë të ndërruar nga njëra – tjetra përsa i përket marrëdhënieve tregtare dhe shkëmbimit të mallrave. Rëndësia e tregtisë ndërkombëtare është shprehur që në shekullin e XVI-të në teorinë merkantiliste.

Politikat makroekonomike të një vendi ndikojnë në marrëdhëniet tregtare të tij si dhe si rrjedhojë dhe në bilancin tregtar. Bilanci tregtar është diferenca midis vlerës monetare të eksporteve dhe importeve në një ekonomi gjatë një periudhe të caktuar kohe apo thjesht diferenca midis mallrave që një vend prodhon dhe mallrave që ai blen nga jashtë. Bilanci tregtar mund të jetë pozitiv, negativ ose i balancuar.

Me qëllim pasjen e një bilanci tregtar të balancuar, është e rëndësishme që të studiohen faktorët apo determinantët që ndikojnë në të si dhe madhësia dhe drejtimi i ndikimit të secilit. Disa nga determinantët më kryesor që ndikojnë në bilancin tregtar të një vendi janë të ardhurat, konsumi i brendshëm, kursi i këmbimit, oferta e parasë, zhvlerësimi, norma e inflacionit, investimet e huaja direkte, shpenzimet qeveritare si dhe të ardhurat e vendeve partnere tregtare ku eksportohet.

Në pjesën e mëposhtme të literaturës do të shikojmë në mënyrë më të detajuar teoritë e tregtisë ndërkombëtare si dhe studime empirike të realizuara në vende të ndryshme të botës në lidhje me determinantët e bilancit tregtar për të parë drejtimin dhe madhësinë e ndikimit të tyre.

3.1.1 Teoritë e tregtisë së jashtme

Në tregtinë ndërkombëtare dallohen 4 klasifikime të mëdha të teorive: A. Merkantilizmi, B. Teoritë klasike të tregtisë, C. Teoritë moderne të tregtisë dhe D. Teoritë e reja të tregtisë.

Teoria e parë në këtë fushë është merkantilizmi sipas të cilit sa më i lartë sufiçiti tregtar aq më e zhvilluar është ekonomia e vendit (Klug, 2006). Nëse eksportet janë më të larta se importet vendi do të bëhet ekonomikisht më i fortë si pasojë e akumulimit të arit dhe argjendit.

Një nga kritikët e parë të merkantilizmit ishte David Hume me teorinë e tij të çmimit të metaleve të çmuara. Sipas Hume, grumbullimi i arit dhe argjendit për një kohë të gjatë do të shkaktojë inflacionin në vend dhe rritje të përgjithshme të çmimeve dhe vendi do të shkojë drejt një ekuilibri në bilancin tregtar (Gandolfo, 1998). Një kritik tjetër i merkantilizmit ishte dhe Adam Smith i cili nëpërmjet teorisë së avantazhit absolut shprehu mendimin se tregtia ndërkombëtare nuk është një lojë me shumën zero dhe se ideja e mbështetjes në eksporte është joproduktive. Sipas Smith çdo vend duhet të specializohet vetëm në prodhimin e atyre produkteve që mund t'i prodhojë me pak burime (Dixit & Norman, 1980). Bazuar në teorinë e avantazhit absolut të Smith, David Ricardo zhvilloi teorinë e avantazhit krahasues i cili e vë theksin në avantazhin krahasues të një vendi lidhur me prodhimin e një produkti krahasuar me vendin tjetër me të cilin zhvillon tregti (Zhang, 2008).

A. Merkantilizmi

I zhvilluar në shekullin e XVI-ë, merkantilizmi është një nga përpjekjet më të hershme për të zhvilluar një teori ekonomike (Rivera-Batiz & Olivia, 2003). Kjo teori deklaroi se pasuria e një vendi përcaktohet nga sasia e zotërimit të arit dhe argjendit që ai ka. Merkantilistët besonin se një vend duhet të rrisë zotërimin e arit dhe argjendit, duke nxitur eksportet dhe dekurajuar importet (Magnusson L., 2002).

Nga shekulli XVI deri në shekullin XVIII, merkantilizmi ishte politika e Fuqive të Mëdha të Evropës pasi ata zgjeruan perandoritë e tyre dhe ishte korniza universale me të cilën ishte kuptuar tregtia ndërkombëtare. Merkantilizmi fokusohet në maksimizimin e eksporteve në mënyrë që të sjellë “metale të çmuara” në vend. Akumulimi i arit dhe argjendit lidhej drejtpërdrejt me fuqinë e tij dhe pasurinë e vendit. Tregtia në merkantilizëm ishte një lojë me shumën zero, me fitues të cilët fitojnë vetëm në kurriz të humbësve (Langdana & Murphy, 2014).

Që në kohën e Adam Smithit, Merkantilizmi ka qenë një çështje e debatuar ashpër. I dënua në fund të shekullit të XVIII si një sistem “fallco” i mendimit ekonomik dhe praktikave politike, është rikthyer në mënyrë paradoksale lidhur me çështje të tilla si krijimi i rritjes ekonomike në vendet në zhvillim (Magnusson L. , 2015).

Edhe pse merkantilizmi është një nga teoritë më të vjetra tregtare, ai mbetet pjesë e të menduarit modern. Vende të tilla si Japonia, Kina, Singapori, Tajvani dhe madje edhe Gjermania, ende favorizojnë eksportin dhe dekurajojnë importet përmes një forme neo-merkantiliste në të cilën promovojnë një kombinim të politikave dhe kufizimeve proteksioniste dhe subvencionimit të industrisë vendase. Pothuajse çdo vend, në një moment apo një tjetër, ka zbatuar një formë të politikave proteksioniste për ruajtjen e industrive kyçe në ekonominë e saj. Kompanitë e orientuara nga eksporti zakonisht mbështesin politikat proteksioniste që favorizojnë industrinë apo kompanitë e tyre, ndërsa kompanitë e tjera dhe konsumatorët dëmtohen nga proteksionizmi. Kufizimet e importit çojnë në çmime më të larta për konsumatorët, të cilët paguajnë më shumë për mallrat apo shërbimet e huaja (Chmitz, 2012).

Avokatët e tregtisë së lirë të nxjerrin në pah se si përfitojnë nga tregtia e lirë të gjithë anëtarët e komunitetit global, ndërkohë që me politikat proteksioniste merkantiliste përfitojnë vetëm industrinë e përcaktuara, në kurriz të konsumatorëve dhe kompanive të tjera brenda dhe jashtë industrisë (Chmitz, 2012).

A.1 Kritika e Hume mbi Merkantilizmin

Një nga kritikët e parë të mendimit merkantilist ishte David Hume me zhvillimin e mekanizmit të çmimit të metaleve të çmuara (White & Gueguen, 1998).

Mekanizmi i metaleve të çmuara është një argument kundër idesë merkantiliste që një komb duhet të synojë për një bilanc tregtar pozitiv, apo eksporte neto pozitive. Argumenti tregon efektet e transaksioneve ndërkombëtare në sistemin e standardit të arit, një sistem në të cilin ari është mjete zyrtar i pagesave ndërkombëtare dhe monedha e çdo kombi është në formën e arit ose të valutës letër plotësisht të konvertueshme në ar (McArthur, 2007).

Hume argumentoi se kur një vend me standard ari ka një bilanc tregtar pozitiv, ari qarkullon brenda vendit në shumën që vlera e eksporteve tejkalon vlerën e importeve. Në anën tjetër, kur një vend i tillë ka një bilanc tregtar negativ, ari qarkullon jashtë vendit në shumën që vlera e

importeve tejkalon vlerën e eksporteve. Si pasojë, në mungesë të veprimeve nga ana e bankës qendrore në sasinë e parave në qarkullim, oferta e parasë do të rritet në një vend me një bilanc tregtar pozitiv dhe do të ulet në një vend me bilanc tregtar negativ. Duke përdorur një teori të quajtur Teoria Sasiore e Parasë, Hume argumentoi se në vendet ku sasia e parave rritet, inflacioni do të rritet dhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve do të tentojnë të rriten, ndërsa në vendet ku oferta monetare bie, do të ketë deflacion si dhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve do të bien (Wiley, 2012).

Çmimet e larta në vendet me bilanc tregtar pozitiv, shkaktojnë ulje të eksporteve dhe rritje të importeve, e cila do të ndryshojë bilancin tregtar drejt një ekuilibri neutral. Anasjelltas, në vendet me bilanc tregtar negativ, çmimet e ulëta do të shkaktojnë rritje të eksporteve dhe ulje të importeve, të cilat do të rrisin bilancin tregtar drejt një ekuilibri neutral. Këto rregullime në bilancin tregtar do të vazhdojnë derisa bilanci tregtar të jetë zero në të gjitha vendet e përfshira në këtë shkëmbim (Pomfret, 2008).

Sipas Appleyard dhe Field (2014), sot mekanizmi i rregullimit të çmimit është i parë mbi disa supozime. Duhet të ketë një lidhje formale midis çmimit dhe parave, si ai i supozuar në teorinë sasiore të parasë të Irvin Fisher, ku supozohet punësim i plotë:

$$MV=PY$$

Ku: M = oferta monetare

V = shpejtësia në të cilën qarkullojnë paratë

P = niveli mesatar i çmimeve

Y = Prodhimi i brendshëm real

Nëse supozohet se M (oferta e parasë) është e fiksuar nga rregullimet institucionale dhe Y është fiksuar në nivelin e punësimit të plotë, atëherë çdo ndryshim në ofertën e parave shoqërohet me një ndryshim proporcional në nivelin e çmimeve.

Kërkesa për mallrat e tregtuara është elastike. Kjo është e nevojshme për të siguruar që një rritje e çmimeve do të çojë në një rënie në shpenzimet totale për mallrat që tregtohen dhe një ulje e çmimeve do të ketë efekt të kundërt. Nëse kërkesa është jo elastike, mekanizmi i çmimeve të metaleve të çmuara do të tentojë të përkeqësojë disekuilibrin në bilancin tregtar.

Konkurrenca perfektë në tregjet e produkteve dhe faktorëve, supozohet në mënyrë që të krijojë lidhjen e nevojshme midis sjelljes së çmimeve dhe sjelljes së pagave, si dhe për të garantuar që çmimet dhe pagat janë fleksibël si në rritje ashtu dhe në rënie.

Së fundmi, është supozuar se ekziston standardi i arit. Në një sistem të tillë, të gjithë monedhat janë të lidhura me arin dhe me njëra-tjetrën, të gjitha monedhat janë të konvertueshme në ar, ari mund të blihet dhe të shitet dhe qeveria nuk kompenson impaktin e arit që rrjedh nga aktivitete të tjera për të influencuar në ofertën e parasë. Kjo është e mjaftueshme për të krijuar lidhjen ndërmjet lëvizjes së metaleve të çmuara dhe ndryshimit në ofertën e parasë së një kombi.

Nëse të gjitha këto supozime përmbushen, mekanizmi automatik i rregullimit do të kërkojë kohë që të ndodhë. Mekanizmi i rregullimit të bilancit të pagesave dhe standardi i arit, janë akoma çështje që diskutohen në ekonominë monetare ndërkombëtare.

A.2 Kritika e Adam Smith dhe David Rikardo për merkantilizmin

Adam Smith ka kritikuar teorinë merkantiliste për shkak se merkantilistët, në mënyrë të gabuar, kanë barazuar paranë me kapitalin dhe pozicionin e favorshëm në bilancin tregtar me bilancin e të ardhurave vjetore mbi konsumin.

Një tjetër çështje e kritikuar te merkantilistët është fakti se ato e shihnin tregtinë si një lojë me shumë zero në fund. Kjo pikëpamje është kritikuar si nga Adam Smith ashtu edhe nga David Rikardo të cilët kanë demonstruar se tregtia është një lojë me shumë pozitive në të cilën të gjithë vendet mund të përfitojnë nga tregtia ndërkombëtare.

Në mënyrë të përgjithësuar merkantilistët kanë dështuar të adresojnë 3 nga çështjet me interes të tregtisë ndërkombëtare: përfitimet nga tregtia, struktura e tregtisë dhe termat e tregtisë. Megjithatë merkantilistët janë kritikuar për qasjen e tyre, duhet të vihet në vëmendje se koncepti i bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar është përdorur për herë të parë në periudhën e merkantilizmit.

B. Teoritë klasike të tregtisë ndërkombëtare

Teoritë klasike janë quajtur kështu për shkak të ekonomistëve të cilët i kanë zhvilluar ato: Adam Smith, David Ricardo, Robert Torrens dhe John Stuart Mill. Teoritë e zhvilluara nga këto ekonomistë klasik janë të grupuara në kategoritë në vijim.

B.1 Teoria e Avantazhit absolut, Adam Smith

Adam Smith njihet si themeluesi i ekonomisë moderne dhe si një nga mendimtarët e parë dhe më të famshëm të cilët argumentuan në favor të tregtisë së lire. Megjithatë, teoria e tij e tregtisë

ndërkombëtare nuk është vlerësuar aq sa duhet (Schumacher, 2012). Puna e tij më e madhe ekonomike “Pasuria e Kombeve” e cila u botua në 1776, ishte një polemikë kundër merkantilizmit (Petralla, 1968).

Në teorinë e tij të avantazhit absolut, Smith (1776) u fokusua në aftësinë e një vendi për të prodhuar një produkt në mënyrë më efikase se një vend tjetër. Smith arsyetoi se tregtia midis vendeve nuk duhet të rregullohet apo të kufizohet nga politikat apo ndërhyrjet e qeverisë. Ai theksoi se tregtia duhet të rrjedhë natyrshëm në përputhje me forcat e tregut.

Në një botë hipotetike mes dy vendeve, nëqoftëse vendi A mund të prodhojë një të mirë të lirë ose më shpejt (ose të dyja) se vendi B, atëherë vendi A ka avantazh dhe duhet të fokusohet në specializimin e prodhimit të asaj të mire. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se vendi B është më mirë në prodhimin e një të mire, ai duhet të fokusohet në specializimin e prodhimit të saj. Nga specializimi, vendet do të gjenerojnë efikasitet, sepse forca e tyre të punës do të bëhet më e aftë duke bërë detyrat e njëjta. Prodhimi do të bëhet më efikas, sepse do të ketë një nxitje për të krijuar metoda prodhimi më të shpejta dhe më të mira për të rritur specializimin (Griswold, 1999).

Teoria e Smith-it argumentoi se me rritjen e efikasitetit, njerëzit në të dy shtetet do të përfitojnë dhe tregtia do të të inkurajohet. Teoria e tij deklaroi se pasuria e një vendi nuk duhet të gjykohej nga sasia e arit dhe argjendit që kishte, por më tepër nga standardet e jetesës së popullit të tij (Chmitz, 2012). Adam Smith ishte i pari që shprehu mendimin që tregtia ndërkombëtare nuk është një lojë me shumën zero dhe se ideja e mbështetjes në eksporte është joproductive. Sipas tij, të dy vendet mund të përfitojnë nga tregtia dhe tregtia është një lojë me shumë pozitive (positive-sum game) (Appleyard & Field, 2014).

Ai shpjegoi se vendet e ndryshme duhet të përdorin sasi të ndryshme burimesh në prodhimin e mallrave të njëjta. Kështu, çdo vend duhet të specializohet vetëm në prodhimin e atyre produkteve që mund t'i prodhojë me më pak burime. Në këtë mënyrë, prodhimi global maksimizohet. Pastaj, nga tregtia e lirë, çdo vend që tregton do të përfundojë me një sasi më të madhe të mallrave se më parë (Langdana & Murphy, 2014).

Idetë e Smith-it ishin shumë të rëndësishme për zhvillimin e hershëm të mendimit klasik dhe për ndryshimin e pikëpamjes mbi fitimet e mundshme nga tregtia ndërkombëtare. David Ricardo

zgjeroi konceptet e Smith-it dhe tregoi se përfitimet e mundshme nga tregtia janë shumë më të mëdha sesa Adam Smith-i i kishte parashikuar në teorinë e avantazhit absolut (Maneschi, 1998).

B.2 Teoria e Avantazhit krahasues, David Ricardo

Teoria e avantazhit krahasues është një nga teoritë më të vlerësuara në ekonomi. Sipas Schumacher-it (2012), David Ricardo nuk mund të jetë i pari i cili zhvilloi teorinë e avantazhit krahasues. Në fakt, shumë ia atribuojnë meritat e zbulimit të kësaj teorie Robert Torrens. Megjithatë, kjo teori është e lidhur ngushtë me emrin e Ricardos dhe ai ishte i pari që shkroi një formulim të plotë të kësaj teorie, përkatësisht në kapitullin 7 të punës së tij kryesore “Mbi Parimet e Ekonomisë Politike dhe Tatimeve”. Qëllimi i tij ishte të tregonte se tregtia e lirë është e dobishme për vendet pjesëmarrëse. Ky supozim mbështetet në teorinë e avantazhit krahasues. Ashtu si Smith, edhe Ricardo besonin se tregtia e lirë është e dëshirueshme dhe se vendet përfitojnë prej saj, por ndryshe nga Smith, Ricardo sheh një ndryshim themelor mes tregtisë së jashtme dhe të brendshme: "I njëjti rregull që rregullon vlerën relative të mallrave në një vend, nuk do të rregullojë vlerën relative të mallrave të shkëmbyer mes dy ose më shumë vendeve. Argumenti i tij është bazuar në supozimin se puna dhe kapitali nuk lëvizin mes vendeve (Schumacher, 2012).

Teoria e avantazhit krahasues është ndoshta koncepti më i rëndësishëm në teorinë e tregtisë ndërkombëtare. Ajo është gjithashtu një nga principet më të keqkuptuara. Burimet e keqkuptimeve janë të lehta për t'u identifikuar. Së pari, parimi i avantazhit krahasues është qartë kundër-intuitive. Shumë rezultate nga modeli formal, janë në kundërshtim me logjikën e thjeshtë. Së dyti, teoria është e lehtë për të ngatërruar me një tjetër nocion rreth avantazhit të tregtisë, i njohur në teorinë e tregtisë si teoria e avantazhit absolut. Logjika në teorinë e avantazhit absolut është mjaft intuitive. Ky konfuzion mes këtyre dy koncepteve, çon shumë njerëz të mendojnë se ata e kuptojnë avantazhin krahasues, kur në fakt, ajo që ata kuptojnë është avantazhi absolut. Së fundmi, teoria e avantazhit krahasues është shumë shpesh e paraqitur vetëm në formën e saj matematikore. Prezantimi i shembujve numerik ose prezantimeve me diagram, është e dobishme në demonstrimin e rezultateve themelore dhe implikimeve më të thella të teorisë. Megjithatë,

është gjithashtu e lehtë për të parë rezultatet matematikisht, pa e kuptuar intuitën themelore të teorisë (Suranovic, 2012).

Ricardo, e ka paraqitur teorinë e avantazhit krahasues nëpërmjet një shembulli numerik, duke marrë dy vende Anglinë dhe Portugalinë dhe dy produkte verë dhe rroba. Supozioni që një njësi rroba prodhohet në Angli dhe këmbëhet kundrejt një njësie verë në Portugal. Anglia, mund të jetë në ato rrethana që për të prodhuar rrobat, mund të ketë nevojë për 100 njerëz për një vit dhe nëse ajo tenton të prodhojë verë, mund t'i duhen 120 burra për të njëjtën kohë. Në këtë rast, Anglia ka më tepër interesi të importojë verë dhe ta blejë atë nga eksportimi i rrobave. Për të prodhuar verë në Portugal, mund të duhen 80 njerëz për një vit dhe për të prodhuar rroba, mund t'i duhen 90 njerëz për të njëjtën kohë. Në këtë rast, do të jetë në avantazh për të që të eksportojë verë në këmbim të rrobave (Ricardo, 1951).

Anglia ka avantazh krahasues në rroba ndërsa Portugalia ka në verë. Ky këmbim realizohet pavarësisht se produkti i importuar nga Portugalia mund të prodhohet brenda vendit me një forcë punëtore më të ulët se Anglia, pasi Anglia e prodhon këtë produkt me një forcë punëtore prej 100 njerëzish ndërsa Portugalia me 80 njerëz. Ajo që ka rëndësi është kostoja krahasuese. Anglia mund të eksportojë rroba pasi ajo mund t'i prodhojë ato me një kosto relative më të ulët (ndaj verës) se Portugalia, p.sh $100/120 < 90/80$ (Negishi, 2001).

Versioni modern i modelit Ricardian dhe rezultatet e tij, janë prezantuar duke ndërtuar dhe analizuar një model ekonomik të tregtisë ndërkombëtare.

Sipas (Appleyard & Field, 2014) më poshtë janë supozimet e modelit Ricardian:

1. Çdo vend ka një përzierje të caktuar të burimeve dhe të gjitha njësitë e çdo burim të veçantë janë identike.
2. Faktorët e prodhimit janë plotësisht të lëvizshëm mes përdorimeve alternative brenda një vendi. Ky supozim nënkupton se çmimet e faktorëve të prodhimit gjithashtu janë të njëjtë mes këtyre përdorime alternative.
3. Faktorët e prodhimit janë plotësisht të palëvizshëm jashtë; që do të thotë se ata nuk lëvizin mes vendeve. Prandaj, çmimet e faktorëve mund të jenë të ndryshëm mes vendeve para tregtisë.
4. Në model është përfshirë teoria e vlerës së punës. Kështu, vlera relative e një malli bazohet vetëm në përmbajtjen e tij relative të punës. Nga pikëpamja e prodhimit, kjo

nënkupton se (a) nuk janë përdorur inpute të tjera në procesin e prodhimit, ose (b) çdo input tjetër matet në termat e punës që përfshihet në prodhimin e tyre, ose (c) raporti inpute/punë është i njëjtë në të gjitha industritë. Në terma të thjeshtë, ky supozim do të thotë se një e mirë që kërkon dy orë pune është dy herë më e shtrenjtë se një e mirë që përdoret vetëm një orë.

5. Niveli i teknologjisë është i fiksuar për të dy vendet, edhe pse teknologjia mund të ndryshojnë mes tyre.
6. Kostot për njësi të prodhimit janë konstante. Kështu, orët e punës për njësi të prodhimit të një të mire nuk do të ndryshojnë, pavarësisht nga sasia e prodhuar. Kjo do të thotë se kurba e ofertës për çdo të mirë është horizontale.
7. Ka punësim të plotë.
8. Ekonomia karakterizohet nga konkurrencë e plotë. Asnjë konsumator apo prodhues nuk është mjaftueshëm i madh sa për të ndikuar në treg; kështu, të gjithë janë çmimpranues. Të gjithë pjesëmarrësit kanë qasje të plotë në informacionin e tregut, hyrja dhe dalja nga industria është e lirë dhe të gjitha çmimet janë të barabarta me koston marginale të prodhimit.
9. Nuk ka pengesa të imponuara nga qeveria në aktivitetin ekonomik.
10. Shpenzimet e transportit të brendshëm dhe të jashtëm janë zero.
11. Analiza është e kufizuar në dy-vende, dy mallra "botëror" për të lehtësuar prezantimin. Ky thjeshtësim do të hiqet më vonë për ta bërë modelin më realist.

Ajo që analizohet në këtë model, është se çfarë ndodh kur çdo vend lëviz nga jo tregtia në tregtinë e lirë me vendet e tjera, pra cilat janë efektet e tregtisë. Pra, cilat janë efektet e tregtisë mbi çmimet e mallrave në çdo vend, nivelet e prodhimit të mallrave, nivelet e punësimit në industri, nivelet e konsumit në çdo vend, pagat dhe të ardhurat si edhe mirëqenia individuale dhe kombëtare (Suranovic, 2012).

Përdorimi i këtij modeli tregon se në mungesë të tregtisë secili vend prodhon disa të mira. Për shkak të ndryshimeve të teknologjisë, çmimeve relative të dy produkteve do të ndryshojnë mes vendeve. Çmimi i produktit një njërin vend, sipas avantazhit krahasues do të jetë më i ulët se çmimi i të njëjtit produkt në vendin tjetër. Në qoftë se vendi ka avantazh absolut në prodhimin e të dy produkteve (siç është supozuar nga Ricardo), pagat reale të punonjësve në këtë vend do të

jenë më të larta në të dy industritë krahasuar me pagat e vendit tjetër. Me fjalë të tjera, punonjësit që jetojnë në një vend me teknologji të avancuar, kanë standard jetese më të lartë sesa punonjësit që jetojnë në një vend me teknologji inferiore. Arsyeja është se pagat janë të bazuara në produktivitet, pra në një vend që është më produktiv, pagat janë më të larta (Suranovic, 2012).

B.3 Kritikë e Teorisë së Avantazhit krahasues

Doktrina e avantazhit krahasues është kritikuar nga një sërë autorësh për shkak të numri të madh të supozimeve jorealitike të saj.

Profesor Bertil Ohlin në mënyrë kritike ka treguar se principet e avantazhit krahasues nuk janë të aplikueshme në tregtinë ndërkombëtare si edhe faktin se teoria nuk shpjegon pse ka diferenca në kosto. Teoria e Rikardos e avantazhit krahasues nuk shpjegon raportet me të cilët dy të mira mund të këmben për një tjetër. Pra ajo nuk jep indicie se çfarë janë termat e tregtisë. John Stuart Mill ka diskutuar këto çështje në teorinë e tij të kërkesë reciproke. Termi “kërkesë reciproke” nënkupton kërkesën e vendit për një të mirë të shprehur në terma të sasisë së një të mire tjetër për të cilën ai mund të heq dorë në këmbim. Në këtë mënyrë përcaktohen termat e tregtisë dhe pjesa relative e secilit vend.

Megjithatë teoria Rikardiane bazohet në supozime jorealitike, ajo ka shënuar një zhvillim të rëndësishëm në formimin e teorive të tregtisë ndërkombëtare.

C. Teoritë moderne të tregtisë ndërkombëtare

Një nga problemet e teorisë Rikardiane të avantazhit krahasues ishte se ajo nuk shpjegonte përse kishim diferenca në kostot e produkteve. Në vitin 1919, Eli Heckscher hodhi idenë se tregtia ishte si rezultat i diferencës së ekzistencës së faktorëve të prodhimit në vend të ndryshme të botës. Kjo ide është vazhduar nga pasardhësi i tij në këtë fushë Bertil Ohlin në vitin 1933 në librin e tij. Pikërisht ky libër është vlerësuar si baza e teorisë së Heckscher-Ohlin apo ndryshe si teoria moderne e tregtisë ndërkombëtare.

Teoria Heckscher-Ohlin

Teoria e Heckscher-Ohlin bazohet më së shumti në të njëjtat supozime si teoritë klasike të tregtisë për të krijuar dy teorema kryesore: Teorema e Heckscher-Ohlin si edhe teorema e barazisë së çmimeve.

Heckscher-Ohlin bazojnë zhvillimin e tregtisë në faktin se vende të ndryshme kanë nivele të ndryshme të faktorëve kapital dhe punë. Ato e vlerësojnë ekzistencën e faktorëve të ndryshëm në vende të ndryshme nëpërmjet dy kriterëve: kriterit të çmimit dhe kriterit fizik. Referuar kriterit të çmimit: një vend ka tepri në kapital nëse çmimi relativ i kapitalit kundrejt punës është më i ulët se në vendet e tjera. Ky kriter merr në konsideratë kërkesën dhe ofertën për faktorë. Kriteri fizik nga ana tjetër thekson se një vend ka tepri në kapital nëse sasia e kapitalit kundrejt sasisë së punës është më e madhe krahasuar me vendet e tjera. Ky kriter merr në konsideratë vetëm ofertën e këtyre faktorëve.

Kështu një vend do të eksportoj ato të mira për të cilat prodhimi kërkon përdorim intensive të faktorit me tepri dhe të lirë të vendit dhe do të importojë ato të mira për të cilat prodhimi kërkon përdorim intensive të faktorëve të kufizuar dhe me çmim më të lartë.

Teoria e Heckscher-Ohlin ka çuar në krijimin e teoremës së barazisë së faktorit dhe çmimit sipas së cilës tregtia e lirë ndërkombëtare do të çojë në barazimin e çmimit të faktorit dhe çmimit të të mirave. Teoria e Heckscher-Ohlin është vlerësuar si një teori më suplementare se teoria Rikardiane sepse mund të shpjegonte diferencat relative në kostove të faktorëve. Një kufizim i kësaj teorie është fakti se ajo supozon sasi fikse të faktorëve dhe nivel të paracaktuara teknologjie.

D. Teoritë e reja të tregtisë ndërkombëtare

Periudha moderne e tregtisë ndërkombëtare ka përkuar kryesisht me një sërë marrëveshesh të sistemit të tregtisë të nënshkruara në pjesë të ndryshme të botës. Të gjitha marrëveshjet realizohen me në qendër Organizatën Botërore të tregtisë (WTO) e cila ka për qëllim të përcaktojë rregullat në realizimin e tregtisë ndërkombëtare, politikat dhe marrëveshjet e ndryshme që vendet bëjnë me njëri-tjetrin. Një sërë marrëveshjes janë realizuar (për një vlerësim

të marrëveshjeve të ndryshme që kanë efekte korrente në tregtinë botërore mund ti referoheni seksionit të vlerësimit të partnerëve tregtar të Maqedonisë) duke rritur volumin e tregtisë botërore në nivelet më të larta që bota ka njohur ndonjëherë (Kerr & Gaisford, 2007).

Referuar zhvillimit empirik të kohëve moderne të matjes së tregtisë, janë përdorur dy modele kryesore nga studiuesit. Modeli i parë është modeli i Gravitetit dhe modeli i dytë është modeli Ekuilibrit të Përgjithshëm (Dilanchiev, 2012); (Ekanayake, Mukherjee, & Veeramacheneni, 2010); (Martinez-Zarzoso & Nowak-Lehmann, 2003)(Acreman & Gallagher, 2008); (Bhattarai, 2016), etc. Modeli i gravitetit është zhvillim i ligjit të Njutonit i cili specifikon se masa e të mirave dhe punës në një vend është e tërhequr nga masa e kërkesës për këto të mira në vendet destinacion por lëvizja e tyre ndikohet nga distance e vendit të origjinës me vendin nga ku vjen tërheqja e kërkesës. Sa më afër vendet aq më i lartë gravitetit midis të mirave dhe punës nga njëra anë dhe kërkesës nga ana tjetër.

Paraqitja matematikore e modelit të gravitetit është sipas formulës në vijim:

$$X_{ij} = \frac{Y_i E_j}{d_{ij}^2}$$

Në formulë X parashikon lëvizjen e të mirave dhe punës


i: është vendi i origjinës

j: është vendi destinacion

Ky model është përdorur fillimisht për të shpjeguar lëvizjen e punës (Ravenstein, 1889) dhe më pas nga (Tinberg, 1962) paraqitur në (Anderson, 2010) për të shpjeguar evolucionin në bilancin tregtar.

Modeli i dytë i Ekonomisë në ekuilibër të përgjithshëm është përdorur nga studiuesit me qëllim të paraqesë një pamje më të plotë të efekteve të politikave të ndryshme në të gjithë agjentët e ekonomisë.

Figure 14: Diagrama e modelit të ekuilibrit të përgjithshëm



Burimi: Kerr & Gaisford (2007)

Diagrama shërben për të paraqitur konceptualisht marrëdhënien që ekziston midis agentëve të ndryshëm të ekonomisë me qëllim konceptimin e implikimeve të ndryshme dhe politikave të ndërmarra. Modeli është paraqitur fillimisht nga Johansen (1960) dhe po përdoret gjithmonë e më shumë nga kërkuesit e ekonomisë politike me qëllim shpjegimin e nismave të ndryshme dhe efektet e tyre.

Teoritë e reja të tregtisë ndërkombëtare janë zhvilluar sepse teoritë e mëparshme: Teoria Rikardiane dhe ajo e Heckscher-Ohlin, nuk mund të shpjegojnë zhvillimet modern të tregtisë. Supozimet e tyre ishin jo reale si konkurrenca e plotë, kthime konstante të ekonomive të shkallës dhe teknologjia e njëjtë midis vendeve nuk qëndronin në zhvillimin e tregtisë në periudhën pas gjysmës së shekullit të 20-të.

Modifikimi i supozimeve të teorive ekzistuese kanë qenë bazat për zhvillimin e teorive të reja të cilat ndahen në 3 kategori kryesore: 1. Teoritë e tregtisë neo-teknologjike; 2. Modelet e tregtisë ndër-industriale; 3. Modelet strategjike të politikës tregtare.

1. Teoritë e tregtisë neo-teknologjike

Këto teori theksojnë rëndësinë e inovacionit teknologjik dhe diferencave në zhvillimin teknologjik midis firmave dhe vendeve si faktor kryesor për zhvillimin e tregtisë. Teoritë kryesore në këtë grup janë:

- a. Teoria e Kravis (Kravis, 1956) thekson se vendet tregtojnë ato produkte që janë të gjindshme në vend. Produkte të krijuara nga sipërmarrësit dhe inovacioni janë ato të cilët krijojnë avantazh krahasues duke përmirësuar pozicionin në tregtinë ndërkombëtare.
- b. Teoria e Linder (Linder, 1961) e volumit të tregtisë si edhe e modelit të kërkesës thekson se ngjashmëria e faktorëve të kërkesës si niveli i të ardhurave dhe shpërndarja e tyre përcaktojnë modelin e tregtisë. Sipas kësaj teorie kjo është arsyeja që volumi më i madh i tregtisë realizohet ndërmjet vendeve të zhvilluara.
- c. Teoria e diferencave teknologjike e Posnerit (Posner, 1961). Kjo teori thekson se ndryshimet teknologjike janë një proces i vazhdueshëm që ndikojnë në tregtinë ndërkombëtare. Ekzistenca e teknologjisë së avancuar në një vend bën që ai të ketë një avantazh krahasues ndaj vendeve të tjera.
- d. Teoria e ciklit të produktit të Vernon (Vernon, 1966), mbështetet në teorinë e ndryshimeve në zhvillimin teknologjik të vendeve por merr parasysh edhe ciklin e jetës së produktit. Kjo teori thekson se avantazhi krahasues ndryshon përgjatë jetës së këtyre produkteve.

2. Modelet e tregtisë ndër-industriale

Teoritë e tregtisë ndër-industriale janë zhvilluar mbas viteve 1970 dhe theksojnë se vendet hyjnë në tregti për produkte të ngjashme por të diferencuara. Ekonomitë e shkallës dhe konkurrenca joperfekte krijon zhvillimin e tregtisë edhe nëse midis vendeve nuk ka avantazh krahasues. Modelet kryesore të tregtisë midis industrive janë:

- a. Modeli i Krugman (Krugman P. , 1979 b)– Modeli Krugman njeh rolin e ekonomive të shkallës dhe konkurrencës monopolistike në tregtinë ndërkombëtare. Sipas këtij modeli për shkak të ekonomive të shkallës dhe konkurrencës monopolistike shkëmbimet që realizohen midis vendeve bëjnë që të kemi një shumëllojshmëri të të mirave dhe kështu mirëqenie më të lartë për konsumatorët, rritje të kërkesës, prodhimit dhe të ardhurave reale.
- b. Modeli Brander-Krugman (Brander & Krugman, 1983)-bazohet në modelin e oligopolit në tregtinë ndër-industriale. Ky model përfshin konceptin e dampingut në tregtinë ndërkombëtare. Damping në tregtinë ndërkombëtare është fenomeni me anë të së cilit

kompanitë shesin produktet në vendet eksportuese me çmim më të ulët se në vendin e origjinës. Kjo sjellje ndiqet edhe nga firmat e tjera në tregjet reciproke duke krijuar një situatë oligopoli në tregtinë brenda industrisë të produkteve homogjene. Problematika e këtij modeli është se ai nuk mund të shpjegojë efektin neto të këtij procesi në mirëqenien ekonomike të vendeve.

3. *Modelet strategjike të politikës tregtare*

Modelet strategjike të politikës tregtare janë zgjerime të modeleve të tregtisë ndër-industriale. Ato janë ndërtuar në supozimet e ekuilibrit të pjesshëm dhe në modelin e tregjeve oligopolistike. Këto modele sigurojnë një justifikim të masave të ndërmarra në kuadër të mbrojtjes së tregjeve të brendshme dhe subvencionimit të eksporteve me qëllim rritjen e tyre dhe mirëqenien kombëtare. Këto modele shtrihen mbi bazat e luftës tregtare midis vendeve të industrializuara si Shtetet e Bashkuara, Japonia dhe Komuniteti European. Në këtë grup përfshihen:

- a. Modeli Strategjik i Krugman-it (Krugman P. R., 1984)-Modeli strategjik i Krugman-it tregon se mbrojtja e prodhuesve vendas nga importi çon në rritje të eksportit. Në këtë model merren parasysh tre forma të ekonomive të shkallës a. Ekonomitë statike të brendshme të një firme, b. Ekonomitë në kërkim & zhvillim dhe investim c. Ekonomitë dinamike të të mësuarit duke vepruar.
- b. Model i Brander-it dhe Spencer-it (Brander & Spencer, 1985)- Modeli i Brander dhe Spencer tregon se subvencionimi i eksporteve ndihmon prodhuesit e brendshëm të hyjnë në tregjet e vendeve të treta me kosto të njëjta me rivalët. Kjo është një teori loje me dy stadi në të cilën qeveria në mënyrë simuluese përzgjedh nivelin e subvencionit dhe më pas prodhuesit përzgjedhin nivelin e prodhimit. Modeli supozon se mungon kërkesa e brendshme dhe se firmat e vendit rival nuk subvencionohen. Subvencionimi bën që të ulen kostot e prodhimit për eksportuesit, duke bërë që ato të zotërojnë një treg më të gjerë në vendet ku eksportojnë në kurriz të rivalëve të tyre.

Teoritë e reja të tregtisë shpjegojnë më së miri zhvillimin e tregtisë në kohën e sotme. Konkretisht 1/4 e tregtisë kryhet për produkte të ngjashme të të njëjtës industri kryesisht midis vendeve të zhvilluara. Tregtia ndër-industriale përfiton nga tregtia ndërkombëtare më shumë se

prej avantazhit krahasues sepse tregtia ndër-industriale lejon vendet të përfitojnë nga tregjet e mëdha. Tregtia ndër-industriale do të zhvillohet midis vendeve të cilat kanë ngjashmëri në faktorët e prodhimit dhe kanë të njëjtët faktorë që ndikojnë kërkesën.

3.1.2 Teoritë mbi determinantët e bilancit tregtar

Teoria e bilancit tregtar apo bilancit të llogarisë korrente, ka të bëjë me determinantët ekonomik të bilancit tregtar. Teoritë dominuese të bilancit tregtar janë tre teori kryesore. Sipas mekanizmit të çmimit të metaleve të çmuara i zhvilluar nga David Hume (1752), rregullimi i bilancit tregtar është parë si një proces automatik në tregtinë e lirë. Kjo doktrinë ishte dominuese para Depresionit të Madh në vitin 1930. Që pas rënies së kursit fiks të këmbimit dhe shfaqjes së disekuilibrit në shumë vende pas Luftës së parë botërore, u adoptua gjerësisht qasja ekonomike Keynesiane e cila mbron ndërhyrjet e qeverisë në treg (Johnson G. , 1958). Gjatë viteve 1950 u propozua një qasje monetare nga Frenkel dhe Johnson (1976), sipas të cilës disekuilibri i bilancit tregtar konsiderohet si një fenomen monetar.

Në lidhje me determinantët e bilancit tregtar janë realizuar shumë studime. Në studimin e tij “Një leksion Inagurues”, Hicks (1953) e përshkruan problemin afatgjatë të dollarit si një problem i disekuilibrit i zhvilluar nga ndryshimi i produktivitetit. Johnson (1954), përfshiu të ardhurat dhe efektin e rritjes së produktivitetit në bilancin tregtar, duke treguar se efekti i të ardhurave ndihmon në ekuilibrimin apo përkeqësimin e bilancit tregtar nën supozimin e rregullimit të çmimeve. Metzler (1949), tregoi nevojën për rregullimin e çmimeve përmes ndryshimeve të kursit të këmbimit dhe sipas tij zhvlerësimi është efektiv në përmirësimin e bilancit tregtar.

Determinantët kryesor si produktiviteti, të ardhurat e brendshme dhe vendeve partnere tregtare, norma reale efektive e kursit të këmbimit, konsumi, investimet e huaja direkte por edhe faktorët monetarë. Studime mbi këto faktorë paraqiten në literaturën e shqyrtuar në vijim të studimit.

A. Produktiviteti dhe Bilanci Tregtar

Efektet e produktivitetit në bilancin tregtar janë analizuar që në modelet Richardiane, ku modeli tregtar që përdor një vend përcaktohet nga produktiviteti i tij. Hicks (1953), realizoi një analizë intuitive dhe deskriptive duke u bazuar në modelin Richardian, ku analizoi produktivitetin dhe gjendjen e disekuilibrit. Ai supozoi se kostoja ishte konstante, sipas të cilës të gjitha produktet prodhohen me një kosto për njësi e cila është e pavarur nga sasia e prodhuar. Rezultati i studimit ishte që përmirësimet e produktivitetit të bazuara në eksport, kanë tendencë të shkaktojnë defiçit në bilancin e pagesave të vendit të origjinës. Kur produktiviteti rritet bazuar në importe, ndikimi monetar do të shkaktojë defiçit në vendin e huaj.

Pas Hicks (1953), Johnson (1954) analizoi lidhjen ndërmjet rritjes së produktivitetit, të ardhurave dhe bilancit të pagesave, duke përdorur modelin e dy vendeve të tregtisë ndërkombëtare. Për të realizuar këtë analizë, ai mori shkas nga disekuilibri i vazhdueshëm i pagesave në Amerikë dhe nga “dollar shortage”. Sipas tij kishte dy shpjegime për këtë disekuilibër të vazhdueshëm. Së pari, të hyrat e parave në Amerikë rriten me ritme më të ulta sesa rritja e produktivitetit, kështu që çmimet bien dhe bota jashtë është e detyruar të zgjedhë mes deflacionit periodik dhe zhvlerësimit periodik dhe në këtë linjë argumenti, disekuilibri i vazhdueshëm është një problem i axhustimeve të parave. Së dyti, progresi teknik i Amerikës është i bazuar në zëvendësimin e importit, kështu që përveç komplikimeve monetare, progresi ekonomik imponon një humbje të vërtetë në botën e jashtme dhe në këtë linjë argumenti, disekuilibri ekonomik është kryesisht një problem i axhustimeve reale.

Dornbusch, Fischer dhe Samuelson (1977), analizuan progresin teknologjik, nëpërmjet një modeli që ishte zgjerim i modelit Richardian, për të përcaktuar ekuilibrin relativ të pagave dhe strukturën e çmimeve. Ata supozuan kërkesë konstante të punës për njësi për mallra që mund të prodhohen në vendin e origjinës dhe në vendet e huaja dhe shpërndarje konstante të shpenzimeve. Ata dolën në përfundimin se progresi teknologjik uniform në rastin e vazhdimësisë së mallrave, me një reduktim proporcional në kërkesat e huaja të punës për njësi, çon në një humbje të avantazhit konkurrues në vendin e origjinës dhe defiçit tregtar.

Një studim tjetër për të parë efektin e produktivitetit, u realizua nga Krugman (1979), i cili u përpoq të përfshinte ndryshimet teknologjike në teorinë e tregtisë ndërkombëtare. Ai zhvilloi një model ekuilibri të përgjithshëm të tregtisë së produkteve, ku mori në studim dy vende, veriu ku kishte inovacion dhe jugun ku nuk kishte inovacion. Inovacioni konsiston në zhvillimin e produkteve të reja, të cilat mund të prodhoheshin fillimisht vetëm në veri, por eventualisht teknologjia e prodhimit u bë e mundur në jug. Faktorët që studioi ishin inovacioni dhe transferimi i teknologjisë. Supozimet kryesore ishin që forca punëtore ishte i vetmi faktor i prodhimit të produkteve (të vjetra dhe të reja) dhe të gjitha produktet prodhohen me të njëjtin funksionim kostoje. Gjithashtu supozim tjetër ishte që produktiviteti i forcës punëtore ishte i njëjtë në veri dhe në jug. Nga realizimi i analizës, ai arriti në përfundimin se transferimi i teknologjisë ndikon në rritjen e tregtisë dhe përmirëson termat e tregtisë për vendet më pak të zhvilluara.

Modelet e mësipërme supozonin që të gjitha mallrat janë të tregtueshëm. Balassa-Samuelson (1964), zgjeruan modelin Richardian duke përfshirë në model edhe mallrat e patregtueshëm dhe identifikuan ndryshimet e produktivitetit në sektorin e mallrave të tregtueshëm dhe atyre të patregtueshëm, si burim i ndryshimeve relative të çmimeve të brendshme. Kur një vend ka lëvizje pozitive të produktivitetit që ndikon në tregtimin e mallrave, monedha vlerësohet në terma real dhe bilanci tregtar përkeqësohet.

B. Të ardhurat dhe Bilanci Tregtar

Të ardhurat janë një nga determinantët më të rëndësishëm të bilancit tregtar, pasi ndikojnë si në importet e një vendi ashtu edhe në eksportet e tij. Përcaktimi i të ardhurave të një vendi në një ekonomi të hapur është përcaktuar kryesisht duke përdorur modelin tradicional Keynesian, sipas të cilit ndryshimet në eksporte, importe dhe në investimet e brendshme, janë të transferueshme nga një vend në një tjetër nëpërmjet ndryshimeve në tregtinë e jashtme duke shkaktuar ndryshime të të ardhurave (Xin, 2012).

Shumica e analizave lidhur me efektin e të ardhurave, është fokusuar në elasticitetin e të ardhurave midis vendeve. Në modelin e tij të dy vendeve, Johnson (1954) tregoi se edhe në qoftë se tregtia është e balancuar fillimisht midis dy vendeve, çmimet janë konstante dhe rritja e të

ardhurave është e njëjtë në të dy vendet, bilanci tregtar mund të ndryshojë me kalimin e kohës nëse elasticiteti i të ardhurave nga kërkesa për eksportet e të tjerëve ndryshon.

Sipas qasjes absorbuese, çdo përmirësim në bilancin tregtar kërkon rritje të të ardhurave mbi shpenzimet totale. Aplikimi i qasjes absorbuese ndaj zhbancimeve të llogarive korrente në vitet 1970, çoi në përfundimin se zhbancimet e vërejtura reflektojnë dallimet brenda vendeve në nxitjen e kursimeve dhe investimeve (Artus, 1979).

Sipas qasjes monetare, bilanci i pagesave konsiderohet si një fenomen monetar. Vendet me norma të larta të rritjes së të ardhurave reale do të kenë bilanc pagesash me sufiçit për shkak të efektit pozitiv të të ardhurave reale të larta në kërkesën për para reale (Frenkel & Johnson, 1976). Kur norma e brendshme e interesit është më e lartë, të huajt janë më të interesuar për të blerë aktive financiare të vendit. Kjo krijon fluks kapitali dhe sufiçit në bilancin e pagesave (Goldstein & Khan, 1985)

Shumica e studimeve empirike që kanë analizuar bilancin tregtar apo bilancin e llogarisë korrente, është bazuar në modelin Keynesian të përcaktimit të të ardhurave.

Sachs (1981), analizoi korrelacionin midis të ardhurave dhe bilancit tregtar duke theksuar dallimin ndërmjet ndryshimeve kalimtare dhe të përhershme të të ardhurave. Analiza supozoi se nivelet e prodhimit janë të përcaktuara nga oferta dhe nuk janë të ndikuara nga kërkesa agregate; normat reale të interesit janë të lidhura me produktivitetin marginal të kapitalit dhe nuk janë të ndikuara nga politikat monetare. Ai konkludoi se një rritje e përhershme e të ardhurave nuk e ndikon bilancin tregtar sepse të ardhurat dhe konsumi ndryshojnë me të njëjtën madhësi.

Një rritje e përkohshme e të ardhurave, mund të rritë apo të ulë bilancin tregtar në afatshkurtër, në varësi të burimeve të ndryshimit. Nëse rritja është shkaktuar nga kërkesa agregate, bilanci tregtar ka tendencë të ulët (Cardia, 1991).

C. Kursi i Këmbimit, Efektet e çmimeve Relative dhe Bilanci Tregtar

Nga studimet e realizuara, është konkluduar se kursi i këmbimit është determinanti më i rëndësishëm i cili ndikon në bilancin tregtar.

Sipas David Humes në mekanizmin e çmimeve të metaleve të çmuara, rregullimi automatik i disekuilibrit ndërkombëtar shkaktohet nga rrjedhja e parave dhe nga ndryshimet e nivelit të çmimeve kombëtare. Pas kolapsit të regjimit të kurseve fikse të këmbimit, shfaqja e papunësisë masive ishte një problem i madh ekonomik dhe modeli Keynesian ndryshoi supozimin e tij bazë të fleksibilitetit të pagave dhe të çmimeve në punësim të plotë dhe rregullimi ndërkombëtar u pa si problem i politikave monetare (Xin, 2012).

Sipas pikëpamjes tradicionale, zhvlerësimi i monedhës çon në zgjerim të tregtisë me anë të çmimeve më të ulta eksportuese dhe përmirëson bilancin tregtar. Shkalla në të cilën zhvlerësimi kalon te konsumatorët e huaj, varet nga elasticiteti i kërkesës dhe ofertës për eksporte. (Bickerdike, 1920), (Robinson, 1937).

Sipas kushteve të Marshall-Lerner dhe kurbës J, zhvlerësimi ndikon në stabilizimin e tregut të këmbimit valuator dhe përmirëson bilancin tregtar (Bahmani-Oskooee M. , 1985).

Në lidhje me kursin e këmbimit dhe bilancin tregtar janë realizuar analiza dhe studime nga shumë autorë ku disa prej tyre do t'i shohim më poshtë.

Alexander dhe Miller (1952), realizuan një studim duke përdorur një qasje absorbuese të një modeli të plotë ekonomik, ku analizuan normën e kursit të këmbimit. Ky studim supozonte që në një ekonomi ku nuk kishte papunësi, ndryshimi i kursit të këmbimit ndikon vetëm në çmimin e të mirave që tregtohen, ndërsa të gjitha çmimet e tjera dhe të ardhurat mbeten të pandryshuara. Ata konkluduan që efekti i zhvlerësimit varet vetëm nga elasticiteti, por kërkon që inflacioni që rezulton nga zhvlerësimi në këto kushte, të prodhojë një reduktim të absorbimit agregat, në krahasim me kapacitetin prodhues agregat.

Në një studim të mëvonshëm, Alexander (1959), realizoi një sintezë të qasjeve të elasticitetit dhe absorbimit, ku donte të analizonte normën e këmbimit dhe të ardhurat. Supozimi i këtij studimi

ishte që norma e kursit të këmbimit duhet të barazojë çmimet e vendase dhe ato të huaja. Efekti i zhvlerësimit në bilancin e pagesave përcaktohet nga qasja tradicionale e elasticitetit, në të cilin është aplikuar një shumëzues për të marrë ndryshimet në të ardhurat kombëtare dhe për të nxitur ndryshime në importet dhe eksportet e vendit të origjinës.

Mundell (1963), studio implikimet teorike dhe praktike të lëvizshmërisë së kapitalit dhe politikat e stabilizimit gjatë kursit të këmbimit fiks dhe fleksibël. Studimi supozonte: burime të papërdorura, kthim shkalle konstant dhe paga fikse. Kjo do të thotë se furnizimi i prodhimit të brendshëm është elastik dhe niveli i çmimeve është konstant. Supozimi tjetër është që kursimet dhe taksat rriten me rritjen e të ardhurave, që bilanci tregtar varet vetëm nga të ardhurat dhe norma e këmbimit, që investimet varen nga norma e interesit dhe kërkesa për para varet nga të ardhurat dhe norma e interesit. Gjithashtu supozohej që vendi në konsideratë është shumë i vogël për të ndikuar në të ardhurat e vendeve të tjera apo në nivelin e normave të interesit botëror. Politika monetare supozohej që të marrë formën e blerjes së letrave me vlerë në treg të hapur dhe politika fiskale formën e rritjes së shpenzimeve qeveritare (në mallra për shtëpi) financuar nga një rritje e borxhit publik. Mundell (1963) nxori përfundimin që politika monetare nuk ka asnjë ndikim në punësim gjatë kursit fleksibël të këmbimit dhe politika fiskale ka efekt të fortë në punësim gjatë kursit fiks të këmbimit. Politika monetare gjatë kurseve fikse të këmbimit bëhet një mjet për ndryshimin e nivelit të rezervave, ndërsa politika fiskale gjatë normave fleksibël të këmbimit behët mjet për ndryshimin e bilancit tregtar, pra të dy politikat e lënë të paprekur nivelin e prodhimit dhe punësimit.

Dy studiuesit Calvo dhe Rodriguez (1977), përdorën modelin e dy sektorëve të përcaktimit të kursit të këmbimit për të analizuar ofertën monetare dhe kursin e këmbimit. Supozimi i studimit ishte që rezidentët mbajnë valutë të huaj përveç monedhës së tyre. Nga analiza rezultoi që kursi real i këmbimit varet nga variablat monetare (shkalla e zgjerimit monetar) në afatshkurtër, ndërsa në afatgjatë përcaktohet plotësisht nga variablat reale. Supozimi kryesor ishte që rritja e produktivitetit është e reflektuar në mënyrë proporcionale me rritjen e të hyrave të parave ose në mënyrë proporcionale me uljen e çmimeve. Rezultati i studimit ishte që rritja e produktivitetit rrit të ardhurat reale dhe ka tendencë të përkeqësojë bilancin tregtar. Ndërsa ulja e çmimeve përmirëson bilancin tregtar nëse elasticiteti i kërkesës është mjaftueshëm i lartë për zhvlerësim.

Sachs (1981), realizoi një analizë të integruar të llogarive korrente duke përdorur teoritë moderne të kursimit dhe investimit, ku studioi faktorët që kanë përcaktuar madhësinë dhe drejtimin e imbalancës së llogarisë korrente dhe marrëdhënien mes llogarisë korrente dhe lëvizjes së kursit të këmbimit. Analiza supozoi se nivelet e prodhimit janë të përcaktuara nga oferta dhe nuk janë të ndikuara nga kërkesa agregate; normat reale të interesit janë të lidhura me produktivitetin marginal të kapitalit dhe nuk janë të ndikuara nga politikat monetare. Ai konkludoi se një rritje e përhershme e të ardhurave e lë të pandikuar bilancin tregtar dhe një rritje e përkohshme e të ardhurave varet nga burimet që sjellin ndryshimin e saj.

D. Pikëpamja Monetare dhe Bilanci Tregtar

Roli i parave nuk është marrë në konsideratë në qasjen konvencionale të çmimeve relative (elasticiteti) dhe në qasjen e shpenzimeve agregate (absorbuese) (Xin, 2012).

Pas punës së Meade (1951), Polak (1957) dhe Lee dhe Sampson (2000), modelet e reja monetare e konsiderojnë disekuilibrin tregtar si një fenomen monetar dhe supozojnë çmime dhe paga fleksibël në vend të çmimeve të vazhdueshme në modelin Keynesian. Në këto modele monetare, përdoret më shpesh termi bilanc i pagesave sesa bilanc tregtar (Xin, 2012).

Një sërë studiuesish si Mundell (1963), Calvo dhe Rodriguez (1977), Frenkel & Rodrigues (1982) etj, studiovan marrëdhënien ndërmjet bilancit të pagesave të një vendi dhe ofertës së parave. Ata argumentuan se ka disekuilibër në tregun e parave nëse ka surplus apo defiçit në bilancin e pagesave.

Frenkel dhe Razin (1986), përdorën modelin e ekuilibrit të dy vendeve të ekonomisë botërore, për të analizuar defiçitin buxhetor dhe shpenzimet qeveritare në botë, normat e interesit, konsumin dhe borxhin ndërkombëtar. Supozimi i këtij studimi ishte që tregjet botërore të kapitalit janë plotësisht të integruara dhe individët dhe qeveritë në këto vende kanë të njëjtat norma interesi. Analiza demonstroi që varësia e normës botërore të interesit, pasuria dhe konsumi në politikën fiskale është shumë e ndjeshme ndaj specifikimeve të detajuara të politikës në termat e nivelit dhe mënyrës së shpenzimeve qeveritare dhe taksave. Efektet cilësore të

politikave fiskale varen nëse vendi ndjek politika që drejtojnë një suficit apo deficit në llogarinë korrente.

Obstfeld dhe Rogoff (2000), zhvilluan një model rastësor makroekonomik të ekonomisë së hapur bazuar në paga nominale fikse, për të analizuar ofertën monetare dhe shpenzimet qeveritare. Studimi supozonte konkurrencë monopolistike dhe çmime nominale fikse. Zgjidhja e problemit të vendosjes së pagave në kushte pasigurie, lejon analizën e efekteve të regjimit monetar në mirëqenie, në prodhimin e pritur dhe kushtet e pritshme të tregtisë. Pavarësisht bashkëveprimit të mundshëm ndërmjet papërsosmërive për shkak të pagave fikse dhe monopolit, rregulli optimal i politikës monetare ka një zgjidhje të formës së mbyllur. Lëvizjet e ofertës monetare mund të kenë efekte reale nëpërmjet llogarive korrente dhe një rritje e përhershme në blerjet qeveritare botërore, ul përkohësisht normat reale të interesit botëror.

Kim (2001), përdori një model të një ekonomie të vogël të hapur me mallra të patregtuar bazuar në qasjen monetare, për të analizuar çmimin e aseteve dhe kërkesën për para.

Ky studim tregon një evidencë empirike të efekteve të lëvizjeve të politikës monetare mbi bilancin tregtar në vendet e vogla të hapura evropiane (Itali, Francë dhe Angli). Studimi supozoi një model me treg jo të plotë, ku çmimi i aseteve është çmim i tokës dhe është i vetmi çmim i tregut i përcaktuar në sistemi. Çmimi i mallrave konsiderohet i përcaktuar nga pariteti i fuqisë blerëse. Kim arriti në përfundimin se kërkesa për para dhe kthimi i aseteve janë faktorët kyç në gjenerimin e një mekanizmi rrjedhës. Ekziston një lidhje pozitive ndërmjet çmimit të aseteve dhe injeksionit monetar nëpërmjet balancimit të suficitit të pagesave.

Nga sa pamë më sipër, mund të themi që produktiviteti, norma e interesit, të ardhurat dhe faktorët monetarë, janë identifikuar si faktorët më të rëndësishëm të bilancit tregtar sipas modeleve teorike. Rritja e produktivitetit mund të ndikojë në të ardhurat e brendshme dhe pagat. Në modelet monetare, bilanci i pagesave trajtohet më tepër si një fenomen monetar.

3.2 Studime empirike mbi determinantët e bilancit tregtar

Në pjesën e mësipërme pamë teoritë e tregtisë ndërkombëtare, determinantët e bilancit tregtar si dhe evoluimin e modeleve të përdorura për të përcaktuar determinantët e bilancit tregtar. Në këtë pjesë do të shohim disa studime empirike mbi lidhjen e determinantëve kryesor dhe bilancit tregtar.

Për të paraqitur një pamje sa më të gjerë të marrëdhënies së determinantëve me bilancin tregtar, janë rishikuar analizat empirike në disa vende të botës, duke përfshirë vendet e zhvilluara si dhe vendet në zhvillim të cilat janë pak a shumë në të njëjtën situatë ekonomike me Maqedoninë.

Referuar situatës së SHBA-ve, përse i përket tregtisë së jashtme e cila është e shoqëruar me defiçiteve të larta, është realizuar studimi i Bernheim (1988). Ky studim ka vëzhguar marrëdhënien ndërmjet politikave fiskale dhe llogarive korrente të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe pesë partnerëve të saj kryesor që janë Britania e Madhe, Gjermania, Japonia, Kanada dhe Meksika. Të dhënat u morën për një periudhë 24 vjeçare, nga viti 1960-1986. Nga analiza e serive kohore për gjashtë vendet e marra në studim, rezultoi se ekziston një lidhje e fortë dhe e rëndësishme ndërmjet politikës fiskale dhe defiçitit tregtar. Për Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermaninë, rritja me 1\$ në defiçitin buxhetor është e lidhur me rënien me 0.30\$ në tepriçën e llogarisë korrente. Efektet fiskale janë dukshëm të mëdha për Meksikën, ndërsa për Japoninë nuk ka efekte fiskale megjithëse evidenca është shumë e dobët.

Një tjetër studim për bilancin tregtar të Gjermanisë dhe SHBA-ve vjen nga Schroder (2011), i cili analizoi në mënyrë empirike ndikimin e kërkesës relative dhe çmimeve relative në bilancin tregtar në Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë periudhës 1991-2010. Gjermania kishte një defiçit tregtar për shkak se kërkesa e brendshme ishte më e ulët në raport me kërkesën e vendeve partnere, ndërsa shtetet e bashkuara të Amerikës kishin defiçit tregtar për shkak se kërkesa e brendshme ishte më e madhe se e vendeve të OECD-së. Faktorët që përcaktojnë çmimet relative, të tilla si kostoja e punës për njësi dhe kursi i këmbimit, nuk kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në bilancin tregtar të këtyre vendeve.

Falk (2008), investigoi në mënyrë empirike faktorët kryesorë që ndikojnë në bilancin tregtar duke përdorur të dhënat për 32 vende të industrializuara dhe në zhvillim për periudhën 1990-2007. Në veçanti u analizua ndikimi i indeksit real efektiv të kursit të këmbimit, PBB-ja reale dhe bilanci i buxhetit të qeverisë në bilancin tregtar. Rezultatet empirike bazuar në modelin fiks dhe variabël, treguan se indeksi real efektiv i kursit të këmbimit dhe të ardhurat e jashtme dhe të brendshme, janë faktorët më të rëndësishëm në shpjegimin e bilancit tregtar. Evidenca për ndikimin e bilancit të buxhetit të qeverisë është e përzier. Rezultatet tregojnë një marrëdhënie pozitive të rëndësishme mes bilancit të buxhetit qeveritar dhe bilancit tregtar, megjithatë efekti nuk është i rëndësishëm. Gjithashtu rezultatet tregojnë se efektet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme mes vendeve, në varësi të pozicionit pozitiv apo negativ të investimeve të huaja direkte. Në vendet që kanë pozicion pozitiv të IDH-ve, bilanci tregtar është më pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të indeksit real efektiv të kursit të këmbimit.

Efekti i normave reale të kursit të këmbimit në 20 vendet e OECD për periudhën 1985–2008 është studiuar nga Kharroubi, (2011). Në këtë studim specifikohet se rritja e tregtisë botërore do të thotë rritje të ndjeshmërisë së saj nga norma reale e këmbimit por nga ana tjetër rritja e specializimit vertikal dhe rritja e ofertës globale ka bërë që të ulet ky elasticitet, megjithëse rëndësia relative e këtyre dy efekteve varion ndërmjet vendeve. Nga vlerësimet e modelit ekonometrik ka rezultuar se vendet të cilat mund të përfitojnë më shumë për të balancuar bilancin tregtar janë ato me nivel të lartë të indeksit IIT dhe nivel të ulët të indeksit ICE. IIT-ja është matës i tregtisë ndërmjet industrive.

Bitzis, Paleologos dhe Papazoglou (2008) realizuan një studim empirik mbi determinantët bilancit tregtar në Greqi duke përdorur qasjen e integritetit të Johansen dhe modelin ECM për të dhënat e periudhës 1995-2006. Qëllimi ishte të identifikonin faktorët që kanë çuar në zgjerimin e defiçitit tregtar të Greqisë. Nga studimi rezultoi se në perspektivën afatshkurtër, përkeqësimi i konkurrencës, procesi i vazhdueshëm i konvergjencës reale e cila është ndihmuar nga rritja e madhe e kredive si pasojë e liberalizimit financiar dhe normave të ulëta të interesit, pozicioni ciklik i ekonomisë greke dhe në masë më të vogël ekspansioni fiskal, kanë ndikuar në rritjen e defiçitit të bilancit tregtar. Gjithashtu rol të rëndësishëm në afatshkurtër kanë luajtur dhe faktorët ekzogjenë që përfshijnë zhvillimet në çmimet e naftës dhe transportit të mallrave.

Bollano dhe Ibrahimaj (2015) realizuan një studim empirik mbi determinantët e llogarisë korrente për 11 vende të Europës Qendrore dhe Lindore (Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Republika Çeke, Hungari, Lituani, Maqedoni, Poland, Rumani, Serbi dhe Turqi). Të dhënat u morën për periudhën 2005-2014 dhe analiza u realizua duke përdorur modelin VAR-it. Rezultatet e analizës treguan se PBB-ja, defiçiti fiskal dhe norma reale efektive e këmbimit janë determinantët kryesorë në llogarinë korrente të këtyre vendeve. Një lëvizje pozitive e PBB-së sjell një efekt të vazhdueshëm negativ në bilancin e llogarisë korrente. Gjithashtu ekziston lidhje pozitive mes defiçitit fiskal dhe defiçitit të llogarive korrente dhe zhvlerësimi i kursit real efektiv të këmbimit nuk ka efekt të menjëhershëm në llogarinë korrente por mund ta përmirësojë atë pas një viti.

Irhan, Alacahan dhe Korap (2011) analizuan determinantët e bilancit tregtar të Turqisë duke u bazuar në një model empirik. Të dhënat u morën për periudhën 1990-2007. Rezultatet treguan se kursi real i këmbimit përmirëson bilancin tregtar në mënyrë të fortë dhe të rëndësishme, të ardhurat reale në familje ndikojnë negativisht në bilancin tregtar dhe bilanci tregtar përmirësohet ndjeshëm nga rritja e të ardhurave reale nga jashtë.

Jafari, Ismail dhe Kouhestani (2011) analizuan determinantët e tregtisë dypalëshe ndërmjet vendeve të D8 (Malajzi, Iran, Turqi, Indonezi, Egjipt, Bangladesh, Pakistan dhe Nigeri) bazuar në modelin e gravitetit duke përdorur të dhënat panel të periudhës 1990-2007. Rezultatet treguan se PBB-ja, kursi i këmbimit, popullsia e vendit eksportues, vendet kufizuese dhe distanca ndërmjet vendeve janë faktorët që ndikojnë në volumin e eksporteve. Zhvlerësimi i monedhës mund të rritë rrjedhjen e tregtisë në vendet anëtare kur efektet e tjera të pafavorshme merren në konsideratë. Gjithashtu diferenca në madhësinë e ekonomisë së vendeve rezultoi e rëndësishme.

Mohammad (2010) eksploroj determinantët afatgjatë dhe afatshkurtër që ndikojnë në defiçitin tregtar në Pakistan gjatë periudhës 1975-2008, duke përdorur qasjen e integritit të Johansen dhe ECM. Rezultatet e studimit treguan se të ardhurat nga jashtë, investimet e huaja direkte, konsumi i brendshëm dhe kursi real efektiv i këmbimit, ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në defiçitin tregtar.

Chua dhe Sharma (1998) investiguan dinamikën e importeve dhe eksporteve ndaj ndryshimeve në çmimet e brendshme, çmimet e jashtme dhe normën reale të këmbimit për Korenë, Filipinet,

Singaporin dhe Tajlandën. Për të studiuar marrëdhënien afatgjatë dhe dinamikat afatshkurtra të këtyre variablave, u përdor modeli i autoregresionit dhe i integritetit Johansen. Rezultatet treguan se pothuajse në të gjitha rastet çmimet e brendshme dhe të jashtme kanë një ndikim më të madh në tregti sesa norma reale efektive e këmbimit.

Një tjetër studim vjen nga Kina e largët por tepër e rëndësishme referuar sufiçitetit tepër të lartë në bilancin tregtar. Xin(2012) analizoi determinantët ekonomik, politik, social dhe kulturor që ndikonin në bilancin tregtar të Kinës. Për të realizuar analizën empirike ai zhvilloi një qasje të integruar me shumë dimensione të bazuar në literaturë. Modeli ekonometrik tregoi ekzistencën e ekuilibrit afatgjatë mes bilancit tregtar dhe të ardhurave të brendshme, të ardhurave nga jashtë, normës së këmbimit dhe IDH-ve. Rezultatet treguan se ndryshimet në bilancin tregtar të Kinës janë të dominuara kryesisht nga lëvizjet e të ardhurave brenda dhe jashtë. IDH-të kanë ndikim në bilancin tregtar në afatshkurtër por në afatgjatë ndikimi nuk është i rëndësishëm. Norma reale efektive e këmbimit e cila përfaqëson efektin relativ të çmimeve nuk ka ndikim të rëndësishëm në bilancin tregtar as në afatshkurtër dhe as në afatgjatë.

Lardy (1996) ka studiuar ndikimin e investimeve të huaja direkte në bilancin tregtar të Kinës duke përdorur modelin “pooled ols”. Ato kanë konkluduar se investimet e huaja direkte kanë një ndikim të rëndësishëm në ekspansionin e eksporteve dhe në rritjen ekonomike të vendit.

Liew, Lim dhe Hussain (2003) kanë realizuar një studim në vendet e ASEAN-it (Association of South East Asian Nations) dhe ka gjetur se bilanci tregtar i vendeve që kanë ndryshuar kursin real efektiv të këmbimit dhe jo ato që kanë ndryshuar kursin nominal të këmbimit. Gjetjet e këtij studimi sugjerojnë se bilanci tregtar është një komponent kryesor i llogarisë korrente dhe rrjedhimisht i bilancit të pagesave të vendit dhe stabilitetit makroekonomik të vendit.

Elmorsy (2015) identifikoi variablat më efektiv dhe të rëndësishëm që përcaktojnë intensitetin e tregtisë së Egjiptit me vendet e COMESA-s (tregu i përbashkët i Afrikës lindore dhe jugore). Për të realizuar studimin, u përdor modeli i gravitetit dhe indeksi i intensitetit të tregtisë. Rezultatet e studimit treguan se ka mundësi për të rritur tregtinë egjiptiane me COMESA-n dhe se PBB-ja dhe ekzistenca e ndarjes së kufijve janë variablat më efektiv që përcaktojnë tregtinë e Egjiptit.

Po kështu, Kennedy (2013) investigoi determinantët kryesorë që ndikojnë në bilancin tregtar në Kenia gjatë periudhës 1963-2012. Ai eksploroj determinantët afatgjatë dhe afatshkurtër të deficitit tregtar duke përdorur qasjen e integritit të Johansen dhe ECM-së (Error Correction Model). Rezultatet e studimit treguan se koeficientët e bilancit tregtar janë të lidhur pozitivisht me deficitet buxhetore, investimet e huaja direkte dhe kursin e këmbimit. Investimet e huaja direkte kanë efekt pozitiv në bilancin tregtar sepse bilanci tregtar në Kenia është negativ. Gjithashtu rezultatet treguan se çmimet e kursit real të këmbimit përmirësojnë bilancin tregtar në mënyrë të fortë dhe të rëndësishme. Kjo mund t'i atribuohet një bilanci tregtar shumë negativ apo pozicionit pozitiv të investimeve të huaja direkte të cilat janë një tregues se bilanci tregtar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të kursit real të këmbimit.

Ray (2012) realizoi një studim ku ekzaminoi rolin e disa determinantëve si norma reale efektive e këmbimit, konsumi i brendshëm, investimet e huaja direkte dhe të ardhurat nga jashtë në bilancin tregtar të Indisë gjatë periudhës 1973-2011. Për të realizuar studimin përdori disa modele ekonometrike si qasjen e integritit të Johansen, ECM (Error Correction Model) dhe OLS (Ordinary Least Squares). Rezultatet treguan se investimet e huaja direkte dhe të ardhurat nga jashtë kanë një lidhje të rëndësishme pozitive në bilancin tregtar, ndërsa konsumi i brendshëm dhe kursi real efektiv i këmbimit ndikojnë negativisht në bilancin tregtar në Indi.

Duasa (2007) ekzaminoi marrëdhënien afatshkurtër dhe afatgjatë ndërmjet bilancit tregtar, normës reale të këmbimit, të ardhurave dhe ofertës së parase në Malajzi gjatë periudhës 1974-2003. Ajo përfshiu në studim të ardhurat dhe ofertën e parave për të ekzaminuar qasjen monetare dhe absorbuese të bilancit të pagesave përveç qasjes tradicionale të elasticitetit, duke përdorur normën e këmbimit. Rezultatet treguan se marrëdhënia afatgjatë mes bilancit tregtar, të ardhurave dhe ofertës së parave është pozitive ndërsa mes bilancit tregtar dhe kursit real të këmbimit është negativ.

Shawa dhe Shen (2013), realizuan një studim mbi determinantët kryesor që ndikojnë në bilancin tregtar të Tanzanisë gjatë periudhës 1980-2012, duke përdorur modelet ekonometrike në E-view 7. Determinantët që u morën në studim ishin investimet e huaja direkte, zhvillimi i kapitalit human, konsumi i brendshëm, shpenzimet qeveritare, inflacioni, gjendja e burimeve natyrore,

norma reale e këmbimit, të ardhurat nga jashtë dhe liberalizimi i tregtisë. Rezultatet e studimit treguan se të gjithë determinantët e marrë në studim kishin lidhje pozitive me bilancin tregtar.

Silwal (2008) realizoi një studim për të parë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në bilancin tregtar në Nepal. Ai u bazua në analizimin e të dhënave të periudhës 1976-2004. Nga analiza rezultoi se si faktorët e brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm, ndikojnë në bilancin tregtar të Nepalit. Në mënyrë të veçantë, kërkesa dhe ndryshimet e çmimeve në ekonominë e mëdha të botës kanë treguar ndikime të pashmangshme në bilancin tregtar. Ndër të tjera, pengesat e brendshme si mungesa e konkurrencës, aspetet gjeografike, politikat ekonomike dhe marrëveshjet dy palëshe me partnerët e jashtëm, janë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e drejtimit të bilancit tregtar. Nga kjo analizë nuk rezultoi lidhje e fortë mes deficitit buxhetor, ofertës së parave, kursit real të këmbimit dhe rritjes ekonomike me bilancin tregtar në Nepal.

Khan dhe Hossain (2012) analizuan marrëdhënien ndërmjet determinantëve dhe bilancit tregtar në Bangladesh gjatë periudhës 1980-2005 duke përdorur teknikën e të dhënave panel. Nga analiza rezultoi lidhje pozitive mes determinantëve dhe bilancit tregtar. Një tjetër studim në kontekstin e përcaktuesve të bilancit tregtar të Bangladeshit është realizuar nga (Muktadir-Al-Mukit, Shafiullah, & Sajib , 2013) të cilët kanë studiuar marrëdhënien midis remitancave dhe importeve. Ato kanë përdorur teknikën e kointegrit Johansen dhe analizën e kazualitetit të Gangerit. Rezultatet e studimit kanë treguar se importet e vendit nuk ndikohen nga niveli i remitancave por niveli i importeve influencon nivelin e remitancave. Ato kanë konkluduar se vendi ka një varësi tepër të lartë ndaj imortit dhe rritja e produktivitetit të brendshëm në sektor të caktuar mund të jetë një politikë e përshtatshme për balancimin e situatës.

Jiranyakul dhe Brahmasrene (2002) analizuan ndikimin e normave reale të këmbimit dhe lidhjen e variableve të importit dhe eksportit në Tajlandë me partnerët kryesorë tregtarë. Rezultatet treguan se të ardhurat reale dhe norma bilaterale reale e këmbimit janë përcaktues të rëndësishëm të importit dhe eksportit mes Tajlandës dhe partnerëve kryesorë.

Amoah dhe Antwi (2016) realizuan një investigim empirik të impaktit të normës reale të këmbimit në bilancin tregtar në Gana gjatë periudhës 1980-2012 duke përdorur qasjen e integritit të Johansen dhe analizën e variancës. Gjithashtu u morr në studim dhe impakti i PBB-

së dhe ofertës së parasë në bilancin tregtar. Rezultatet e studimit treguan që në afatgjatë ekziston një lidhje pozitive mes bilancit tregtar dhe normës reale të këmbimit, ndërsa në afatshkurtër ka një lidhje të parëndësishme negative. Gjithashtu edhe për PBB-në në afatgjatë ka një lidhje pozitive ndërsa në afatshkurtër ka lidhje të parëndësishme negative. Ndërsa oferta e parasë ka efekt pozitiv por të parëndësishëm në afatshkurtër.

Edoun, Mufundisi dhe Mbohwa (2015), realizuan një studim empirik ku analizuan ndikimin që ka zhvlerësimi i monedhës në bilancin tregtar në Zimbabve gjatë periudhës 1990-2005 duke përdorur qasjen e integritit Johansen dhe modelin VECM (Vector Error Correction Model). Rezultatet treguan se zhvlerësimi ndikon në përmirësimin e bilancit tregtar dhe ka një marrëdhënie të integruar ndërmjet normës efektive reale të këmbimit dhe bilancit tregtar në afatgjatë. Gjetjet gjithashtu treguan se ekziston një lidhje e drejtë mes bilancit tregtar dhe kursit të këmbimit në afatgjatë dhe se kursi real i këmbimit është një variabël i rëndësishëm në bilancin tregtar dhe se zhvlerësimi do të përmirësojë bilancin tregtar në afatgjatë. Një tjetër studim i realizuar për këtë vend (Caleb, Mazanai, & Netsai L , 2014) është për marrëdhënien e tregtisë ndërkombëtare dhe rritjes ekonomike. Studimi ka përdorur metodën e kointegritit për të parë lidhjen afatgjatë të variablave. Ka rezultuar se tregtia dhe rritja ekonomike janë të kointegruara por marrëdhënia e tyre ndikohet nga stabiliteti i faktorëve makroekonomikë. Hapja tregtare po kështu luan një rol tepër të rëndësishëm në rritjen e tregtisë.

Gzaw (2015), analizoi marrëdhënien afatshkurtër dhe afatgjatë mes bilancit tregtar, të ardhurave, ofertës së parave dhe kursit real të këmbimit në ekonominë e Etiopisë. Për të realizuar studimin u përdor qasja e integritit e Jahansen dhe modeli ECM ku të dhënat u morën për periudhën 1979-2013. Rezultatet treguan se ka një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë mes bilancit tregtar, të ardhurave, ofertës së parasë dhe kursit të këmbimit.

Sunday (2013) analizoi efektet e defiçitit financiar në bilancin tregtar të Nigerisë gjatë periudhës 1980-2008. Ai përdori metodën e serive kohore dhe teknikën VAR-it. Rezultatet treguan se në afatshkurtër ekziston marrëdhënie pozitive midis defiçitit financiar dhe bilancit tregtar (surplus), ndërsa në afatgjatë rritja e defiçitit financiar zvogëlon defiçitin tregtar në Nigeri.

Rincon (1998) ekzaminoi rolin e kursit së këmbimit në përcaktimin e sjelljes afatshkurtër dhe afatgjatë të bilancit tregtar në Kolumbi. Ai përdori një model regresioni i cili përfshinte të ardhurat, paratë dhe qasjen absorbuese të bilancit të pagesave. Proçedura ekonometrike e përdorur ishte qasja e integritit e Johansen dhe qasja e vlerësimit e Juselius. Rezultatet treguan se kursi i këmbimit luan rol të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes afatshkurtër dhe afatgjatë të bilancit tregtar në Kolumbi. Për më tepër, zhvlerësimi përmirëson bilancin tregtar. Gjithashtu rezultatet treguan se në afatgjatë, efekti i zhvlerësimit të kursit të këmbimit në bilancin tregtar rritet nëse shoqërohet me reduktim të stokut të parave dhe me rritje të të ardhurave.

Weliwita dhe Tsujii (2000) analizuan ndikimin defiçitit tregtar në zhvlerësimin e parave në Sri Lanka duke përdorur modelin e dy vendeve gjatë periudhës 1978-1997. Rezultatet treguan se defiçiti tregtar nuk ishte i përgjegjshëm për zhvlerësimin. Jo vetëm bilanci tregtar por as volumi i eksporteve dhe importeve nuk ishin përgjegjës për zhvlerësimin e monedhës. Normat reale të këmbimit nuk ishin në gjendje që të ndiqnin rënien e normave nominale duke treguar vetëm një rënie modeste të normave reale të këmbimit. Inflacioni i lartë ishte shkaku kryesor i dështimit të qëndrimit në të njëjtin nivel të normave reale të këmbimit me ato nominale. Gjithashtu rezultatet treguan se rritja e eksporteve në Sri Lanka është ndikuar pozitivisht nga rritja e të ardhurave në vendet importuese. Zhvlerësimi nuk ka arritur të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e eksporteve. Rritja e të ardhurave të brendshme reale lidhet pozitivisht me rritjen e importeve reale.

Alla, Awad, Mohamed dhe Abdaldaim (2015) shqyrtuan disa nga determinantët ekonomik që ndikojnë eksportet në Sudan. Determinantët e marrë në studim ishin PBB-ja, kursi i këmbimit dhe hapja e tregut dhe të dhënat i përkisnin periudhës 1990-2012. Rezultatet treguan se PBB-ja, norma e këmbimit dhe hapja e tregut kanë lidhje pozitive me eksportin e Sudanit. PBB-ja është përcaktuesi më i rëndësishëm i eksporteve, ndërsa kursi i këmbimit është një nga faktorët kryesorë që pengojnë rritjen e eksporteve.

Nga vështrimi i studimeve empirike të realizuara në vende të ndryshme të botës, mund të themi që determinantët kryesorë që ndikojnë në bilancin tregtar janë PBB-ja, norma reale efektive e këmbimit, oferta e parasë, zhvlerësimi, investimet e huaja direkte, shpenzimet qeveritare, konsumi i brendshëm, inflacioni dhe të ardhurat nga jashtë. Marrëdhënia e këtyre determinantëve

me bilancin tregtar është e ndryshme në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në varësi të periudhës afatgjatë apo afatshkurtër në të cilën merren në studim.

3.3 Evidenca empirike mbi bilancin tregtar të Maqedonisë

Në vijim do të prezantohen evidencat e literaturës mbi përcaktuesit e eksporteve, importeve dhe bilancit tregtar të Maqedonisë. Fillimisht do të ndalemi në elasticitetin e importeve dhe eksporteve si rezultat i të ardhurave të brendshme dhe të ardhurave të vendeve partnere tregtare. Në vijim do të shohim efektin e kursit real të këmbimit dhe teorinë e kurbës J.

3.3.1 Të ardhurat kombëtare, të ardhurat e vendeve partnere tregtare dhe kursi real i këmbimit

Guitierres (2007) ka vëzhguar një ndikim të rëndësishëm të normës reale efektive të këmbimit në bilancin tregtar të Maqedonisë. Kjo autore ka specifikuar se në afatgjatë kërkohet një rritje e produktivitetit relativ të vendit kundrejt vendeve partnere, rialokim të burimeve në sektorët më dinamik të ekonomisë dhe përmirësim të klimës së biznesit për të stimuluar prodhimin e brendshëm dhe eksportin e mallrave.

Petreski & Kostoska,(2009), kanë evidentuar një elasticitet të lartë të eksporteve dhe importeve maqedonase si rezultat i ndryshimit të të ardhurave për frymë. Gjithashtu, sipas tyre, eksportet ndikohen nga lëvizjet e kursit real efektiv të këmbimit (REER) ndryshe nga importet të cilat janë përgjegjëse të disa ndryshimeve të indikatorit të hapjes së vendit ndaj ekonomive të vendeve partnere.

Elasticiteti i bilancit tregtar të Maqedonisë si rezultat i të ardhurave dhe çmimeve është studiuar edhe nga Jovanovic (2012). Ai ka përdorur 3 procedura të ndryshme: metodën e katrorëve më të vegjël (OLS), metodën ARDL (Autoregressive Distributed Lag) dhe teknikën e kointegrimit Johansen. Variablat që janë marrë në studim janë: eksportet reale, importet reale, kërkesa e vendeve partnere tregtare, prodhimi i brendshëm i Maqedonisë, kursi real efektiv i këmbimit dhe çmimet e metaleve dhe prodhimin industrial. Rezultatet e publikuara nga ky studiuues i referoheshin fillimisht problematikës së përdorimi të të dhënave të agreguara. Përdorimi i të dhënave të tregtisë bilaterale rrit numrin e vëzhgimeve dhe sjell rezultate më të besueshme sipas

autorit kryesisht për modelin e elasticitetit të eksporteve. Elasticiteti i eksporteve si rezultat it ë ardhurave është vlerësuar 3.3 ndërsa elasticiteti i eksporteve si rezultat i ndryshimit të çmimit është vlerësuar -0.6. Elasticiteti i importeve si rezultat i ndryshimit të të ardhurave kombëtare ka rezultuar 1.4 duke përdorur të dhënat bilaterale dhe 1.9 duke përdorur të dhënat e agreguara(Jovanovic, 2012).

Vlerësimi i performancës së eksporteve si funksion i të ardhurave të brendshme, popullsia e vendeve partnere dhe të Maqedonisë dhe cikleve të biznesit është studiuar nga (Josheski & Apostolov, 2013). Ato kanë përdorur modelin e gravitetit si model konceptual dhe vendet partnere të zgjedhura janë vendet e Ballkanit. Autorët kanë realizuar vlerësimet me modelin me efekte fikse dhe efekte rastësore dhe ka rezultuar se të ardhurat kombëtare kanë lidhje pozitive me eksportet e vendit. Numri i popullsisë është i lidhur negativisht me nivelin e eksporteve dhe ciklet e biznesit nuk kanë pasur ndikim pozitiv në nivelin e eksporteve maqedonase.

Vehapi & Lutfiu, (2013) kanë realizuar një studim mbi ndikimin e çmimeve relative dhe të ardhurave në nivelin e eksporteve, importeve dhe tregtisë në total për Maqedoninë. Metoda e përdorur për analizën është modeli Thirlwall dhe ARDL dhe të dhënat e studiara janë për periudhën: 1990-2012. Gjetjet e tyre treguan se ka një elasticitet të rëndësishëm të importeve si rezultat i kërkesës së brendshme dhe një elasticitet relativ të eksporteve si rezultat i kërkesës globale (Vehapi & Lutfiu, 2013).

Ndikimi i zhvillimit ekonomik të Maqedonisë dhe vendeve partnere tregtare të tij është studiuar nga Stafai (2016). Studimi është realizuar për periudhën 2003-2014 dhe ka përdorur si variabël të varur deficitin tregtar të matur në milion euro. Metoda e përdorur është metoda e katrorëve me tëvegjël duke përdorur programin SPSS 20. Rezultatet e studimit tregojnë se ka një ndikim pozitiv, statistikisht të rëndësishëm në bilancin tregtar rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare. Po kështu, konform teorisë ekonomike ndikimi i rritjes ekonomike të brendshme ndikon negativisht në bilancin tregtar nëpërmjet rritjes së importeve, por sipas modelit ekonometrik të vlerësuar, efekti i tij nuk ishte statistikisht i rëndësishëm.

3.3.2 Teoria e kurbës J për ndikimin e kursit të këmbimit

Ndryshimi i kursit të këmbimit ka dy efekte bazë në bilancin tregtar nëpërmjet efektit të çmimit dhe efektit në volum. Ndërkohë që zhvlerësimi i monedhës vendase rrit çmimin e importeve në terma të monedhës vendase, po kështu ul edhe çmimin e eksporteve në terma të monedhës së huaj. Si rezultat importet do të bëhen më të shtrenjta dhe eksportet do të bëhen më të lira. Në këto kushte familjet vendase do të blejnë më pak produkte importi dhe të huajt do të blejnë më shumë nga produktet vendase. Niveli i importeve do të bjerë dhe niveli i eksporteve do të rritet duke përmirësuar pozicionin e një vendi në tregtinë e jashtme. Megjithatë ekzistenca e kontratave paraprake të eksporteve dhe importeve, të cilat zakonisht krijohen në avancë bën që efekti i çmimit të veproj më shpejt se efekti i volumit në bilancin (LaI & Lowinger, 2002).

Bazuar në sa më sipër ka besime në literaturën e ekonomiksit ndërkombëtar të cilat tregojnë se marrëdhënia midis kursit të këmbimit dhe bilancit tregtar varion në periudhën afatgjatë dhe në periudhën afatshkurtër. Sipas studiuesve të fushës efekti i menjëhershëm i zhvlerësimit të monedhës është negative në bilancin tregtar por ndodh e kundërta në periudhën afatgjatë. Pra politika e zhvlerësimit të monedhës me fillimisht përkeqëson bilancin tregtar por më pas e përmirëson atë. Sjellja e bilancit tregtar ka formën e shkronjës J dhe prandaj kjo teori ka marrë këtë emër.

Kura J është një fenomen i zhvilluar nga Magee (1973) dhe përshkruan ecurinë në kohë të bilancit tregtar në përgjigje të zhvlerësimit të monedhës. Kjo tregon se do të duhet një kohë e caktuar derisa prodhuesit dhe konsumatorët të informohen dhe të axhustojnë sjelljen e tyre kundrejt situatës së re ekonomike të paraqitur. (Junz & Rhomberg, 1973) kanë identifikuar pesë vonesa kohore midis zhvlerësimit të monedhës dhe impaktit final në bilancin tregtar. Këto vonesa kohore janë: vonesa e njohjes me uljen e çmimeve, vonesa për marrjen e vendimit ekonomik në situatën e re, vonesa e dërgesës, vonesa e zëvendësimit dhe vonesa e prodhimit. Sjellja racionale pas teorisë së kurbës J është e përfshirë në qasjen e elasticiteteve të axhustimeve të bilancit të pagesave. Kjo foksuohet në faktin se elasticiteti i kërkesës për eksporte dhe importe si rezultat i çmimit mund të ndryshoj me kalimin e kohës.

Elasticiteti priret të jetë i ulët në periudhën afatshkurtër dhe duke u rritur në periudhën afatgjatë. Elasticiteti i ulët në periudhën afatshkurtër i atribuohet kontratave të nënshkruara të tregtisë disa muaj në avancë. Këto kontrata duan kohë që të ekzekutohen dhe në këto kushte përgjigja e

volumit të eksporteve dhe importeve do të jetë më e ulët. Empirikisht efektet e zhvlerësimit të monedhës në bilancin tregtar janë zakonisht të ekzaminuara duke përdorur kushtine Marshall-Lerner. Vendet të cilat kanë defiçite në bilancin tregtar shpesh herë këshillohen të përdorin zhvlerësimin e monedhës për të përmirësuar bilancin në tregtin e jashtme. Megjithatë efektiviteti i kësaj politike varet nëse qëndron kushti i Marshall-Lerner. Kushti thotë se për të pasur një politikë zhvlerësimi efektive duhet të shuma e elasticitetit të kërkesës për importe me elasticitetin e kërkesës për eksporte të jetë më i madh se 1.

Evidenca të studimeve empirike mbi kurbën J paraqiten në paragrafin e mëposhtëm ku evidentohet se kemi rezultate të ndryshme nga autrë të ndryshëm për këtë çështje.

Një vështrim mbi literaturën për këtë fushë është zhvilluar nga Bahmani-Oskooee and Ratha (2004). Këto autorë i kanë ndarë studimet në dy grupe: studime të cilët kanë përdorur të dhëna të agreguara për tregtinë dhe studime që kanë përdorur të dhëna të tregtisë dypalëshe. Ato kanë dalë në përfundim se duke përdorur të dhëna të agreguara nuk mund të nxjerrim rezultate të pastra për praninë e efektit të kurbës J si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë.

Nga ana tjetër autorët kanë gjetur se përdorimi i të dhënave të tregtisë dypalëshe ka sjell efekt të favorshëm, të dukshëm në bilancin tregtar por nuk është evidentuar mbështetje e fortë për formën e kurbës J. Studimet janë fokusuar kryesisht në vendet e zhvilluara dhe disa vende në zhvillim në Azi por duke lënë shumë hapsira për vendet në tranzicion. (Bahmani-Oskooee & Kutun, 2009) ka ekzaminuar efektet afatshkurtër dhe afatgjatë për 11 vende të Europës lindore (Bullgari, Kroaci, Republika Çeke, Hungari, Poloni, Rumani, Rusi, Sllovaki, Turqi dhe Ukrainë) duke përdorur të dhëna bilaterale për periudhën 1990-2005. Ato kanë përdorur modelin ARDL dhe testin bound për të testuar kointegrimin dhe modelimin e korrektimit të gabimit që përfshihet në këtë model. Autorët konkluduan në evidencë të kointegrimit në secilin rast por mbështetje për kurbën hipotetike J gjetën vetëm në rastin e Bullgarisë, Kroacisë dhe Rusisë.

Një studim për rastin e Kinës vjen nga (Bahmani-Oskooee & Wang, 2006). Këto autorë kanë studiuar bilancin tregtar të Kinës me 13 partnerë tregtar duke përdorur të dhënat bilaterale për periudhën Q11983-Q12002. Autorët kanë përdorur testin Bound për të matur efektin afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvlerësimit të Renminbi në bilancin tregtar të Kinës. Autorët kanë gjetur se një

zhvlerësim i monedhës ka pasur efekte të rëndësishme në afatshkurtër por nuk ndjek modelin e kurbës J. Po kështu ata kanë konkluduar se zhvlerësimi i monedhës nuk ka efekte në periudhën afatgjatë në më të shumtën e rasteve.

Ekzaminimin e tregtisë së Kinës tashmë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ka realizuar (Narayan, 2006). Ky autor ka përdorur të dhënat mujore nga nëntori i vitit 1979 në shtator të vitit 2002. Me të njëjtën procedurë si paraardhësit edhe ky autorë ka ekzaminuar efektet afatshkurtëra dhe afatgjata duke përdorur testin bound. Autori ka konkluduar se zhvlerësimi i monedhës ndikon pozitivisht në bilancin tregtar të Kinës si në periudhën afatshkurtër dhe në atë afatgjatë. Bazuar në këtë gjetje nuk mund të themi se kemi praninë e efektit të kurbës J.

Ndërkohë Hacker dhe Hatemi-J (2004) kanë ekzaminuar efektet afatshkurtra dhe afatgjata të zhvlerësimit të monedhës në bilancin tregtar të Republikës Çeke, Hungarisë, Polonisë dhe Gjermanisë duke përdorur të dhënat bilaterale mujore përgjatë periudhës gusht 1993-korrik 2002 duke përdorur procedurën e kointegritimit Johansen. Ato kanë gjetur efekte pozitive në periudhën afatgjatë midis bilancit tregtar dhe kursit të këmbimit në tre vende me përjashtim të Hungarisë.

Në studimin e realizuar nga (Nusair, 2013) në 17 vende të CEE, CIS, Vendet e Baltikut dhe Azisë. Qëllimi është të testoj fenomenin e kurbës J në ekonomitë në tranzicion duke përdorur të dhëna mujore nga Janari i vitit 1991 deri në Janarin e vitit 2012. Metoda e përdorur është metoda ARDL dhe testi bound për të matur kointegritimin dhe korrektimin e termit të gabimit. Rezultatet kanë treguar se në shumicën e rasteve zhvlerësimi i monedhës ka efekte afatshkurtëra. Megjithatë efektet afatshkurtra ndjekin modelin e kurbës J vetëm në rastin e Sllovenisë. Efektet afatshkurtra zgjasin deri në periudhën afatgjatë vetëm në rastin e Armenisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës për të cilat mund të themi se ndjekin teorinë e kurbës J.

Nga kërkimet e literaturës së publikuar nuk u evidentua studime nëkëndvështrim të aplikimit të kurbës J në efektin e zhvlerësimit të monedhës për të përmirësuar bilancin tregtar. Kjo sepse politika e ndjekur nga banka qendrore është ruajta e një kursi fiks këmbimi.

Në studimin tonë ne kemi përfshirë kursin efektiv të këmbimit si variabël e cila do të matë efektin e ndryshimit të çmimeve relative në bilancin tregtar të vendit.

3.3.3 Investimet e huaja direkte

Tashmë globalizimi është një fenomen prezent. Bizneset tashmë janë më të hapur ndaj ekonomive të vendeve të tjera dhe kryejnë transaksione edhe më gjerë por edhe sikur ato të mos kishin një frymë proaktive shumë shpejtë do të largoheshin nga tregu. Realizimi i operacioneve në vendet të cilat kanë faktor prodhimi më të lirë tashmë është një fenomen që është prezent si në korporatat më të mëdha botërore por edhe në ato më të vogla, të cilat konsiderojnë realizimin e proceseve të prodhimit apo shërbimit ndaj klientit në venet e tjera. Pikërisht ky ekspansion i operacioneve përbën investimet e huaja direkte. Investimet e huaja direkte tashmë janë një instrument i rëndësishëm për konkurrencën mbarëbotërore.

Ka shumë përkufizime për investime të huaja mirëpo nga OECD-ja është një investim i drejtpërdrejtë i huaj llogaritet si investim kapital apo financiar me minimum 10 % pronësi në një firmë të huaj. Investimet mund të jenë në formën e blerjeve të kompanive shtetërore apo private, bërjen e kapaciteteve prodhuese të orientuara për eksport apo investime.

Përfitimet e investimeve të huaja direkte janë të shumta. Në vijim do të paraqesim disa prej tyre. Hapja e vendeve të reja të punë. Investimi në krijimin e kompanive të reja si edhe në procese më bashkëkohore të operacioneve bën një numër i madh i popullsisë vendase të punësohet në këto kompani.

Së dyti, rritja e prodhimit të brendshëm bruto për shkak të rritjes së konsumit, nivelit të eksporteve etj.

Së treti, transferim të teknologjisë. Në shumicën e rasteve kompanitë të cilat janë si rezultat i investimeve të huaja kanë të implementuar teknologjitë më të zhvilluara të proceseve të cilat vijnë nga vendet e origjinës.

Së katërti, rritje e të ardhurave tatimore. Zhvillimi i aktivitetit të bizneseve në vend dhe rritja e nivelit të punëzënies sjell rritje të të ardhurave të qeverisë nëpërmjet tatimeve dhe taksave të bizneseve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Së fundmi, ndikim në bilancin e pagesave. Investimet e huaja direkte janë një zë i rëndësishëm i bilancit të pagesat duke balancuar flukset dalëse të bilancit tregtar.

Po kështu bilanci tregtar paraqet një prej zërave më të rëndësishëm të llogarisë korrente. Rëndësia e saj rrjedh si rezultat i faktit se kjo llogari pasqyron të gjitha marrëdhëniet e vendit me botën e jashtme. Në këtë llogari pasqyrohet fuqia prodhuese e një vendi, fuqia konsumuese e tij,

kërkesa vendore, kërkesa e huaj për produktet e prodhuara në vend, na jep informacion mbi sektorët më frytdhënës dhe më të brishtë të ekonomisë kombëtare (Ademi, 2011).

Duke qenë se bilanci tregtar dhe investimet e huaja direkte janë determinant të rëndësishëm të bilancit të pagesave atëherë studimi i hollësishëm i tyre ka rëndësi të madhe për ruajtjen e bilancës së jashtme të vendit.

Defiçiti tregtar zë masë në 22-29 % të prodhimit të brendshëm bruto ndërsa hyrjet e investimeve të huaja direkte zënë 2-8 % të prodhimit të brendshëm bruto të Maqedonisë. Shohim se këto tregues nuk janë bashkëplotësues me njëri tjetrin. Investimet e huaja lënë një hapsirë të paplotësuar në mbulimin e flukseve dalëse të defiçitit tregtar.

Për Maqedoninë ka rezultuar se IHD-të janë statistikisht të rëndësishme në përcaktimin e bilancit tregtar të vendit megjithëse vlerat e saj janë tepër të vogla. Asetet e sapokrijuara janë shumë më të varura nga inputet e vendeve të huaja se nga inputet e vendit dhe po kështu hyrja e korporatave shumëkombëshe në tregun vendas ka pasur efekt negativ në financat dhe shitjet e kompanive brenda vendit. Gjithsesi në periudhat me vonesa kohore pritet që përfitimet të jenë të konsiderueshme.

Ndikimi i investimeve direkte në vendin pritës varion në varësi të motivit të investimeve, nëse ato janë: efience kërkuese, treg kërkuese, në kërkim të burimeve apo në kërkim të aseteve të zhvillimit strategjik. Investimet e huaja direkte mund të kenë një ndikim shumë të madh në zhvillimin e vendit pritës duke ndikuar në rritjen e eksporteve me anë të rritjes së produkteve konkurruese në tregjet e vendeve të destinacionit të të mirave, në rastin e kompanive investitore të cilat janë efience kërkuese. Nëse vlera e shtuar nga firmat lokale është e lartë atëherë do të kemi një rritje të nivelit të eksporteve edhe sikur produktet ndërmjetëse të importohen nga vendet e tjera (Kastrati, 2013).

Investimet e huaja direkte ndikojnë në përmirësimin e nivelit të eksporteve nëpërmjet transfertave në teknologji dhe përmirësim të aftësive të cilat ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe produktivitetit në vendin pritës. Vlerësimi për indeksin e fluksit të investimeve direkte në gjermani është vlerësuar pozitiv në vlerat 50 % dhe ka kontribuar në rritjen e eksporteve të Maqedonisë si produktet e fabrikuara, ushqimeve dhe pijeve si edhe duhanit(2013). Në një tjetër studim të realizuar nga autori i mësipërm në bashkëpunim me të

tjerë autor (Kastrati, Ramadani, Dana, & Ratten, 2016) ka gjetur se ndikimi i investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik vjen nëpërmjet kanalit të eksporteve. Vendet që zbatojnë regjimin e promovimit të eksporteve kanë përfitim më të lartë se ato që kanë si strategji zëvendësimin e importeve.

(Bucevska, 2014) ka studiuar ndikimin që investimet e huaja direkte kanë mbi eksportet maqedonase dhe turke. Të dhënat janë studiuar duke përdorur metodën “pooled ols” për dy vendet dhe përfshin të dhënat për periudhën 1999-2012. Rezultatet kanë treguar se ka një lidhje pozitive midis nivelit të eksporteve dhe investimeve të huaja direkte në këto vende por efekti nuk është statistikisht i rëndësishëm. Në këtë studim është vlerësuar si statistikisht të rëndësishme impakti i eksporteve të periudhës paraardhëse dhe liberalizimit tregtar.

Megjithëse në literaturë pranohet ndikimi pozitiv i investimeve të huaja direkte në nivelin e eksporteve dhe rrjedhimisht në përmirësimin e pozicionit në tregtinë e jashtme masa e ndikimit varion nga industria. Për të matur pikërisht këtë impakt për industri të ndryshme është realizuar një studim nga Krstevska & Petrovska (2012). Metoda e analizës së përdorur është regresioni i të dhënave panel duke marrë parasysh efektet e industrive të ndryshme të ekonomisë. Databaza përfshin të dhënat nga 2002 deri në 2007 dhe nga vlerësimi i modelit a rezultuar se rritja me 1 % e investimeve të huaja direkte të periudhës paraardhëse shoqërohet me rritje me 0.39 % të eksporteve në periudhën korrente (Krstevska & Petrovska, 2012).

Literatura thekson ndikimin pozitiv të investimeve të huaja direkte në zhvillimin ekonomik por ka studime që janë më konservative duke theksuar ndikimin në afatshkurtër të bilancit të pagesave, efektet e monopolizimit të tregut të brendshëm dhe ndikimin që investimet e huaja direkte mund të kenë në aftësinë e përgjithshme të shtetit për qeverisjen e vendit (World Trade Organisation, 1996). Po kështu një impakt negativ mund të ketë edhe fakti se shumica e produkteve mund të importohen nën regjimin e përpunimit në vijim dhe më pas konsumohen në tregun e brendshëm (Jayakumar, Kannan, & Anbalagan, 2014).

Ndikimi negativ i investimeve të huaja direkte mund të vijë edhe për shkak se në periudhën afatshkurtër investorët e huaj e shohin si treg potencial tregun e brendshëm duke sjellë produkte

për të cilat ekziston kërkesa vendase por më pas efekti i tyre bëhet pozitiv për shkak të rritjes së efektit në kanalet e tjera të sipërpërmendura (Tran & Dinh, 2014).

3.3.4 Remitancat dhe transfertat private

Ekonomia e Maqedonisë është një ekonomi e vogël dhe nuk ka fuqi të mjaftueshme fillestare e cila do të shërbejë si indicia për bum ekonomik të mëvonshëm. Ekonomia ka qenë gjithmonë e varur nga flukset e kapitalit nga jashtë vendit të cilat regjistrohen si flukse në llogarinë korrente dhe në llogarinë financiare të bilancit të pagesave të vendit. Qarkullimi i flukseve nga jashtë mund të vij në formën e transfertave zyrtare nga emigrantët të quajtura remitanca por edhe në formën e transfertave pa kompensim që quhen ndryshe transfertat private. Karakteristikat dhe madhësia e këtyre transfertave kërkojnë vëmendje të veçantë nga studiuesit apo politikëbërësit për të vlerësuar saktë efektet e këtyre transfertave në ekonomi.

Për vendet në zhvillim niveli i remitancave apo transfertave private është i barabartë apo e kalon nivelin e investimeve të huaja direkte dhe qarkullimin e portofolave nga tregjet financiare. Duke pasur parasysh madhësinë e remitancave dhe marjen e tyre nga një numër i rëndësishëm i familjeve në ekonomitë pritëse, kanë efekt të padyshimtë në nivelin makroekonomik, influencimin e çmimeve në tregje dhe ndërveprim në marrëdhëniet midis familjeve, firmave, ndërmjetësuesve financiar dhe qeverisë. Disa vende përfitojnë remitanca që zënë një porcion tepër të rëndësishëm në importet e vendit dhe në prodhimin e brendshëm bruto të tij.

Ka dallime të rëndësishme midis remitancave dhe qarkullimeve të tjera ndërkombëtare. Megjithatë është mjaft e lehtë të studiojmë këto transfertat në të njëjtën mënyrë si ndihma zyrtare apo flukse private të kapitalit, ka evidencë të mjaftueshme të besojmë se këto remitanca sillen në mënyrë të ndryshme dhe rrjedhimisht kanë ndikim të ndryshëm ekonomik. Një përkufizim i pranuar gjerësisht në literaturë për remitancat është se ato janë transfertat personale që nuk bazohen në treg, midis familjeve midis vendeve. Remitancat janë të ndryshme nga ndihmat sepse këto të fundit realizohen nga qeveritë për qeveritë ndërsa remitancat përbëhen nga shuma e transfertave të vogla midis individëve privat. Një tjetër element i rëndësishëm që i veçon remitancat nga ndihmat zyrtare apo nga qarkullimi privat i kapitalit është prezenca e

marrëdhënieve familjare. Ky element është tepër i rëndësishëm për të kuptuar sjelljen e remitancave.

Të ardhurat sekondare të cilat janë në formë të transfertave private midis individëve dhe familjeve ndikojnë në ekonomik në dimensione të ndryshme:

Së pari, politikës fiskale. Transfertat private orientohen kryesisht drejt konsumit duke sjellë flukse të të ardhurave të shtetit nëpërmjet taksave të të ardhurave të vendosura mbi konsumin e familjarëve.

Së dyti, qëndrueshmëri të borxhit. Remitancat mund të sjellin reduktim të riskut të vendit dhe rritje të qëndrueshmërisë së borxhit qeveritar. Përpos rritjes së kursimeve familjare, rritja e rëndësishme e remitancave mund të ndikoj direkt dhe indirekt në bazën e të ardhurave qeveritare duke reduktuar koston e rritjes së të ardhurave.

Së treti, disiplina fiskale. Remitancat mund të reduktojnë iniciativat e qeverive për të mbajtur disiplinën e politikës fiskale. Evidenca empirike tregojnë se qeveritë konsiderojnë avantazhin e hapsirës fiskale që krijohet nga remitancat duke konsumuar dhe duke marrë më shumë borxh.

Së katërti, rritja ekonomike. Remitancat jodomosdoshmërisht shoqërohen me rritje të investimeve të brendshme apo në alokim më eficient të investimeve të brendshme. Përfituesit e remitancave në mënyrë të rëndësishme dhe racionale zëvendësojnë të ardhurat nga remitancat me të ardhurat nga puna dhe duke qenë se puna dhe kapitali janë faktor bashkëplotësues në prodhim norma e akumulimit të kapitalit ndikohet negativisht. Analizat kanë treguar se remitancat nuk kanë efekt statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Së pesti, ndikimi në kursin e këmbimit. Megjithatë remitancat mund të jenë një faktor i financimit të bilancit të pagesave, evidence empirike tregojnë se remitancat janë të korreluara pozitivisht me kursin real të këmbimit. Ka evidence të të ashtuquajturit efekti i sëmundjes gjermane në vendet që përfitojnë remitancat. Politikëbërësit duhet të gjejnë mënyrë të adresojnë humbjet në konkurrueshmëri si rezultat i vlerësimit të ekuilibrit të kursit real efektiv të këmbimit.

Së gjashti, arritja e ekuilibrit në bilancin e pagesave dhe indikatorëve të tjerë makroekonomikë. Flukset hyrëse të transfertave private në vendet në zhvillim kompensojnë defiçitet e larta tregtare. Kjo krijon pozicion të favorshëm për konsolidimin e rezervave të monedhave të huaja. Rezervat valutore janë një instrument shumë i rëndësishëm i bankave qendrore në vendet në zhvillim për të ruajtur kursin e këmbimit kryesisht në vendet të cilat kanë një kurs fiks këmbimi dhe ndërveprimi i bankës qendrore do të jetë më i lartë. Konsolidimi i bilancit të pagesave krijon mundësi për të ruajtur paritetin e fuqisë blerëse dhe ruajtjen e pozicionit të monedhës kundrejt monedhave të tjera.

Studime të ndryshme kanë treguar për rëndësinë e llogarisë korrente në rritjen ekonomike. Kandil dhe Greene (2002) kanë studiuar efektet në prodhimin e brendshëm bruto si rezultat i ndryshimit në llogarinë korrente. Bagnai dhe Manzocchi (1999) kanë gjetur një lidhje të fortë midis rritjes ekonomike dhe defiçitit në llogarinë korrente. Llogaria korrente në Maqedoni dominohet nga dy forca: bilanci tregtar dhe të ardhurat sekondare njëra tregues i rëndësishëm i defiçitit dhe tjetra tregues i rëndësishëm i sufiçitit.

Një numër i konsiderueshëm studimesh në literaturë analizojnë marrëdhënien midis remitancave dhe importeve. Remitancat e dërguara nga emigrantët janë rritur me kalimin e kohës në ekonominë maqedonase. Remitancat kontribuojnë në rritjen ekonomike si edhe në ruajtjen e kursit të këmbimit. Referuar bankës botërore remitancat sigurojnë një burim të rëndësishëm financiar për vendet në zhvillim, kryesisht atyre që janë më të varfra (World Bank, 2005).

Për shkak të burimeve më të larta të financimit nga kapaciteti prodhues remitancat rriten nivelin e importeve apo edhe investon më shumë se kursen dhe kjo është më e rëndësishme për ekonominë më të vogla si rasti i Maqedonisë.

Remitancat luajnë një rol të rëndësishëm në funksionin e kërkesës për importe si në nivelin agregat dhe atë jo agregat kryesisht kur kemi problemin e kursit të këmbimit. Importet maqedonase janë më të larta se eksportet duke rezultuar në një bilanc negativ në tregtinë e jashtme dhe kjo hapësirë mund të plotësohet duke rritur rezervat e kursit të këmbimit nëpërmjet remitancave. Remitancat konsiderohen si një burim i rëndësishëm i kursit të këmbimit për vendet të cilat eksportojnë punën për të paguar detyrimet e importit.

Në vijim të pagesës së importeve, remitancat përdoren për investime productive nga qeveritë, kjo paraqitur nga Salim (1990). Prosperiteti marxhinal i importeve dhe remitancave janë të lidhur pozitivisht me nivelin e importeve (Khan, et al., 2007). Me rritjen e të ardhurave familjare të familjareve emigrante për shkak të remitancave atëherë edhe mundësia për të konsumuar më shumë e tyre rritet duke rritur kështu kërkesën për produkte. Megjithëse ky rregull është në vendet normale i zbatueshëm, në vetet të cilat kanë të ardhura tepër të ulta dhe popullsia të pa zhvilluar nuk do të kemi një rritje të kërkesës për mallrat e importit sepse popullsia nuk do të ketë njohuri dhe qëndrim pozitiv ndaj produkteve të importit.

Nga ana tjetër studiuesit si Paine (1974) kanë argumentuar se rritja e importeve për shkak të remitancave do të jetë e lartë sepse familjet që përfitojnë remitancat do të kenë më shumë njohuri mbi në produktet e huaja dhe standardin e jetesës së këtyre vendeve, fenomen i cili është më i intensifikuar pas kthimit të emigrantit në shtëpinë e tij.

Durand dhe Massey (1992) kanë gjetur se shumica e të ardhurave të emigrantëve është përdorur për konsum sesa për investime produktive. Zaman and Imrani (2005) kanë gjetur po kështu se remitancat nuk kanë ndikim në kërkesën për importe të të mirave të konsumit por kanë ndikim pozitiv në kërkesën për të mirat kapitale apo për lëndën e parë. Adams (2006) ka gjetur se një porcion i ulët i të ardhurave nga remitancat përdoret për ushqim apo të mira të konsumit afatshkurtër ndërsa pjesa më e madhe e tyre për shtëpi, edukim dhe për shërbim shëndetësor.

Glytsos (2005) ka analizuar efektet e remitancave në investime, konsum, importe dhe produkt të prodhuar dhe ka gjetur se efekti i reduktimit të remitancave do të jetë më i lartë se efekti i rritjes së tyre. Në qoftë se remitancat përdoren për investime produktive atëherë rritja e prodhimit do të ndihmojë për të ulur kërkesën në rritje. Në një studim të realizuar nga Barua et al (2007) është konkluduar në një korrelacion negativ midis remitancave dhe inflacionit. Referuar vëzhgimeve që janë bërë në Maqedoni pjesa më e madhe e remitancave shkojnë për konsum duke rritur standardin e jetesës dhe kualitetin e jetës. Kjo tregon se mbas rëndësisë që transfertat private kanë për të mbuluar defiçitin e lartë tregtar, nga ana tjetër ato e thellojnë atë. Duke qenë se pjesa më e madhe e remitancave shkon për familjet të cilat kanë standard të ulët jetese (janë pikërisht

nga këto familje pjesëtarët që emigrojnë) prioriteti i përdorimit të tyre është për konsum dhe më pak për aktivitetet e tjera ekonomike.

Llogaria korrente e Maqedonisë dominohet nga dy forca, bilanci tregtar dhe të ardhurat sekondare. Njëra element i rëndësishëm i defiçitit dhe tjetra element i rëndësishëm i sufiçitit.

Të ardhurat sekondare përfshin përfshin transaksionet midis rezidentëve dhe jorezidentëve për të cilat nuk është realizuar një punë e caktuar apo nuk është dhënë një shërbim. Të ardhurat sekondare kanë arritur në nivelin 18 % duke mbyllur kështu defiçitin tregtar në nivele 75-80 %. Të ardhurat sekondare, të ndjekura nga remitancat stabilizojnë llogarinë korrente dhe bilancin e pagesave. Këto janë një forcë stabilizuese të bilancit të pagesave, rezervat valutore të huaja, kursin e këmbimit dhe indikatorët e tjerë makroekonomikë të vendit. Studimet për destinancionet e remitancave të realizuara në Maqedoni por edhe në të gjithë rajonin kanë treguar se pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave shkon për konsum, të ritin standardin e jetesës dhe kualitetin e jetesës. Rezulton se megjithëse transfertat mbulojnë defiçitin tregtar nga ana tjetër ato e thellojnë atë.

Kjo deklaratë është konfirmuar nga testi i korrelacionit ku është evidentuar lidhje e rëndësishme statistikore midis dy treguesve. Megjithëse studimet të shumta kanë përdorur vetëm remitancat dhe rezervat valutore si dy indikator. Flukset hyrëse në formën e të ardhurave sekondare janë indikatorët më të mëdhenj, pozitiv që konsolidojnë bilancin e pagesave, mbulojnë bilancin tregtar dhe plotësojnë rezervat valutore të vendit.

3.3.5 Defiçitit buxhetor dhe shpenzimet qeveritare

Lidhja midis bilancit tregtar dhe variablave makroekonomike fillon nga identitetet themelore të makroekonomisë, të cilët përshkruajnë anën reale të ekonomisë ashtu si shpjegohet në modelin e absorbimit. Teoria e absorbimit e Keynes-it sugjeron se një rritje e defiçitit buxhetor do të sjell induktim të brendshëm dhe rrjedhimisht ekspansion të importeve duke shkaktuar në këtë mënyrë edhe defiçit në bilancin tregtar dhe llogarinë korrente të vendit.

Ky model përfshinë ndryshore makroekonomike si: konsumi, kursimi, investimet dhe të ardhurat me balancat e jashtme të vendit. Një lidhje pozitive midis buxhetit qeveritar dhe bilancit tregtar

mund të tregohet dhe të mbështetet në kontekstin e një ekonomie të mbyllur të modelit Kejnsianist.

Një defiçit i qëndrueshëm në bilancin tregtar në afatgjatë mund të çojë në një rritje të borxhit të jashtëm dhe më pas në kufizim të funksionizmit të mekanizmit të tregut, zhvlerësim të monedhës dhe ulje të rritjes ekonomike. Ka një literaturë të gjerë e cila shpjegon efektet e disbalancave në variablat makroekonomike.

Fleming (1962)dhe (Mundell R. A., 1963 b) kanë shpjeguar që një rritje në defiçitin buxhetor mund tërritë presionin për rritjen e normave të interesit duke shkaktuar hyrje të kapitaleve dhe vlerësim të kursit të këmbimit i cili më pas sjell rritje të defiçitit të llogarisë korrente.

3.3.6 Ndikimi i krizës financiare, masat fiskale dhe monetare

Ndikimi i krizës financiare globale në ekonominë e Maqedonisë ka qenë mjaft i madh referuar një numër të madh autorësh si (Kabashi, 2013), (Pollozhani, Sadiku , & Demishai, 2011), etj.

Normat e rritjes së prodhimit të brendshëm bruto janë ulur në fund të vitit 2008 e deri në rënie të tyre në vitin 2009. Në vitin 2010-2011 vendi përjetoj një rritje të shkurtër në periudhë për të vazhduar përsëri në rënie në vitin 2012.

Maqedonia ka një ekonomi të vogël dhe të hapur ndaj vendeve të tjera dhe në këto kushte të gjitha krizat të cilat vendet partnere përjetojnë transmetohen në ekonominë e brendshme nëpërmjet kanaleve të ndryshme të transmetimit ku ndër më të rëndësishmit është bilanci tregtar. Ashtu edhe si u pasqyrua në kapitullin e parë pamë një ulje të nivelit të eksporteve dhe importeve në vitin 2008 dhe 2009. Komponentët e tjerë të prodhimit të brendshëm bruto patën ndikim më të zbehtë por me kalimin e kohës edhe ato filluan të binin. Ulja e konsumit rezultoj në deri 4.7 % në vitin 2009 por investimet bruto ishin të pandryshuara deri në 2009 dhe filluan të binin në vitin 2010 në 6.7 % (Kabashi, 2013). Kjo për shkak se investimet e huaja direkte janë shpenzimet kapitale që realizohen me një plan afatgjatë veprimi dhe nuk mund të anulohen për një periudhë të shkurtër kohe për shkak të pamundësisë por edhe për shkak se një vendim i tillë është financiarisht më i mirë.

Efektet e krizës janë ndjerë gjithashtu edhe nëpërmjet kanalit financiar duke qenë se bankat ndjekin një politikë më konservative në kushte të krizave. Rritja e kreditimit zbriti nga 34.4 % në 2008 deri në 3.5 % dhe 7.1 % në 2009 dhe 2010. Po kështu edhe kriza në vendet e eurozonës bëri që individët të ulnin nivelin e dërgesave dhe transfertave për shkak se u ulën përfitimet që ato merrni si edhe për shkak të rritjes së pasigurisë në lidhje me qëndrimin e tyre dhe të ardhmen e vendeve të punës. Kjo gjë ndikoi negativisht në financimin e defiçitit tregtar.

Rritja vjetore e këtyre transfertave u bë negative në tremujorin e fundit të 2007 dhe ato vazhduan të binin në 2008 dhe në fillim të 2009. Këto lëvizje të treguesve bënë që Banka Kombëtare e Republikë së Maqedonisë të ndërmernte një sërë politikash në përgjigje të efekteve të krizës. Ndryshe nga bankat në vende e tjera politika monetare e bankës qendrore ka qenë konservative. Kjo politikë e shtrënguar ka pasur qëllim të mbajë të stabilizuar kursin e këmbimit duke e mbajtur atë të pandryshuar deri në fund të vitit 2009. Pas kësaj periudhe banka ka filluar të liberalizojë politikën e saj në mënyrë graduale.

Banka qendrore ndërhyri në gjysmën e parë të 2009 duke shitur monedhë të huaj në treg me qëllim ruajtjen e kursit të këmbimit.

(Kabashi, 2013) ka realizuar një studim ku ka analizuar kanalet e transmetimit të krizës, duke krahasuar efektin në variablat kryesore makroekonomike të vendit. Ai ka analizuar politikën monetare nga fillimi i krizës deri në fund të 2010 ku efektet ishin më të dukshme. Efektet e krizës janë analizuar duke përdorur qasjen kundërfaktuale, duke ndërtuar skenare hipotetike të lëvizjes së ekonomisë nëse do të mungonte kriza financiare. Më pas këto skenare i ka krahasuar me rezultatet aktuale në mënyrë që të vlerësonte efektet e një elementi të krizës në variablat makroekonomike. Kjo teknikë është teknikë plotësuese e dy teknikave të përdorura nga Jovanovikj dhe Georgievskaja, të cilat kanë përdorur të dhëna mikroekonomike për të analizuar impaktet e krizës dhe Unevskaja Andonova dhe Petkovskaja (2011), të cilët kanë përdorur metodën VAR-it me të dhëna makroekonomike. Kjo metodë është përdorur nga shumë studiues të tjerë për të matur efektet e krizës në Itali apo edhe në Angli. Qëllimi i kësaj teknike nuk është të matë ekzaktësisht efektet në terma monetare por të ofrojë një qasje për të kuptuar kanalet dhe mënyrat se si kriza ka ndikuar aktivitetin ekonomik të vendit.

Rezultatet e analizës kanë qenë në të njëjtën linjë me shumicën e pritshmërive të autorit si rezultat i krizës. Importimi i krizës ishte kanali më i rëndësishëm i transmetimit i cili shkaktoj rënie të prodhimit të brendshëm bruto, ngadalsim të inflacionit dhe ulje të tregtisë së jashtme. Rezultatet kanë konfirmuar rëndësinë e kërkesës së vendeve partnere të jashtme dhe çmimet e jashtme për një ekonomi të vogël të hapur si Maqedonia (Kabashi, 2013).

Humbja e besimit nga ana tjetër ishte një efekt negativ por rëndësia e saj ishte e vogël krahasuar me importimin e krizës. Po kështu edhe analiza e politikës monetare ka treguar se kjo e fundit ka pasur efekt të vogël negativ në nivelin e prodhimit të brendshëm bruto dhe çmimeve midis 2008 dhe 2010. Në fakt duke qenë se fokusi i politikës monetare ishte stabilizimi i presioneve për të mbajtur kursin fiks të këmbimit, mbas vitit 2010 politika monetare ka pasur ndikim pozitiv në rritjen ekonomike (Kabashi, 2013).

Sidoqoftë kjo metodë analize ka edhe disavantazhet e veta. Këto disavantazhe lidhen me arbitraritetin në përzgjedhjen e faktorëve të krizës, analiza është realizuar në lidhje me një model të caktuar i cili nuk ka të inkorporuar efektet e politikës fiskale (Kabashi, 2013).

3.3.7 Politika fiskale dhe monetare si përgjigje pas krizës financiare

Qeveritë e vendeve të prekura nga kriza financiare kanë ndërmarrë një sërë nismash për rritjen e ekonomisë së vendeve ku ato qeverisin. Ekzistojnë teori të ndryshme për rolin e qeverisë dhe masave qeveritare në kushtet e krizave. Ka teori të cilat mbështesin rritjen e shpenzimeve qeveritare për të promovuar rritjen e ekonomisë nëpërmjet rritjes së vendeve të punës dhe aktiviteteve të ndryshme në ekonomi. Megjithatë ka edhe teori të cilat mbështesin faktin se rritja e shpenzimeve qeveritare në fakt ndikon negativisht në rritjen ekonomike duke qenë se fondet nuk përdoren në mënyrë efikase dhe rritet niveli i inflacionit. Qasja Keynesianiste e ekonomisë specifikon se rritja e shpenzimeve publike prodhon efekte pozitive në prodhimin e brendshëm bruto por rritja totale e taksave sjell efekte negative.

Qeveria e Maqedonisë ka përdorur politika ekspansioniste fiskale dhe qasjen Keynesianiste për të kompensuar pjesën e kërkesës për produkte dhe shërbime që janë eksportuesit kryesor, me qëllim rritjen e performancës ekonomike. Në këtë linjë qeveria maqedonase ka ndërmarrë 4 nisma.

Nisma e parë ka filluar në nëntor të vitit 2008 e cila ka vlerën e 330 milion eurove. Paketa përfshin zbritjen e detyrimeve korrente për sigurimin shëndetësor nëse kompanitë do të paguajnë rregullisht për 4 vitet e ardhshme. Së dyti paketa përfshinte fshirjen e interesit të akumuluar për detyrimet e sigurimit shëndetësor nëse kompania paguan principalin e borxhit. Së treti i ofronte kompanive mundësinë për të shtyrë pagesat e detyrimeve të taksave nëse kompania siguronte borxhin me anë garancive nga bankat në masën 100 % ose nëse kompania vendoste kolateral në masën e 250 % tëdetyrimit tatimor. Në vijim ulje të disa taksave, uljen e taksës mbi të ardhurat personale për fermerët individual, transformim të të drejtave nga taksat për qeverinë në aksione të zakonshme në ato kompani ku qeveria ishte aksionar kryesor, reduktim të shpenzimeve qeveritare për festat e fundvitit 2008. Ana negative e këtyre matjeve është sepse ato janë të bazuara në faljen nga ana e qeverisë dhe jo në injeksion direkt të qeverisë në ekonomik apo në asistencë financiare me anë të kredive të buta.

Efektet ekonomike të këtyre masave ishin shumë të ulta dhe për këtë arsye qeveria maqedonase implementoi paketën e dytë të masave kundër krizës financiare. Kjo paketë përfshinte një program investimi të qeverisë maqedonase me një kohëzgjatje prej 8 vjetësh nga 2009 në 2016. Kjo paketë përfshinte përpos të tjerave: projekte rrugësh, infrastrukturën hekurudhore, projekte sportive, energjetike, furnizim me ujë etj. Burimi i fondeve për këtë projekt ishin nga buxheti i shtetit maqedonas dhe kredi nga Bashkimi Europian, Banka Botërore apo institucione të tjera financiare.

Paketa e dytë e ndërmarrë nga qeveria shpesh është konsideruar si një paketë e cila mund të ndërmerret në kushte normale të zhvillimit të ekonomisë dhe se i mungon karakteri për të përballuar sfidën e krizës financiare sepse i mungonin masat antikrizë. Është evidente se mundësitë për të implementuar masa më ekspansioniste në politikën fiskale janë të ulta sepse hapësira fiskale është faktor kufizues së bashku me strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke qenë se këto masa do të ritin në mënyrë të rëndësishme borxhin publik të vendit.

Gjatë tre mujorit të dytë të 2009 qeveria implementoi paketën e tretë anti krizë e cila konsistonte në 70 matës. Këto matës përfshinin ribalancim të buxhetit, mbajtjen e defiçitit buxhetor në kufirin e 2.8 %, mbështetje me anë të kreditimit të bizneseve nëpërmjet Bankës Europiane të

Investimit në masën e 100 milion eurove, nisma për simulimin e eksporteve, programe për kooperim në financimin e projekteve si edhe garantim të huave për investime afatgjata.

Kjo paketë u shoqërua me vonesa të mëdha në implementim, shtyrje në implementimin e rebalancimit të buxhetit si edhe mungesë të kredive afatgjata në denar. Kjo paketë madje u shoqërua edhe me efekte negative në likuiditetin e kompanive.

Paketa e katërt e masave antikrizë përfshinte 24 matje si linjat e kreditimit nga Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Europiane në shumën e 15 milion eurove, rritje të periudhës për mbledhjen e tatimit mbi vlerën e shtuar etj.

Në një vështrim të përgjithshëm të situatës është vlerësuar se ka pasur një mungesë në kohezion dhe mungesë sinergjie të institucioneve kompetente për politikën vitale makroekonomike në Maqedoni fiskale apo monetare. Rritja e normave të interesit në njërin anë dhe kërkesës për likuiditet nga ana tjetër kanë gjeneruar efekte negative për shkak të mungesës së koordinimit.

3.3.8 Defiçiti buxhetor dhe defiçiti tregtar (twin deficits) në rastin e Maqedonisë

Ndërveprimi në ekonomi i qeverisë, nëpërmjet paketave të ndryshme fiskale si kundërpërgjigje e krizës ka tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve për ta analizuar atë në këndvështrim me defiçitin tregtar. Mbas krizës financiare ishte kriza e borxheve në vendet partnere si Greqia e cila tërhoqi përsëri vëmendjen dhe theksoj rëndësinë e studimit të efekteve fiskale në tregtinë e jashtme të vendit. Duke qenë se bilanci tregtar është përcaktuesi kryesor i llogarisë korrente dhe rrjedhimisht faktor i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave dhe stabilitetin makroekonomik, është e rëndësishme të evidentohet lidhja midis dy defiçiteve.

Lidhja midis dy defiçiteve ka ngjallur shumë debate në literaturën makroekonomike. Ndërkohë që lidhja statistikore e rëndësishme është dokumentuar nga një numër i madh studiuesish, efekti shkak-pasojë i politikës fiskale në llogarinë korrente ka hasur shumë debate në literaturë. Studime të shumta janë realizuar mbi këtë çështje kryesisht në ekonominë e zhvilluara. Shumë pak studime gjenden të publikuara për vendet e Europës juglindore dhe asaj qendrore.

Teorikisht lëvizja e llogarisë korrente lidhet me politikë fiskale nëpërmjet ekuacionit të mëposhtëm:

$$CA \equiv (SP-IP) + (SG-IG) + IP$$

Ku me CA paraqitet llogaria korrente; SP është kursimi privat; I janë investimet private; SG janë kursimet qeveritare; IG janë investimet qeveritare dhe IP është interesi i paguar. Bazuar në ekuacionin e mësipërm është zhvilluara teoria e defiqiteve “binjakë” e cila argumenton se defiqite më të larta fiskale nëpërmjet efektit të tyre në kursimin dhe investimin kombëtar çon në një llogari korrente të zgjeruar.

Referuar studimeve teorike të realizuara, politika fiskale mund të shkaktoj efekte direkte në llogarinë korrente duke ndikuar në kërkesën agregate si edhe efekte indirekte duke ndikuar çmimet relative. Në këto kushte defiqitet binjake mund të shpjegohen teorikisht duke përdorur dy marrëdhëniet midis defiqtit buxhetor dhe defiqtit të llogarisë korrente, qasjes së kursit të këmbimit e cila derivohet nga modeli bazëi Mundell-Fleming dha llogaritë e të ardhurave kombëtare si më sipër. Fuqia e ndikimit të të dy mekanismave në llogarinë korrente është e paracaktuar nga karakteristikat e një vendi specifik.

Një vëzhgim i detajuar nga (Ali Abbas , Bouhga-Hagbe , Fatás, Mauro, & Velloso, 2011) kanë përaqitur një pamje të gjerë të metodave empirike të përdorura dhe gjetjet e prezantuara të kërkimeve të ndryshme. Në këto studimi ka një konsensus të pranuar nga të gjithë se politika fiskale ekspansioniste e përkeqësojnë llogarinë korrente. Rritja me 1 pikë përqindje e defiqtit si raport i PBB-së sjell rritje të defiqtit të llogarisë korrente me 0.2 deri në 0.7 pikë përqindje kundrejt PBB-së. Këto studime janë realizuar në vendet e zhvilluara duke përdorur databaza të gjera të të dhënave në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim duke përdorur metoda të ndryshme ekonometrike si regresionet me të dhëna panel, modelin VAR dhe VEC. Rezultatet e studimeve kanë treguar po kështu se përmirësimi i bilancit fiskal me 1 pikë përqindje kundrejt prodhimit të brendshëm bruto në këto vende sjell përmirësim të bilancit të llogarisë korrente me 0.3 deri në 0.4 pikë përqindje kundrejt prodhimit të brendshëm bruto. Ky efekt është më i lartë në vendet nëzhvillim sesa në vendet e zhvilluara. Vendet të cilat kanë të ardhura më të ulta, kurse fleksibile

të këmbimit dhe nivel të lartë të hapjes tregtare si edhe nivel të lartë të borxhit publik mbi 90 % të PBB-së(Stojcevska & Miteski, 2016).

Në literaturën e fundit empirike është përdorur teknika VAR (vector autoregressive) për të matur efektet e shokëve fiskale në bilancin tregtar dhe kursin real të këmbimit. (Monacelli & Perotti, 2007) kanë përdorur modelin SVAR për të analizuar efektet e politikës fiskale, me një theks në shpenzimet qeveritare në bilancin tregtar dhe në kursin real të këmbimit në vendet e OECD-së. Kërkimet e tyre kanë konfirmuar ekzistencën e defiçiteve binjake në të gjithë vendet me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pra, për këto vende rezultoi se një rritje në shpenzimet qeveritare sjell rritje të defiçitit të bilancit tregtar dhe në zhvlerësim të kursit real efektiv të këmbimit. Edhe studiuesit (Corsetti & Müller , 2006) janë fokusuar në këto vende duke përdorur të njëjtën metodologji. Ato kanë studiuar përgjigjet e bilancit tregtar si rezultat i ndryshimeve në buxhetin qeveritar midis vendeve me hapje të ndryshme tregtare.

Rezultatet kanë qenë të ngjashme me ato të(Monacelli & Perotti, 2010), por duke shtuar se ndikimi i shokut fiskal në bilancin tregtar është më i lartë në ato vende që kanë nivel më të lartë të hapjes tregtare si Kanadaja apo Mbretëria e Bashkuar. Ato kanë gjetur gjithashtu se ndikimi i shokëve fiskal është më i lartë nëse këto të fundit janë persistente. Duke përdorur këtë metodë në ekonomitë e vogla si Izraeli studiuesit Mazar dhe Garan(Mazar & Haran, 2012) kanë prezantuar se një shok pozitiv me 1 % të PBB-së në konsumin publik rrit importet neto me 0.6 % të PBB-së.

Siç pamë më sipër ekzistencën e studimeve të cilat dëshmojnë ekzistencën e defiçiteve binjak kemi edhe studime të cilët janë të mendimit të kundërt me ekzistencën e fenomenit të defiçitit binjak. (Kim & Roubini, 2008) kanë studiuar vetëm rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bazuar në modelin VAR. Ato kanë studiuar ndikimin e shokëve të defiçitit të buxhetit të shtetit në llogarinë korrente dhe në kursin real të këmbimit përgjatë periudhave me regjime të kurseve fikse të këmbimit. Në kundërstim me modelin teorik, rezultatet kanë treguar se politika fiskale ekspansive përmirësojnë bilancin e llogarisë korrente dhe zhvlerësojnë kursin e këmbimit. Ky është një rast i divergjencave në defiçite e cila është e vlefshme për SHBA-të. Ato kanë shpjeguar se llogaria korrente rregullohet duke ndjekur modelin Rikardian të kursimit privat dhe efektin “crowding-out” si rezultat i rritjes së normës reale të këmbimit.

Në rastin e Maqedonisë (Stojcevska & Miteski, 2016) është realizuar studimi duke përdorur metodologjinë VAR. Rezultati kryesor empirik ka dëshmuar një lidhje pozitive midis bilancit tregtar dhe atij fiskal. Pra, ka lidhje të rëndësishme midis dy defiçiteve. Megjithëse kjo lidhje paraqitet më e dukshme në ato tremujor ku kemi pasur shok të defiçitit buxhetor duke sugjeruar se politika fiskale ndikon në bilancin e pagesave vetëm në një kohë të shkurtër. Kjo tregon se një politikë fiskale ekspansive apo e shtrënguar përkthehet domosdoshmërisht në lëvizjen e bilancit të pagesave të vendit në periudhën afatgjatë.

3.4 Përmbledhje e rishikimit të literaturës

Në këtë pjesë të punimit u paraqit një vështrim mbi literaturën e determinantëve të bilancit tregtar duke filluar me teoritë e tregtisë ndërkombëtare, teoritë mbi përcaktuesit e bilancit tregtar, disa studime të realizuara në botë mbi përcaktuesit e bilancit tregtar dhe në fund studime specifike për Maqedoninë në kuadër të eksporimit të faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë bilancin tregtar të vendit.

Në mënyrë të përmbledhur ne pamë se teoritë kryesore të tregtisë ndërkombëtare janë 5 momente kohore tepër të rëndësishme të tregtisë ndërkombëtare. Teoria merkantiliste dhe kritikën e David Hume e Adam Smith, Teoritë Klasike të tregtisë: Teoria e Adam Smith, Modeli i David Rikardos, Teorinë moderne të tregtisë: Heckseh- Ohlin si edhe Teoritë e Reja të tregtisë që shpjegojnë zhvillimin e tregtisë në ditët e sotme.

Po kështu teoritë që përcaktojnë bilancin tregtarë janë 4 modele kryesore të shpjegimit të bilancit tregtar: modeli i produktivitetit, model i të ardhurave, model i çmimeve relative dhe pikëpamja monetare e bilancit tregtar.

Qeveria maqedonase veprimi sipas qasjes Kejnsianiste për t'ju përgjigjur krizës financiare. Rritja e shpenzimeve qeveritare dhe ulja e taksave ishin dy metodat kryesore. Masat që qeveria maqedonase ndërmoi në kuadër të zbutjes së efekteve të krizës financiare konsistojnë në implementimin e 4 paketave. Paketa e parë përfshinte kryesisht masa të cilat zbusnin detyrimet tatimore të bizneseve dhe bazoheshin kryesisht në faljen që qeveria u bënte detyrimeve të ndryshme. Paketa e dytë përfshinte një program afatgjatë investimi të ndërtimit të rrugëve dhe projekteve të ndryshme publike por jo paketë u kritikua për shkak të mungesës së matësve të drejtpërdrejtë në ndikimin në ekonominë e vendit që do të korrigjonte efektet e krizës. Paketa e

tretë përfshinte masa si: rebalancim të buxhetit, mbajtjen e defiçitit buxhetor në kufirin e 2.8 %, mbështetje me anë të kreditimit të bizneseve, simulimin e eksporteve etj. Kjo paketë u kritikua për vonesa apo edhe efekte negative në likuiditet. Paketa e katërt përfshinte aksesim të linjave të kreditimit, rritjen e periudhës për shlyerjen e borxheve etj. Faktori kushtëzues i efektivitetit të masave të politikës fiskale dhe monetare ishte mungesa e koordinimit midis institucioneve politikëbërëse dhe politikëzbatuese.

Mbështetur në teoritë e sipërpërmendura, duke mbajtur në vëmendje edhe gjetjet studimeve të mësipërme specifike për Maqedoninë ne do të vijojmë me kapitullin e metodologjisë. Ky kapitull do të pasqyrojë fillimisht kuadrin konceptual të kërkimit dhe ndryshoreve që do të përdoren në studimin tonë, dhe llojin e metodës ekonometrike të përdorur.

Kapitulli 4: Metodologjia e kërkimit, të dhënat dhe procedurat statistikore

Në pjesën në vijim të studimit do të pasqyrojmë metodologjinë e përdorur për realizimin e këtij punimi. Fillimisht është paraqitur kuadri i kërkimit nëpërmjet formës teorike të modelit që është vlerësuar. Është vlerësuar po kështu edhe shenja e pritur nga secila variabël e studimit.

Në seksionin e dytë të kapitullit prezantohen procedura e mbledhjes së të dhënave të studimit si edhe është pasqyruar lista e shkurtimeve të përdorura për ndryshoret. Po kështu janë pasqyruar edhe definicionet e secilës ndryshore.

Seksioni i tretë i kapitullit pasqyron një vlerësim teorik i procedurës statistikore dhe ekonometrike që do të përdoret për të testuar hipotezat e studimit dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura. Fillimisht do të bëhet një prezantim i teknikave përshkruese të serive për të diskutuar lidhjen midis variablave si edhe do të prezantohet modeli ARDL (Autoregressive Distributed Lag). Këtu do të bëhet një vështrim historik i kësaj teknike, qëllimi i përdorimit si edhe me kushtet që duhen plotësuar me qëllim përdorimin e kësaj metode.

4.1 Kuadri i kërkimit

Kuadri i kërkimit është një mekanizëm i cili sugjeron se cilët faktorë do të merren në studim për të vlerësuar impaktin e tyre ndaj bilancit tregtar.

Modeli empirik që do të vlerësojmë në këtë studim ka për qëllim të matë ndikimin e variablave makroekonomik të interesit si rritja ekonomike e Maqedonisë, rritja ekonomike e vendeve partnere (Gjermani, Serbi dhe Greqi), kursi efektiv i këmbimit (REER), investimet e huaja direkte si % e PBB-së, transfertat private si % e PBB, remitancat si % e PBB-së, konsumi familjar dhe shpenzimet qeveritare dhe defiqiti buxhetor në raportin e mbulimit të importeve nga eksportet maqedonase.

Konkretisht modeli ekonometrik i vlerësuar është:

$$EX/IM = C + \beta_1 RPBB \% + \beta_2 RPBBPT\% + \beta_3 REER + \beta_4 IHD \% \text{ of } PBB + \beta_5 REM + \beta_6 TRPR + \beta_7 C\% \text{ PBB} + \beta_8 D/S \text{ BUXHETOR } \% \text{ PBB} + \beta_9 G \% \text{ PBB} + \beta_{10} INF + \mu$$

EX/IM: Raporti i mbulimit të importeve nga eksportet. Vlerat e raportit variojnë nga 0 në 1 dhe sa më afër vlerës 1 aq më shumë mbulohen importet nga eksportet dhe aq më i vogël është

defiçiti tregtar i vendit. Zakonisht, bilanci tregtar matet si diferencë e totalit të eksporteve dhe totalit të importeve. Në këtë studim ne kemi marrë raportin e mbulimi të importeve nga eksportet sepse për shkak se ky tregues është përzgjedhur nga shumë studime të cilat janë bërë për matjen e përcaktuesve të blancit tregtar si në studimet (Bahmani-Oskooee & Brooks, 1999), (Onafowora, 2003), etj. Ky raport është më i preferuar se eksportet neto sepse ai nuk është i ndjeshëm nga njësia matëse dhe mund të interpretohet si bilanc nominal dhe real (Bahmani-Oskooee M. , 1991).

RPBB%: Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto të Maqedonisë e shprehur në % ndaj periudhës paraardhëse.

RPBBPT%: Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendeve partnere tregtare (në studim janë marrë Gjermania, Serbia dhe Greqia për shkak të ndërveprimit më të lartë tregtar të Maqedonisë me këto vende. Treguesi është i shprehur në % ndaj periudhave paraardhëse të tij.

REER: Kursi real efektiv i këmbimit i monedhës maqedonase kundrejt monedhave të tjera e azhustuar me raportin e çmimeve midis vendeve. Ky tregues shërben për të matur ndikimin që ka kursi i këmbimit në raportin e mbulimit të importeve nga eksportet.

IDH %PBB: Investimet e huaja direkte si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto

REM%PBB: Remitancat e dërguara nga emigrantët si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto.

TRPR%PBB: Transfertat Private si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

C% PBB: Konsumi familjar si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

D%SBUXHETOR/PBB: Defiçiti/Sufiçiti Buxhetor si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

G%PBB: Shpenzimet qeveritare si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto

INF: Norma e Inflacionit të Maqedonisë

μ : termi i gabimit të regresionit

Vlerësimi i ndryshoreve të mësipërme është realizuar duke konsideruar vetëm ndryshoret makroekonomike të specifikuara në literaturë, paraqitur në kapitullin 3.

4.2 Të dhënat e studimit

Të gjitha të dhënat e përfshira në studim janë mbledhur në baza 3 mujore për shkak se provat për vlerësimin e regresionit me të dhëna vjetore rezultuan të pasuksesshme për shkak të numrit të ulët të vëzhgimeve të përfshira në studim.

Mbledhja e të dhënave u realizua duke përdorur databazat e të dhënave publike shtetërore. Konkretisht janë marrë të dhënat nga Instituti i Statistikave maqedonase, databaza e të dhënave e OECD (për Gjermaninë dhe Greqinë) dhe Instituti i Statistikave të Serbisë.

Table 3: Informacion mbi variablat e studimit

Variabla	Burimi	Përkufizim i matjes
EX/IM	Instituti i statistikave të Maqedonisë	Paraqet mbulimin e importeve nga eksportet
RPBB%	Instituti i statistikave të Maqedonisë	Rritja ekonomike tremujore e shprehur në % ndaj periudhës paraardhëse
RPBBPT%	OECD Instituti i Statistikave të Serbisë Kalkulime të autorit	Paraqet një mesatare të rritjes ekonomike të partnereve tregtar të Maqedonisë për periudhën 2003-2015 (Gjermani, Greqi, Serbi)
REER	Banka Kombëtare e Republikës maqedonase	Kursi real efekti i këmbimit është një matës, i mesatarizuar me peshat e tregtisë, i kursit të këmbimit kundrejt një grupi monedhash pasi është axhustuar për inflacionin. Ai shprehet si një indeks kundrejt vitit bazë.
IDH	Banka Kombëtare e Republikës maqedonase	Investimet e huaja direkte janë investimet direkte të flukseve të kapitalit në ekonominë që raporton. Ato janë shumë e kapitalit të kompanive, riinvestimeve apo formave të tjera të shumave në kapital.
REM	Banka Kombëtare e Republikës maqedonase	Remitancat janë transfertat personale dhe kompensime nga punonjësit. Transfertat personale përfshijnë të gjitha llojet e transfertave në kesh apo në ndonjë formë tjetër të dhënë apo e marrë nga rezidentët kundrejt apo nga jorezidentët. Kompensime të punonjësve janë të ardhurat apo

		kompensime të tjera që punonjësit marrin në vendet ku ato nuk janë rezident.
TRPR	Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë.	Transfertat korrente janë transfertat e të ardhurave midis rezidentëve të vendit dhe pjesës tjetër të botës të cilat nuk mbajnë provizione për ripagesa. Tranfertat neto nga jashtë që nuk vijnë për shkak të punës apo veprimtarive të tjera shpërblyese.
C/PBB	Instituti i Statistikave të Maqedonisë	Konsumi final familjar i njohur edhe si konsumi privat është vlera e tregut e të gjitha të mirave dhe shërbimeve duke përfshirë produkte që zgjasin në kohë si makina, makina larëse apo edhe kompjuterë të blera nga familjet.
D/S Buxhetor	Banka Kombëtare e Republikës maqedonase	Defiçiti apo Sufiçiti buxhetor janë të ardhurat duke përfshirë edhe grantet minus shpenzimet dhe blerjet e aktiveve jofinanciare.
G%PBB	Instituti i Statistikave të Maqedonisë	Shpenzimet qeveritare përfshinë të gjitha shpenzimet e qeverisë për blerjen e të mirave dhe shërbimeve duke përfshirë kompensimin e punonjësve. Ky tregues përfshin gjithashtu për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, por jo shpenzime ushtarake të cilat shërbejnë për krijimin e kapitaleve ushtarake të vendit.
INF(CPI)	Instituti i Statistikave maqedonase	Ndryshimi i indeksit të çmimeve të konsumit

Burimi: Autori

Në tabelën e mësipërme u paraqitën të gjitha ndryshoret e marra në studim referuar shkurtimeve të tyre, burimin e marrjes së të dhënave si edhe përkufizimin përkatës të matjes së tyre. Në vijim po paraqesim një tabelë duke përmbledhur shenjat e pritshme të secilës për ndaj bilancit tregtar.

Table 4: Shenja e pritur e ndryshoreve

Nr	Variabla	Shenja e pritur
1	RPBB%	(-)
2	RPBBPT%	(+)
3	REER	(-)/(+)
4	IDH	(-)/(+)
5	REM	(-)
6	TRPR	(-)
7	C/PBB	(-)
8	D/S Buxhetor	(-)
9	G%PBB	(-)
10	INF(CPI)	(-)

Burimi: Autori

Në mënyrë të përmbledhur kemi paraqitur në tabelën e mësipërme shenjën e pritshme të ndryshoreve kundrejt bilancit tregtar.

Ndikimi i rritjes ekonomike të Maqedonisë është pozitiv në kuadër të teorisë se rritja ekonomike sjell të ardhura më të larta për frymë dhe rrjedhimisht nivel më të lartë konsumit sepse ekonomia maqedonase është kryesisht e orientuar ndaj konsumit.

Rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare pritet të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin tregtar sepse të ardhura më të larta të vendeve partnere tregtare do të thotë rritje të tërheqjes së produkteve të prodhuara në Maqedoni në këto vende, kjo do të sillte rritje të eksporteve maqedonase dhe rrjedhimisht përmirësim të bilancit tregtar të vendit.

Ndikimi i kursit real të këmbimit është papërcaktuar referuar gjetjeve të autorëve të ndryshëm. Ndikimi i tij mund të jetë edhe negativ. Teorikisht njëritje e indeksit nënkupton një zhvlerësim i monedhës vendase kundrejt vendeve të tjera nënkupton qëproduktet vendase janë më të lira se ato të vendeve partnere dhe kjo ndikon në përmirësimin e bilancit tregtar. Formula për llogaritjen e REER është si në vijim:

$$REER = \frac{\zeta_h \times K_n^{w_n}}{\zeta}$$

ζ dhe ζ_h janë përkatësisht indeksi i çmimeve të vendit dhe indeksi i çmimeve të vendeve të huaja partnere tregtare. K_n është kursi nominal i këmbimit të monedhës vendase ndërsa W_n është pesha përkatëse tregtare e secilit vend e cila llogaritet sipas formulës së mëposhtme

$$W_i = \frac{X_i + M_i}{\sum_{i=1}^n X_i + M_i}$$

X_i dhe M_i janë vlerat e eksporteve dhe importeve të vendit të i -të dhe $\sum_{i=1}^n X_i + M_i$ është vlera totale e importeve dhe eksporteve të të gjithë vendeve tregtare (pesha e tregtisë së një vendi kundrejt totalit të tregtisë së Maqedonisë).

Një rënie e indeksit të REER-it shpreh një vlerësim të monedhës dhe një rritje e tij shpreh një zhvlerësim të monedhës kundrejt monedhave të vendeve të tjera.

Në tabelën e mësipërme është pasqyruar edhe shenja negative për të nënkuptuar rastet kur një zhvlerësim i monedhës nuk sjell përçim të efektit në nivelin e eksporteve dhe importeve por shoqërohet kryesisht me rritje të inflacionit dhe zhbalancim të treguesve makroekonomikë të vendit.

Ndikimi i investimeve të huaja direkte mund të ketë ndikim pozitiv apo edhe negativ në bilancin tregtar të vendit. Ndikimi pozitiv i referohet teorisë që rritja e investimeve të huaja direkte shoqërohet kryesisht me investime kapitale, rritje të aftësive dhe kapaciteteve prodhuese të vendit dhe rrjedhimisht produkte më konkurruese në tregtinë e jashtme. Megjithëse praktika ka treguar se jo domosdoshmërisht rritja e investimeve shoqërohet me përmirësim të bilancit tregtar. Në kushtet kur një pjesë e rëndësishme e produkteve të ndërmjetëme importohen dhe konsumohen në tregun vendas, kur niveli i zhvillimit të vendit është i vogël si edhe kur vlera e shtuar në vend nuk është shumë e lartë mundet që ndikimi i investimeve të huaja direkte të jetë fillimisht negativ në bilancin tregtar të vendit.

Ndikimi i remitancave dhe transfertave private pritet të jetë negativ sepse Maqedonia është vend ku zhvillimi ekonomik i dedikohet në një masë të madhe konsumit familjar dhe rritja e të ardhurave të disponueshme nga familjarët do të shkojë kryesisht për konsum. Marrja e një database të integruar ku të kontrollohet efekti i remitancave dhe transfertave private kur mbahet i pandryshuar konsumi ka përqëllim pikërisht të mati ndikimin e tyre por që nuk kanalizohet nëpërmjet konsumit.

Ndikimi i konsumit ashtu edhe si u përmend në paragrafin paraardhës është vlerësuar si negativ për bilancin tregtar duke qenë se rritja e konsumit të mallrave kryesisht të importuara nënkupton thellim të defiçitit tregtar.

Ndikimi i defiçitit buxhetor është kryesisht negativ në kushtet kur qeveria merr më shumë borxh duke rritur kështu normat e interesit të cilat shoqërohen me vlerësim të monedhës dhe normalisht ulje të nivelit të eksporteve.

Ndikimi i shpenzimeve qeveritare vlerësohet si negativ sipas kanalit të mësipërm të transmetimit të efektit por edhe një rritje e shpenzimeve qeveritare mund të çojë në rritje të ekonomisë vendase dhe rrjedhimisht në rritje të të ardhurave për frymë të cilat shoqërohen me rritje të importeve me destinacion konsumin familjar.

Ndikimi i inflacionit po kështu vlerësohet negativ sepse rritja e çmimeve vendase nënkupton më shumë mjete monetare për të blerë një produkt të caktuar, pra produkte më pak konkurruese në tregun ndërkombëtar të mallrave.

Më sipër bëmë një paraqitje të pritshmërive kryesore të shenjave të ndryshoreve të studimit dhe përmbledhje e arsyeve teorike për secilin rast.

4.3 Procedura statistikore

Procedura statistikore që është përdorur për t'i dhënë përgjigje pyetjeve konsiston në dy grupe: analizë përshkruese dhe modeli ekonometrik. Informacion më i detajuar i statistikave që do të përdoren do të paraqitet në dy seksionet e ardhshme.

Analiza përshkruese e serive

Statistikat përshkruese që do të përdoren në këtë disertacion janë: mesatarja, mesorja, devijimi standard, minimum, maksimumi, testi Jarque Bera dhe rëndësia statistikore e tij. Në vijim do të përdorim edhe paraqitjen grafike me anë të grafikëve linear të serisë e cila do të shërbej si variabël i varur dhe serive të tjera në çifte dyshe. Qëllimi është të kuptojmë trendin e përgjithshëm të serive, variancën e tyre në kohë dhe çfarë lidhje evidentohet midis dy ndryshoreve grafikisht. Në boshtin horizontal të grafikëve është paraqitur periudha kohore e vëzhgimit të serive ndërsa boshti vertikal është përdorur si në anën e majtë ashtu edhe në anën e djathtë me qëllim që të pasqyrohet në mënyrë të veçantë nga njëra-tjetra dy seritë duke eliminuar

konfuzionin. Është zgjedhur po kështu që të mos kemi ndërprerje të grafikëve duke qenë se ky informacion jo vetëm do të krijonte konfuzion por edhe mund të jepte informacion të gabuar për pikat e prerjes të cilat jo domosdoshmërisht mund të kenë shpjegim ekonomik.

Në vijim të testimit të lidhjes së vëzhguar nëpërmjet grafikëve është realizuar testi i korrelacionit të Pearson.

Formula që përdoret për llogaritjen e koeficientit është si në vijim:

$$\text{Pearson } r = \frac{n \sum xy - (\sum x)(\sum y)}{\sqrt{(n \sum x^2 - \sum x^2)(n \sum y^2 - \sum y^2)}}$$

Koeficienti i korrelacionit shërben për të eksploruar shenjën e lidhjes midis dy variablave të vazhdueshme si edhe fortësinë e lidhjes. Vlerat e korrelacionit marrin vlerat nga -1 në +1 duke treguar lidhje perfekte të zhdrejtë apo të drejtë midis dy serive. Nëse koeficienti merr vlerën 0 atëherë nuk kemi lidhje midis variablave (Barrow, 2009). Llogaritja e koeficientëve të korrelacionit është realizuar në programin statistikor SPSS 22.

Modeli ekonometrik

Pas realizimit të një sërë provave me variablat e studimit u përzgjedh forma e modelit ARDL. Fjala ARDL është akronim i fjalëve: Autoregressive-Distributed Lag. Përdorimi i kësaj teknike është shtuar së fundmi në literaturë si një mjet për testimin e marrëdhënies afatgjatë dhe afatshkurtër midis variablave të ndryshme makroekonomike. Ky model është realizuar nga Pesaran dhe Shin (1995).

Modeli ARDL ka formën bazë teorike si më poshtë:

$$y_t = \beta_0 + \beta_1 y_{t-1} + \dots + \beta_{k_y} y_{t-p} + \alpha_0 x_t + \alpha_1 x_{t-1} + \alpha_2 x_{t-2} + \dots + \alpha_{q_x} x_{t-q} + \varepsilon_t$$

ε : është termi i gabimit i cili është ashtu quajtur “i bardhë” sepse nuk vuan nga problemet e supozimeve të regresioneve.

Modeli është “autoregresiv” në kuptimin që vlerat e periudhës paraardhëse të variabëlitesë të varur ndihmojnë në shpjegimin e vlerave aktuale të tij si edhe përfshin “distributed lag” në kuptim të shpërndarjes së vlerave të variablave të pavarura me disa kohë vonesë.

Përdorimi i modelit ARDL për eksplorimin e marrëdhënieve midis variablave makroekonomike kërkon fillimisht që të vlerësojmë stacionaritetin e serive. Nëse variablat janë të gjitha të stacionare në diferencën e parë por nuk janë të co-integruara përdoret modeli “Unrestricted

ECM”, nëse janë të kointegruara përdoret metoda ECM dhe nëqoftë se kanë më shumë se 1 vektor kointegrimit atëherë përdoret metoda VECM.

Stacionariteti i serive përkufizohet si fenomeni kur një ka mesatare, variancë dhe strukturë autokorrelacioni të pandryshueshme në kohë.

Në rast se variablat mund të jenë të stacionare në nivel dhe në diferencën e parë, apo mund të mos ketë një përfundim të saktë për stacionaritetin e tyre, por me siguri të plotë mund të themi se nuk janë stacionare në diferencën e dytë, mund të përdorim teknikën ARDL.

Vlerësimi i modelit ARDL së bashku me testin “bound” ka përdorime mjaft të mira në praktikë sepse edhe nëse seritë janë stacionare në nivel dhe në diferencën e parë dhe një kombinim të të dyjave, mund të vlerësoj nëpërmjet një ekuacioni marrëdhënien midis variablave dhe duke kuptuar ndikimin e impaktit të serive me vonesa kohore të ndryshme.

Vlerësimi i modelit ARDL kalon në hapat e mëposhtme:

1. Vlerësim i stacionaritetit të serive duke përdorur testin e rrënjës unitare

Përpara se të përzgjidhet modeli ekonometrik i serive kohore që do të përdoret vlerësojmë stacionaritetin e serive. Ekzistojnë dy mënyra për të kontrolluar për stacionaritetin e serive: duke vëzhguar grafikisht dhe duke përdorur testet përkatëse statistikore. Një seri jo stacionare quhet e integruar nëse ajo mund të transferohet me anë të diferencimit të një apo disa herëve në një proces stacionar. Rendi i integritetit është minimum i herëve me të cilat një seri diferencohet deri në arritjen e procesit të stacionaritetit. Nëse një seri është stacionare pa u diferencuar ajo quhet e integruar e rendit zero $I(0)$ ose stacionare në nivel.

Nëse kemi një ekuacion:

$$Y_t = \alpha + \beta Y_{t-1} + u_t$$

$$u_t = \rho u_{t-1} + \varepsilon_t$$

testi i rrënjës unitare teston hipotezat e mëposhtme:

$H_0: \rho = 1$ (ka rrënjë unitare)

$H_a: \rho < 1$ (nuk ka rrënjë unitare)

Në vlerësimin e rrënjës unitare të serive ka vend të rëndësishëm përcaktimi i trendit. Nëse trendi është përcaktues ose i përgjithshëm atëherë seria kthehet në trendin e saj në periudhën afatgjatë, shokë të ndryshme kanë efekt që shuhet me kalimin e kohës dhe varianca e parashikuar është konstante për të gjithë horizontin kohor. Nëse trendi është rastësor atëherë seria nuk kthehet në

vijën e trendit afatgjatë, shokët e ndryshme kanë efekt të përhershëm i cili nuk shuhet me kalimin e kohës dhe varianca e parashikimit rritet për horizonte kohore të gjata. Përcaktimi i trendit është i rëndësishëm sepse ndihmon në vlerësimin sa më të saktë të stacionaritetit.

Hipoteza e mësipërme mund të testohet duke përdorur testin Augmented Dickey-Fuller (ADF). Testi i ADF-it është i vlefshëm në rastet kur supozimi i normalitetit të termit të gabimit qëndron. Në praktikë seritë kohore shpesh karakterizohen nga luhatje në periudhën afatshkurtër në sensin që seritë të cilat nuk kanë trend rregullohen me kalimin e kohës. Modeli i ADF-it e neglizhon këtë rast duke bërë që mbetet të kenë të pranishëm korrelacionin serial duke bërë që vlerat kritike të mos jenë të vlefshme. Përdorimi i teknikës Newey-West për korrektimin e korrelacionit serial, vlera e statistikës t të derivuar quhet testi i Phillips-Perron.

Në testimin e stacionaritetit të serive ne do të përdorim të dy teknikat e testimit të rrënjës unitare me qëllim që të jemi sa më pranë realitetit në vlerësimin e luhatjeve të serive në periudhën afatshkurtër.

2. Përcaktimin e modelit ARDL që do të vlerësojmë dhe vlerësimin e modelit

Forma e modelit ARDL përfshin modelin e korrektimit të gabimit i cili merr formën e mëposhtme:

$$\begin{aligned} \Delta(EX / IM)_t = & \alpha_0 + \sum_{i=1}^p \phi_i \Delta(EX / IM)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \theta_i \Delta(REER)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \lambda_i \Delta(RPBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \varphi_i \Delta(RPBBPT)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p k_i \Delta(IHD\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p l_i \Delta(REM\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p j_i \Delta(TRPR\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p r_i \Delta(C\%PBB)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p o_i \Delta(D / S\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p s_i \Delta(G\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p d_i \Delta(INF)_{t-i} \\ & + \delta_1 (X / M)_{t-1} + \delta_2 REER_{t-1} + \delta_3 (RPBB)_{t-1} + \delta_4 (RPBBPT)_{t-1} + \delta_5 (IHD\%PBB)_{t-1} + \delta_6 (REM\%PBB)_{t-1} \\ & + \delta_7 (TRPR\%PBB)_{t-1} + \delta_8 (C\%PBB)_{t-1} + \delta_9 (D / S\%PBB)_{t-1} + \delta_{10} (G\%PBB)_{t-1} + \delta_{11} (INF)_{t-1} + \nu_t \end{aligned}$$

ku: EX/IM është bilanci tregtar, REER-i: kursi real efektiv i këmbimit, RPBB-ja: rritja e prodhimit të brendshëm bruto, RPBBPT-ja: rritja e prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve tregtar, IHD%PBB: investimet e huaja direkte si përqindje ndaj prodhimit të brendshëm bruto, REM%PBB: remitancat si përqindje ndaj prodhimit të brendshëm bruto, TRPR%PBB: transfertat private si përqindje ndaj prodhimit të brendshëm bruto, C%PBB: konsumi si përqindje ndaj prodhimit të brendshëm bruto, D/S% PBB: defiçiti/sufiçiti buxhetor si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto, G%PBB: shpenzimet qeveritare si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto

dhe INF: inflacioni i matur me CPI-në. Δ është operator i diferencës së parë dhe p është gjatësia e përshtatshme e vonesave kohore që do të futen në model.

Testi F përdoret për të testuar ekzistencën e marrëdhënies afatgjatë. Kur ekziston lidhje afatgjatë testi F tregon se cila variabël duhet të normalizohet. Hipoteza zero për mungesën e kointegrimit midis variablave në ekuacion është

$$H_0: \delta_1 = \delta_2 = \delta_3 = \delta_4 = 0$$

$$H_1: \delta_1 \neq \delta_2 \neq \delta_3 \neq \delta_4 \neq 0.$$

Statistika F ka një shpërndarje jo standarde e cila varet nga: (i) nëse variablat e përfshira në model janë të integruara në nivelin zero apo të integruara në nivelin e parë (ii) numri i regresantëve, dhe (iii) nëse modeli përfshin konstante apo konstante dhe trend.

Nëse vlera e F së vrojtuar është më e lartë se vlera e sipërme kritike, mund të konkludojmë se ka evidencë të lidhjes afatgjatë midis variablave pavarësisht rendit të kointegrimit të tyre. Nëse statistika është më e vogël se kufiri i poshtëm hipoteza zero nuk mund të hidhet poshtë dhe nëse testi është midis vlerës së poshtme dhe të sipërme nuk mund të marrim një vendim të prerë pa njohur rendin e kointegrimit të regresantëve të përfshirë në regresion.

Nëse kemi një lidhje afatgjatë midis variablave atëherë vlerësohet modeli i mëposhtëm i lidhjes afatgjatë:

$$\begin{aligned} (EX / IM)_t = & \alpha_1 + \sum_{i=1}^p \phi_{1i} (EX / M)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \beta_{1i} (REER)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \theta_{1i} (RPBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \lambda_{1i} (RPBBPT)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p \omega_{1i} (IHD\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \mu_{1i} (REM\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \gamma_{1i} (TRPR\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \gamma_{1i} (C\%PBB)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p \gamma_{1i} (D / S\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \gamma_{1i} (G\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \gamma_{1i} (INF)_{t-i} + \mu_t \end{aligned}$$

Specifikimi i ARDL për dinamikat afatshkurtra derivohet duke ndërtuar një model të korrektimit të gabimit si në formën në vijim:

$$\begin{aligned} \Delta(X / M)_t = & \alpha_2 + \sum_{i=1}^p \phi_i \Delta(EX / IM)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \theta_i \Delta(REER)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \lambda_i \Delta(RPBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \phi_i \Delta(RPBBPT)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p k_i \Delta(IHD\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p l_i \Delta(REM\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p j_i \Delta(TRPR\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p r_i \Delta(C\%PBB)_{t-i} \\ & + \sum_{i=0}^p o_i \Delta(D / S\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p s_i \Delta(G\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p d_i \Delta(INF)_{t-i} + \psi ECM_{t-1} + \mathcal{G}_t \end{aligned}$$

Termi i korrektimit të gabimit përcaktohet si në vijim:

$$\begin{aligned}
 ECM_t = & \ln(X / M)_t - \alpha_1 - \\
 & \sum_{i=1}^p \phi_i \Delta(EX / IM)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \theta_i \Delta(REER)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \lambda_i \Delta(RPBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p \varphi_i \Delta(RPBBPT)_{t-i} \\
 & + \sum_{i=0}^p k_i \Delta(IHD\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p l_i \Delta(REM\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p j_i \Delta(TRPR\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p r_i \Delta(C\%PBB)_{t-i} \\
 & + \sum_{i=0}^p o_i \Delta(D / S\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p s_i \Delta(G\%PBB)_{t-i} + \sum_{i=0}^p d_i \Delta(INF)_{t-i}
 \end{aligned}$$

Të gjithë koeficientët të ekuilibrit afatshkurtër janë koeficientët e dinamikave afatshkurtra të modelit drejt konvergjencës në ekuilibër dhe termi ψ paraqet shpejtësinë e axhustimit.

3. Kontroll me anë të testit të korrelacionit serial, heteroskedasticitetit, normalitetit dhe stabilitetin e regresionit

Për të testuar korrelacionin serial do të përdorim testin LM të Breusch- Godfrey, për të testuar heteroskedasticitetin do të përdorim testin Breusch-Godfrey-Pagan ndërsa për testimin e normalitetit është përdorur testi i Jarque Bera. Stabiliteti do të testohet me anë të testit RESET.

4. Realizimi i testit të “Bound” për të matur nëse ekziston një lidhje afatgjatë midis variablave.
5. Vlerësimi i koeficientët afatgjatë dhe afatshkurtër nëse rezultatet e testit Bound tregojnë për ekzistencën e lidhjes.
6. Interpretimi i rezultateve.

Në këtë seksion paraqitëm procedurën statistikore është përdorur për vlerësimin e modelit ekonometrik dhe për testimin e hipotezave.

4.4 Kufizime dhe sugjerime për studimet e mëvonshme

Në vijim do të pasqyrohen kufizimet e studimit dhe sugjerimet respektive për punimet e mëvonshme në këtë fushë:

Harku kohor i marrë në studim përfshin të dhënat të cilat i përkasin periudhës 2003-2015. Për një vlerësim më të mirë të efekteve do të ishte e përshtatshme rritje e databazës apo përdorimi i servie në baza mujore. Modeli mund të vlerësohej vetëm me 2 vonesa kohore (2 tre mujorë) por vlerësimi më i mirë do të ishte i përshtatshëm deri në 2 vite (8 tre mujore) në vonesa kohore.

Aplikimi i tillë kushtëzohej nga mungesa e të dhënave për të gjitha seritë për periudha më të gjata dhe se disa seri publikohen në shpeshtinë 3 mujore.

Përfshirja e teorisë monetare në vlerësimin e regresionit me qëllim matjen edhe të efektit të ofertës monetare në bilancin tregtar. Në vlerësimin e modelit nuk u përfshi treguesit e teorisë monetare në vlerësimin e regresionit dhe në studimet e ardhshme kjo do të ishte një temë me interes.

Analiza të llogarisë korrente dhe bilancit të pagesave do të ishte me mjaft interes. Ky studim është referuar kryesisht në bilancin tregtar të vendit dhe ka prekur rëndësinë e tij në kuadër të llogarisë korrente dhe bilancit të pagesave. Në këto kushte do të ishte mjaft me interes që studiuesit e mëvonshëm të studiojnë në mënyrë empirike determinantët e llogarisë korrente apo edhe që ndikojnë bilancin e pagesave të Maqedonisë.

Përdorimi i të dhënave bilaterale me vendet në vend të të dhëna të agreguara. Për realizimin e këtij studimi janë përdorur të dhëna të agreguara të cilat mund të vuajnë për shkak të problemit të agregimit të tyre. Në literaturë sugjerohet përdorimi i të dhënave të tregtisë bilaterale midis vendeve për të matur më saktë efektin e përcaktuesve të ndryshëm.

Përfshirja e tarifave dhe taksave doganore si faktor regresiv mund të ishte një tjetër sugjerim i vlefshëm me qëllim kuptimin e impaktit të tyre në bilancin tregtar. Vlerësimi i marrëveshjeve tregtare të lidhura me vendet partnere do të ishte një rrjedhim i këtij vlerësimi.

Në këtë punim nuk është vlerësuar efektiviteti i secilës prej marrëveshjeve tregtare që Maqedonia ka lidhur me vendet partnere. Një krahasim i efektivitetit të tyre mund të jetë me interes nga studiuesit e ardhshëm.

4.5 Përmbledhje e metodologjisë

Kapitulli pasqyroj metodologjinë e përdorur për studimin. Në fillim u paraqit forma funksionale e modelit e cila tregoj se variablat të cilat janë marrë në studim janë: variabël i varur EX/IM dhe variabla të pavarura: REER, RPBB%, RPBBPT%, IHD%PBB, REM%PBB, TRPR%PBB,

C%PBB D/S%PBB, G%PBB dhe INF. Konceptimi i modelit është duke përdorur metodën standarde të katrorëve më të vegjël.

Vlerësimi i shenjave të pritura për variablat është cilësuar sipas funksionit të mëposhtëm: IM/EX: $f(-RPBB\%, +RPBBPT\%, -/+REER, -/+IHD\%PBB, -REM\%PBB, -TRPR\%PBB, -C\%PBB, -D/SBUXHET\%PBB, -G\%PBB, -INF)$.

Procedura statistikore e cila është përdorur në këtë disertacion përfshin analizën përshkruese dhe analizën empirike. Analiza përshkruese e përdorur përfshin treguesit e mesatares, modës, devijimit standard, minimumit, maksimumit si edhe paraqitjen grafike në grupe dyshe tëvariabëlilit të intresit EX/IM me variablat e pavarura.

Modeli ekonometrik i përdorur për vlerësimin e ndikimit të secilës seri në bilancin tregtar është modeli ARDL. Ky model është i përshtatshëm në kushtet kur seritë janë stacionare në nivel dhe diferencën e parë apo kur vlerësimi i stacionaritetit të serisë nuk mund të bëhet me besueshmëri të plotë. Kushtet për zbatimin e kësaj procedure janë që asnjë nga seritë të mos jetë stacionare në diferencën e dytë.

Vlerësimi i modelit realizohet në disa hapa: testimi i stacionaritetit, vlerësimi i ekuacionit, testimi i normalitetit, autokorrelacionit, heteroskedasticitetit dhe stabilitetit, testimi i lidhjes afatgjatë të variablave dhe interpretimi i rezultateve.

Kapitulli 5: Analiza empirike

Në këtë kapitull do të prezantohen gjetjet nga analiza e të dhënave të studimit. Fillimisht do të bëhet analiza përshkruese e serive e cila do të konsistojnë në përshkrimin e treguesve kryesor të serive dhe paraqitjen grafike të tyre kundrejt raportit të mbulimit të importeve nga eksportet. Në pjesën e dytë do të prezantohen gjetjet e regresionit. Ky seksion do të prezantoj gjetjet e modelit ekonometrik, vlerësimin e lidhjes afatgjate midis serive dhe lidhjen afatshkurtër, testet e modeleve empirike si edhe diskutimin e gjetjeve të tij.

5.1 Analiza përshkruese e serive, paraqitja grafike dhe lidhja statistikore

Në vijim do të bëhet prezantimi i treguesve përshkrues të serive kohore të studiuara si: mesatarja, mediana, maksimumi, minimum, devijimi standard, treguesit e shmangies së të dhënave nga shpërndarja normale, testi i shpërndarjes normale dhe rëndësia statistikore e tij, shuma dhe në fund numri i vëzhgimeve për secilën seri. Në vijim të treguesve përshkrues të mësipërm do të realizohet pasqyrimi me anë të grafikëve tëvariabëlilit të varur EX/IM me të gjitha variablat e pavarura të modelit. Qëllimi i këtij prezantimi është njohja paraprake me marrëdhënien që ekziston midis ndryshoreve.

Table 5: Treguesit statistikor përshkrues të: EX/IM, REER, RPBB, RPPPT, IHD%PBB dhe REM%PBB

	EX_IM	REER	RPBB_	RPBBPT_	IHD_PBB	REM_PBB
Mesatarja	0.6806	102.1551	3.3962	1.1753	3.773	2.445489
Mesorja	0.6811	101.7925	3.4000	1.4230	2.686	2.44808
Maksimumi	0.8073	110.1578	10.7000	6.4135	21.437	2.892768
Minimumi	0.5080	97.6705	(3.7000)	(5.3228)	(0.818)	2.053919
Dev. Stand.	0.0701	2.7761	3.5960	2.8925	3.761	0.224095
Skewness	(0.3582)	1.0552	0.2479	(0.2120)	2.349	-0.016998
Kurtosis	2.6051	4.0017	2.3697	2.1842	10.801	2.010744
Jarque-Bera	1.4497	11.8244	1.3931	1.8314	179.649	2.122864
Rëndësia Stat.	0.4844	0.0027	0.4983	0.4002	0.0000	0.34596
Shuma	35.39314	5312.068	176.6	61.1141	196.172	127.1654
n	52	52	52	52	52	52

Burimi: Autori

Niveli mesatar i treguesit EX/IM është 0.6806 dhe vlera median e tij 0.6811 (50 % e vlerave janë më të vogla se kjo vlerë dhe 50 % janë më të mëdha se kjo vlerë). Maksimum i mbulimit

tëeksporteve nga importet ka ndodhur në masën 0.8073 dhe kjo ka ndodhur së fundmi, përkatësisht në tre mujorin e tretë të vitit 2015. Vlera minimale e e mbulimit të eksporteve nga importet për këtë periudhë kohore është 0.508 dhe ka ndodhur në 3-mujorin e parë të vitit 2009. Vlerat e serisë kanë shpërndarje normale referuar testit Jarque Bera i cili ka vlerën 1.44 dhe rëndësi statistikore 0.48. Numri total i vëzhgimeve për këtë seri është 52.

Vlerësimi mesatar i REER-it është 102.15, mediana është 101.79 ndërsa minimum dhe maksimumi kanë marrë vlerat 110.15 dhe 97.67 respektivisht. Vlera e Jarque Bera për këtë seri është përkatësisht 11.82 dhe rëndësia statistikore e saj është $0.0027 < 0.05$. Seria nuk ka shpërndarje normale dhe shmangia është shmangie lart shpërndarjes normale, kjo identifikuar nga vlera e kurtosis e cila është 4 (vlera e pranueshme në literaturë për indikatorin “Kurtosis” konsiderohet vlera 3).

Rritja mesatare e prodhimit të brendshëm bruto për Maqedoninë në periudhën e marrë në studim ka qenë 3.39 % dhe vlera median e saj ka qenë 3.4 %. Rritja më e shpejtë ekonomike ka ndodhur në 3-mujorin e dytë të vitit 2015 dhe ka arritur vlerën 10.7. Ritmet rënëse më të larta të ekonomisë kanë qenë në masën 3.7 % në 3-mujorin e tretë të 2009-tës të cilat janë paraprirë me rënie ekonomike edhe në tremujorin e dytë të 2009-tës kjo si rezultat i krizës financiare. Shohim se është dashur 1 vit deri në kalimin e efekteve të krizës financiare në ekonominë e Maqedonisë. Seria e rritjes ekonomike ka shpërndarje normale referuar testit të Jarque Bera: 1.39 dhe rëndësisë statistikore të tij: 0.49. Në total për këtë seri kemi vëzhguar 52 raste.

Rritje më e ulët ekonomike mesatarisht është vëzhguar për vendet partnere tregtare të Maqedonisë. Mesatarja e rritjes ekonomike të tyre është: 1.17 % dhe mediana e treguesit është: 1.42 %. Vlera më e lartë e normës së rritjes ekonomike është vëzhguar 6.4 % në 3-mujorin e katërt të vitit 2004 dhe rënia më e lartë e ekonomisë është vëzhguar: 5.32 % në tremujorin e parë të 2009-tës. Shohim se kemi diferenca në periudhën e arritjes së normës më të lartë të zhvillimit të ekonomisë për Maqedoninë në krahasim me mesataren e vendeve partnere si edhe diferenca në shpejtësinë e përcimit të efektit të krizës financiare. Në venet partnere tregtare (Gjermani, Greqi dhe Serbi) kemi pasur përcim më të shpejtë të efektit të krizës financiare e cila është shoqëruar me rënie të ekonomisë që në 3-mujorin e katërt të vitit 2008. Vlera e testit të normalitetit është

1.83 dhe rëndësia statistikore 0.4. Referuar këtyre dy treguesve, konkludojmë se seria ka shpërndarje afërsisht normale.

Investimet e huaja direkte kanë pasur një normë mesatare 3.77 % të PBB-së. Mediana është në vlerën 2.68 dhe vlera maksimale e treguesit 21.43 % e cila ka ndodhur në 3-mujorin e parë të vitit 2006. Vlera më e ulët e tyre ka ndodhur me një vlerësim negativ të investimeve të flukseve të investimeve të huaja direkte në masën 0.8 % të PBB-së. Kjo vlerë negative e treguesit është vlerësuar në 3-mujorin e tretë të vitit 2012. Vlera negative të % të IHD ndaj PBB-së janë evidentuar në 3-mujorin e katërt të vitit 2009 dhe 3-mujorin e dytë të vitit 2011. Seria nuk ka shpërndarje normale referuar vlerës së testit të Jarque Bera: 179.64 dhe rëndësisë statistikore $0.0000 < 0.05$.

Treguesit përshkruan të serisë së remitançave si përqindje e PBB-së janë si në vijim: Vlera mesatare e treguesit është 2.45 dhe mediana është afërsisht në të njëjtën vlerë me mesataren 2.45. Vlera të afërta të dy treguesve janë indikator të shpërndarjes normale e cila konfirmohet nga testi i Jarque Bera i cili ka marrë vlerën: 2.12 dhe rëndësia statistikore: 0.34. Vlera minimale e treguesit të % të remitançave kundrejt PBB-së është 2.05 dhe vlera maksimale 2.89. Numri total i vëzhgimeve të serisë është 52.

Një indikacion i shpërndarjes së të dhënave nga mesatarja e tyre është devijimi standard i cili është paraqitur në tabelën e mësipërme. Shohim se shpërhapje më të lartë nga mesatarja kanë vlerat e IHD%PBB. Nëse krahasojmë shpërhapjen e rritjes ekonomike të Maqedonisë me vendet partnere tregtare të saj shohim se vlerat e rritjes ekonomike të Maqedonisë janë më të shpërhapura së pari sepse vlerat e një vendi të vetëm luhaten më shumë se vlerat e mesatarizuara të 3 vendeve.

Rënia e ekonomisë në një vend mund të balancohet matematikisht nga rritja e ekonomisë të vendit tjetër për të njëjtën periudhë kohore duke shuar vlerat e largëta të shpërndarje së rritjes ekonomike të një vendi specifik. Në tabelën e mëposhtme do të pasqyrohen treguesit përshkruan të serive të tjera të marra në studim si: transfertat si përqindje e PBB-së, konsumi si përqindje PBB-së, defiçiti apo sufiçiti buxhetor si përqindje e PBB-së, shpenzimet qeveritare si % e PBB-së dhe inflacioni i matur me anë të indeksit të çmimeve të konsumit.

Table 6: Treguesit statistikor përshkrues të: TRPR% PBB, C%PBB, D/SBUXHETOR%PBB, G%PBB dhe INF

	TRPR_PBB	C_PBB	D_SBUXHET_PBB	G_PBB	INF__CPI_
Mesatarja	16.3841	76.02074	-1.58996	17.6764	2.009617
Mesorja	16.52709	76.70103	-1.35	17.47583	1.35
Maksimumi	22.97932	87.90612	6.41	21.21297	9.7
Minimumi	8.143936	64.33149	-10.2	15.15734	-2.3
Dev. Stand.	3.697712	5.406348	3.021809	1.53754	2.592314
Skewness	-0.26508	-0.208354	-0.36868	0.242508	1.045679
Kurtosis	2.45006	2.647465	4.348023	2.358028	4.183702
Jarque-Bera	1.264252	0.645506	5.115217	1.402634	12.51235
Rëndësia Stat.	0.531461	0.724153	0.07749	0.495932	0.001919
Shuma	851.973	3953.078	-82.6777	919.1727	104.5001
n	52	52	52	52	52

Burimi: Autori

Transfertat private kanë pasur një vlerë mesatare 16.38 % të PBB-së dhe vlera median e tyre është 16.52 % (vlerë shumë pranë mesatares së të dhënave). Minimumi peshës së transfertave private kundrejt PBB-së është 8.14 % në 3-mujorin e parë të vitit 2009 dhe maksimumi i tyre është 22.97 % i cili ka ndodhur në 3-mujorin e tretë të vitit 2009. Seria ka shpërndarje normale sipas testit të Jarque Bera: 1.26 dhe rëndësisë së tij statistikore 0.53. Nëse do të krahasonim serinë e transferatave private si % e PBB-së me remitancat si % e PBB-së shohim se mesatarisht transferatat private kanë peshë më të lartë kundrejt prodhimi të brendshëm bruto.

Referuar peshës së konsumit kundrejt prodhimit të brendshëm bruto shohim se konsumi ka një peshë tepër të rëndësishme e cila mesatarisht shkon në 76 % në periudhën 2003-2015. Vlera e medianës është 76.7 % dhe minimum është 64.33 % në periudhën e parafundit të marrë në studim dhe maksimumi është 87.9 % në 3-mujorin e parë të vitit 2004. Shohim se konsumi ka një peshë tepër të rëndësishme në rritjen ekonomike të Maqedonisë por ajo që vihet re po kështu është fakti se ka një trend rënës të peshës së tij kundrejt PBB-së.

Treguesi i defiçitit/sufiçitit buxhetor kundrejt prodhimit të brendshëm bruto ka një mesatare - 1.58 % duke treguar një vlerë mesatare në deficit buxhetor po kështu edhe mediana tregon njëvlerë në defiçit -1.35. Vlera minimale e treguesit është -10.2 dhe vlera maksimale e tij është

6.41. Testi i Jarque Bera tregon për një shpërndarje normale e të dhënave në nivelin 95 % të besueshmërisë por jo në nivelin 90 % të besueshmërisë.

Konsumi qeveritar në raport të prodhimit të brendshëm bruto ka pasur vlera 17.67 % mesatarisht dhe vlerë të mesitit të serisë është 17.47 %. Vlera minimale e peshës së konsumit qeveritar kundrejt prodhimit të brendshëm bruto është 15.15 % në 3-mujorin e katërt të 2005 dhe vlera maksimale e tij 21.21 %. Seria ka shpërndarje normale sipas testit të Jarque Bera i cili ka marrë vlerat: 1.4 dhe rëndësi statistikore 0.49.

Së fundmi do të shohim serinë inflacioni i cili ka pasur vlerë mesatare 2 % ndërsa vlerë të mesitit 1.35. Vlerat më të larta të inflacionit që vendi ka pasur kanë qenë 9.7 % e cila ka ndodhur në 3-mujorin e dytë të 2008 dhe ka vazhduar edhe në 3-mujorin e tretë me 8 %. Vendi ka pasur edhe periudhë deflacioni e cila ka arritur nivelin më të lartë në 3-mujorin e katërt të vitit 2009. Vendi pasur ulje çmimesh edhe në: 3M2 2004-3M1 2005, 3M2 2009-3M4 2009, 3M2 2014-3M4 2014 si edhe 3M3 2015-3M4 2015.


Në pjesën e mësipërme realizuam një përshkrim të serive në terma të treguesve kryesor përshkrues të tyre. Mbulimi i importeve nga eksportet realizohet mesatarisht në masën 68 %. Niveli mesatar i kursit real të këmbimit të denarit kundrejt monedhave të tjera të gjitha vendeve tregtare është 102.15.

Rritja ekonomike mesatare e Maqedonisë ka rezultuar 3.39 % dhe ajo e vendeve partnere tregtare 1.17 %. Investimet e huaja direkte përbëjnë mesatarisht 3.77 % të vlerës së prodhimit të brendshëm bruto ndërsa remitancat 2.44 % të tij. Transferrat private kanë zënë një peshë relativisht më të lartë: 16.38 % ndërsa konsumi një peshë tepër të lartë: 76 %. Defiçiti buxhetor ka zënë mesatarisht 1.58 % të prodhimit të brendshëm bruto ndërsa shpenzimet qeveritare 17.67 %. Niveli mesatar i inflacionit ka qenë 2 % për periudhën 2003-2015.

Paraqitja grafike e marrëdhënies së serive me variabëlin e varur EX/IM

Në vijim të këtij seksioni do të paraqiten grafikisht ecuria e secilës seri e cila do të shërbej si faktor përcaktuesi për bilancin tregtar kundrejt treguesit të mbulimit të importeve nga eksportet.

Figure 15: Grafiku i EX/IM dhe REER



Burimi: Autori

Më sipër kemi paraqitur lëvizjen e treguesit të EX/IM-it dhe REER-it në kohë. Në boshtin horizontal janë paraqitur vitet ndërsa në boshtin vertikal majtas janë paraqitur vlerat e EX/IM-it kurse djathtas vlerat e REER-it.


Shohim vlerat e serisë EX/IM. Kjo seri ka në njëfarë mase luhatje ciklike sezonale por nuk mund të konkludojmë për trendin e saj në kohë për shkak se në 2007 vlerat e serisë kanë pësuar një rënie e cila ka vazhduar deri në vitin 2009 ku kemi vlerën më të ulët të treguesit. Nëperiudhën e paskrizës indikator ka njohur një trend të lehtë rritës.

Referuar treguesit të kursit real efektiv të këmbimit shohim se ai ka pasur vlera relativisht të lart në vitet e para të studimit. Këto vlera janë ulur deri në nivelin minimal të tyre në 2007 ku kanë pësuar përsëri rritje deri në vitin 2009. Në 2010 treguesi ka njohur përsëri një rënie të lehtë e cila është ndjekur nga një trend shumë i vogël rritës i treguesit deri në 2014.

Nëse i shohim në kompleks të dy seritë shohim se kursi efektiv i këmbimit ka një lidhje negative në kohë. Në periudha të uljes së REER-it shohim rritje në trend të EX/IM-it dhe e anasjelltë në

ulje. Këto luhatje janë më të qarta në periudhën 2003-2010 dhe vijnë e zbehen në periudhën 2010-2014 ku luhatjet e të dy serive bëhen më të vogla.

Figure 16: Grafiku i EX/IM dhe RPBB%




Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm pasqyron lëvizjen e serisë EX/IM dhe RPBB %. Ashtu si seria EX/IM ka luhatje të mëdha brenda të njëjtit vit edhe rritja ekonomike ka luhatje brenda vitit. Megjithëse s'mund të konkludojmë përfundimisht për tremujorët me rritje më të lartë ekonomike sepse kemi alternim të periudhave të 3-mujorit të tretë dhe të katërt me periudhat e 3-mujorëve të parë dhe të dytë.

Në total të serisë shohim luhatje tepër të larta të normave të rritjes ekonomike në periudhën e parë të marrë në studim, luhatje të cilat vijnë duke u zvogëluar në periudhën e mëvonshme. Në vitet e fundit shohim se rritja ekonomike ka konvergjuar në vlerat 3.5-4 %.

Në lidhje me serinë e EX/IM shohim se kemi lidhje pozitive në vlerësim total të luhatjes së dy serive por ajo që vihet re është fakti se kemi vonesa kohore herë pas herë të luhatjes së tyre me 1 3-mujor.

Figure 17: Grafiku i EX/IM dhe RPBBPT%




Burimi: Autori

Në grafikun e mësipërm dallojmë qartas dy periudha kohore: periudhën 2003-3M3 2008 dhe 3M4 2008-3M4 2015. Në periudhën e parë vendet partnere tregtare kanë pasur një rritje ekonomike mesatarisht 3.85 % ndërsa në periudhën e dytë kemi pasur një rënie të ndjeshme e cila ka filluar në 2008 ka vazhduar në 2009 për të njohur ritme pozitive vetëm në 3M1 2010.

Mbas 3M1 të 2010 kemi pasur rënie të ritmeve të rritjes së ekonomisë së vendeve partnere deri në 3M3 të vitit 2013 ku ekonomitë e vendeve partnere kanë njohur rritje. Për shkak të mesatarizimit komponentia sezonale e rritjes së PBBPT-së nuk është e pranishme. Në kontekstin e marrëdhënies së dy serive shohim se kemi një lidhje pozitive midis dy serive, rritja e njërës shoqërohet edhe me rritjen e tjetrës dhe e kundërta.

Figure 18: Grafiku i EX/IM dhe IHD




Burimi: Autori

Seria e investimeve të huaja direkte në raport të prodhimit të brendshëm bruto ka pasur vlera të qëndrueshme gjatë periudhës. Vihen re vetëm dy shmangie të mëdha: në 3-mujorin e parë të vitit 2006 dhe 3-mujorin e parë të vitit 2011. Pas kësaj periudhe përqindja e IHD-ve është mesatarisht 2.42 %.

Në lidhje me EX/IM shohim se kemi një lidhje negative midis serive megjithëse ajo nuk është shumë e evidente grafikisht. Ajo që vërehet në periudhën pas 2011 është fakti se luhatjet e të dy serive bëhen më të ulta.

Figure 19: Grafiku i EX/IM dhe REM



Burimi: Autori


Treguesi i remitancave si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto tregon luhatje ciklike sezonale. Po kështu shohim lehtësisht se seria ka një trend zbritës në kohë nga 2.89 % të PBB-së në fillim të periudhës në afërsisht 2 % të saj në periudhën fundit të marrë në studim.

Shohim se nuk kemi variancë afërsisht të njëjtë të vlerave nga trend i tyre i përgjithshëm. Duke marrë në konsideratë të dyja seritë shohim se kemi një lidhje negative midis vlerave të remitancave dhe raportit të mbulimit të importeve nga eksportet.

Në trendin e përgjithshëm shohim se treguesi i raportit të mbulimit të importeve nga eksportet ka trend pozitiv të lehtë ndërsa remitancat si përqindje e produktit të brendshëm bruto kanë trend negative. Po kështu edhe në nivele të serive për periudha të caktuara shohim se verat e larta të njëra seri shoqërohen me vlera të ulta të të serisë tjetër megjithëse ky rregull nuk ndodh në të gjitha periudhat.

Megjithëse evidentohet rënie e tyre në vitin 2008-2009 nuk kemi një rënie të theksuar dukshëm, kjo krahasuar me periudhat e tjera.

Figure 20: Grafiku i EX/IM dhe TRPR




Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm tregon lëvizjen kohore të treguesit të transfertave private kundrejt prodhimit të brendshëm bruto. Shohim se seria ka pasur luhajtje të konsiderueshme gjatë periudhës në studim. Transfertat private kanë qenë relativisht të ulta në fillimet e periudhës në normën 12 % mesatarisht. Në vitin 2008-2009 ato janë ulur në mënyrë të rëndësishme.

Vlerat e transfertave private janë rritur në fund të periudhës 2009 duke e kaluar edhe vlerat e periudhave të mëparshme. Lidhja e transfertave private me raportin e mbulimit të importeve nga eksporteve paraqitet lidhje pozitive në kohë referuar trendit të përgjithshëm të të dyja serive. Po kështu edhe nëse vëzhgojmë vlerat individuale për secilën periudhë shohim se kur vlerat e EX/IM janë të ulta janë vëzhguar vlera të ulta edhe për transfertat private. Ky rregull paraqitet në shumicën e periudhave të vëzhguara në grafikun e mësipërm.

Figure 21: Grafiku i EX/IM dhe C%PBB




Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm paraqet luhatjen e serisë së konsumit familjar të shprehur si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto gjatë periudhës në studim. Vlerat e treguesit paraqiten në boshtin vertikal në anën e djathtë. Referuar shmangies së serisë nga trend i përgjithshëm i tyre shohim se seria ka një variancë afërsisht të njëjtë gjatë kohës me përjashtim të dy momenteve kohore atij të vitit 2003-2004 dhe 2013.

Nga grafiku vëmë re se niveli mesatar i konsumit familjar ka një trend rënës në kohë nga vlerat 87 % të PBB-së në 64 % të PBB-së.

Duke konsideruar ecurinë e të dy serive vëmë re se trend i tyre i përgjithshëm ka lidhje negative. Seria EX/IM ka trend pozitiv ndërsa seria C%PBB-ja ka trend negative në kohë. Po kështu edhe nëse eidentojmë vlerat e serive për periudha të veçanta kohore shohim se vlerat pozitive të serisë EX/IM shoqërohen me vlera negative të serisë tjetër C%PBB-së.

Figure 22: Grafiku i EX/IM dhe D/S BUXHETOR%PBB




Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm paraqet në boshtin vertikal majtas dhe djathtas përkatësisht vlerat e serive të raportit të mbulimit të importeve nga eksporteve dhe defiçitit/sufiçitit buxhetor %PBB. Ajo që vëmë re nga paraqitja grafike e serisë së defiçitit buxhetor/sufiçitit buxhetor kundrejt prodhimit të brendshëm bruto është ka një luhatje nga trend i saj që ndryshon në kohë. Për periudhën para vitit 2008 ajo që vihet re është se vlerat e serisë janë si pozitive ashtu edhe negative ndërsa pas këtij viti vlerat e serisë luhaten kryesisht në vlerat negative të saj.

Ndërkohë që para vitit 2008 treguesi i ka njohur vlera të suficitit dhe defiçitit pas kësaj periudhe ne shohim vetëm vlera të defiçitit buxhetor.

Në marrëdhënie me serinë EX/IM shohim se seria ka një trend shumë të vogël në rritje ndërsa seria defiçitit/suficitit buxhetor kundrejt PBB-së është në rritje. Megjithatë nuk mund të evidentojmë me saktësi nga paraqitja grafike lidhjen midis variablave sepse në nivel periudhe ne mund të evidentojmë lidhje pozitive midis vlerave të dy serive.

Figure 23: Grafiku i EX/IM dhe G%PBB



Burimi: Autori


Grafiku i mësipërm pasqyron lëvizjen e nivelit të indikatorit EX/IM dhe G%PBB-ja gjatë periudhës së marrë në studim.

Shohim se pas vitit 2004 vlerat e treguesit të G%PBB-së kanë njohur rënie të lehtë dhe kanë filluar të rriten në vitin 2008 deri në 2009 ku kanë arritur vlerat maksimale. Pas vitit 2009 vlerat e treguesit përsëri kanë pësuar ulje të lehtë për të vazhduar në rritje në 2012 dhe 2013. Pas 2013 vlerat mesatare të serisë kanë ardhur duke u ulur.

Referuar variancës së serisë shohim se kemi luhatje ciklike sezonale të të njëjtit model lëvizjeje përgjat gjithë periudhës së marrë në studim. Ndërkohë marrëdhënia me raportin e mbulimit të importeve nga eksportet paraqet një lidhje negative. Trendet e përgjithshme të të dhënave për të dyja seritë tregojnë për një lidhje negative dhe kjo evidentohet edhe nga vlerat për çdo periudhë kohore të secilës seri ku vlerat negative të njërs seri shoqërohen me vlera pozitive nga tjetra dhe e anasjellta.

Së fundmi është prezantuar grafiku i serisë EX/IM dhe inflacionit.

Figure 24: Grafiku i EX/IM dhe INF



Burimi: Autori

Nga grafiku shohim se vlerat e inflacionit kanë pasur luhatje gjatë periudhës. Vlerat më të larta shihen në periudhën 2008. Pas krizës financiare shohim se treguesi i inflacionit është ulur ndjeshëm në nivele poshtë zeros duke reflektuar pasigurinë për blerje të konsumatorëve si rezultat i krizës financiare.

Ajo që vëmë re nga grafiku është fakti se seria është e sheshuar dhe nuk paraqet komponente ciklike sezonale brenda një viti. Vlerat e larta të inflacionit janë vënë re pas vitit 2009 e deri në 2013. Por vitet 2014 dhe 2015 kanë qenë periudha me ndryshime të nivelit të inflacionit në terma pozitive shumë të vegjël dhe në terma negative po kështu edhe këto afër zeros.

Testimi i lidhjes statistikore midis variablave

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e testit të korrelacionit të Pearson-it midis variablave të pavarura me variabëlin e varur dhe midis variablave të pavarura midis njëra-tjetrës.

PËRCAKTUESIT E BILANCIT TREGTAR TË MAQEDONISË

Table 7: Korrelacioni i Pearson midis variablave

	EX/IM	REER	RPBB%	RPBBPT %	IHD% PBB	REM%PBB	TRPR% PBB	C%P BB	D/SBUXHET% PBB	G% PBB
EX/IM	1									
REER	-.340*	1								
RPBB%	.093	-.062	1							
RPBBPT%	.058	.162	.478**	1						
IHD%PBB	-.150	-.158	.317*	.365**	1					
REM%PBB	-.022	-.005	.018	.318*	.018	1				
TRPR%PBB	.642**	-.522**	-.204	-.357**	-.275*	.124	1			
C%PBB	-.382**	.137	.115	.336*	.333*	.576**	-.366**	1		
D/SBUXH%PBB	.032	-.046	.204	.383**	.084	.593**	.027	.399**	1	
G%PBB	-.449**	.179	-.229	-.399**	.221	-.098	-.363**	.358**	-.236	1
INF (CPI)	-.084	-.286*	.203	.075	.308*	-.010	-.015	.127	.042	.148

*. Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.05 (2-tailed).

**. Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.01 (2-tailed).

Burimi Autori

Qëllimi i realizimit të korrelacionit të Perason ka funksion të dyfishtë: të kontrolloi lidhjen statisikore midis variablave si edhe të testoi për problemin e multikolinearitetit në regresion.

Koefiçenti i korrelacionit midis EX/IM dhe REER është: -0.34. Një lidhje e moderuar, negative midis dy variablave. Koefiçenti është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 95 % të besueshmërisë. Kjo lidhje është e pritshme në kushtet kur ulja e kursit real të këmbimit bën që produktet vendase të jenë më tërheqëse për të huajt dhe normalisht simulon nivelin e eksporteve dhe frenon nivelin e importeve duke qenë se produktet në vend kushtojnë më pak se produktet e importuara.

Lidhje e moderuar negative, statistikisht e rëndësishme është evidentuar edhe midis C%PBB dhe EX/IM. Koefiçenti i korrelacionit është -0.382 dhe është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 99 % të besueshmërisë. Rritja e konsumit të brendshëm ka lidhje

negative me raportin e mbulimi të importeve sepse e konsumit shpesh herë shoqërohet me rritje të blerjeve të produkteve të cilat prodhohen në vendet e tjera dhe normalisht rrit nivelin e importeve.

Edhe midis serisë G%PBB-së dhe EX/IM-së vihet re një lidhje negative mesatare. Koeficienti ka vlerën -0.449 dhe është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë. Edhe në rastin e konsumit qeveritar kemi një lidhje negative sepse rritja e shpenzimeve qeveritare rrit kërkesën për borxh nga qeveria, rrit nivelin e normave të interesit, injekton më shumë para në ekonomi dhe rrit nivelin e inflacionit i cili nga ana tjetër ul nivelin e eksporteve dhe rrit nivelin e importeve.

Lidhje pozitive, statistikisht e rëndësishme e EX/IM-së është evidentuar vetëm në rastin e transfertave private. Shohim se koeficienti ka marrë vlerën: 0.642 dhe është i rëndësishëm në nivelin e besueshmërisë 99 %. Lidhje pozitive midis raportit të mbulimit të importeve nga eksportet shpjegohet duke konsideruar se transfertat private në shumicën e rasteve shkojnë për konsum të familjarëve dhe ka të njëjtin impakt me konsumin familjar.

Lidhje pozitive është vlerësuar edhe midis IM/EX-së dhe rritjes ekonomike të brendshme, rritjes ekonomike të vendeve partnere tregtare si edhe deficitit/suficitit buxhetor megjithëse asnjë nga këto lidhje nuk është statistikisht e rëndësishme.

Vëzhgim i lidhjeve midis variablave të varur me njëra-tjetrën.

Kursi real efektiv i këmbimit ka lidhje statistikisht të rëndësishme me serinë e transfertave private si edhe me inflacionin. Koeficienti i korrelacionit të Pearson midis REER-it dhe TRPR%PBB-së është: -0.522 duke reflektuar lidhje negative, mesatare midis dy ndryshoreve. Koeficienti nuk është shumë i lartë që të shkaktoj multikolinearitet në regresion. Koeficienti i REER-it me INF-it është -0.286, lidhje negative e dobët midis dy ndryshoreve. Normalisht nëse kemi rritje të çmimeve në vend kursi real i këmbimit do të shoqërohet me ulje të vlerave kjo në mënyrë direkte për shkak të formulës së llogaritjes së REER-it.

Seria RPBB% ka lidhje pozitive të rëndësishme me RPBBPT% dhe IHD%PBB. Koeficienti i korrelacionit midis RPBB% dhe RPBBPT% është 0.478 dhe është i rëndësishëm në nivelin 95 % të besueshmërisë. Rritja ekonomike e vendit është e lidhur në mënyrë statistikisht të rëndësishme, pozitivisht me vendet partnere tregtare kjo për shkak të hapjes së madhe të vendit

ndaj vendeve Europiane. Lidhja korrelative midis RPBB% dhe IHD%PBB është vlerësuar: 0.317 dhe është statistikisht e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë.

Lidhja statistikore e RPBBPT% me variablat e tjera është statistikisht e rëndësishme në të gjitha rastet me përjashtim të inflacionit. Koeficienti i korrelacionit të Pearson midis RPBBPT% dhe IHD%PBB është 0.365 dhe është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë. Kjo normalisht është një lidhje e pritshme sepse investimet e huaja direkte në shumicën e rasteve vijnë nga vendet partnere tregtare dhe një rritje e ekonomisë në këto vende shoqërohet me ekspansion të aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve të cilat kërkojnë burime edhe jashtë territorit të tyre.

Lidhja korrelative e RPBBPT% me REM%PBB është vlerësuar 0.318 dhe është e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë. Një rritje e ekonomisë në vendet partnere tregtare shoqërohet me rritje të dërgesave të emigrantëve për shkak të rritjes së të ardhurave të cilat ato kanë në dispozicion nga puna. Koeficienti i korrelacionit të RPBBPT% me TRPR%PBB është vlerësuar - 0.357 dhe është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 95 % të besueshmërisë. Lidhje pozitive statistikisht e rëndësishme evidentohet edhe midis RPBBPT% dhe konsumit familjar në nivelin 0.336 e cila është statistikisht e rëndësishme në nivelin 99 % të besueshmërisë. Rritja e ekonomisë së vendeve partnere tregtare kalon në ekonominë e vendit nëpërmjet dërgesave zyrtare dhe jozyrtare të emigrantëve apo nëpërmjet investimeve të huaja direkte duke rritur nivelin e konsumit të familjarëve.

Lidhje të rëndësishme statistikore është vëzhguar edhe me defiçitin/sufiçitin buxhetor si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto. Koeficienti ka rezultuar të jetë 0.383 dhe është i rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë. Rritja e ekonomisë së vendeve partnere tregtare mund të sjell rritje të zhvillimit të ekonomisë së brendshme dhe rritje të të ardhurave buxhetore më shumë se rritje të shpenzimeve buxhetore.

Lidhja e rëndësishme është vëzhguar edhe me shpenzimet qeveritare por shenja ndaj tyre është negative. Koeficienti i korrelacionit të Pearson për këtë lidhje është: -0.399 dhe është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë. Nivele më të larta të rritjes ekonomike

nëpërmjet kanaleve të transmetimit në ekonominë vendase sjellin politikë fiskale ekspansioniste duke rritur konsumin qeveritar.

Lidhja e investimeve të huaja direkte është statistikisht e rëndësishme me transfertat private, konsumin dhe inflacionin. Lidhja e IHD%PBB me TRPR%PBB është vlerësuar -0.275 dhe është statistikisht e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë. Nivelet e larta të investimeve të huaja direkt shoqërohen me nivele të larta të transfertave private. Lidhja e IHD%PBB me konsumin është vlerësuar: 0.333, statistikisht e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë ndërsa lidhja me inflacionin 0.308, statistikisht e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë.

Treguesi i remitancape si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto ka rezultuar me lidhje statistikisht të rëndësishme pozitive me konsumin familjar dhe defiçitin/sufiçitin buxhetor të dyja të shprehura në përqindje të PBB-së. Vlerat e koefiçentëve të korrelacionit kanë rezultuar respektivisht 0.576 dhe 0.593 dhe të dy janë statistikisht të rëndësishëm në nivelin 99 %.

Treguesi i transfertave private ka lidhje negative, statistikisht të rëndësishme me konsumin familjar dhe konsumin qeveritar. -0.366 dhe -0.363. Të dy koefiçentët janë statistikisht të rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë.

Po kështu lidhje pozitive statistikore e rëndësishme është vlerësuar edhe midis C%PBB dhe G%PBB dhe D/S Buxhetor %PBB. Koefiçentët janë 0.399 dhe 0.358 dhe janë të rëndësishëm në nivelin 99 % të besueshmërisë.

Vlerësimi i treguesve të korrelacionit të mësipërm nuk paraqiti asnjë rast ku koefiçentët të ishin më të lartë se vlera 0.8 çka do të bënte problem për vlerësimin e regresionit sepse do të kishte të pranishëm problemin e multikolinearitetit.

Megjithëse ne kemi realizuar dy matje për dërgesat e emigrantëve do të bëjmë dy vlerësime për regresionet për secilin rast me qëllim të mos kemi probleme me multikolinearitetin për shkak të lidhjes teorike që ato përfaqësojnë.

5.2 Testimi i stacionaritetit

Testet e rrënjës unitare të serive u realizuan duke testuar modelin vetëm me konstante, me konstante dhe trend dhe pa konstante dhe pa trend. U realizua testimi i rrënjës unitare duke përdorur testin ADF dhe testin Phillips-Perron në rast të mungesës së normalitetit në mbetjet e regreseve të vlerësuara.

Rezultatet e testit ADF paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Figure 25: Testi i rrënjës unitare në nivelin bazë me testin ADF

VARIABËLI	ADF (C,-)		VENDIMI	ADF (C,t)		VENDIMI	ADF (-,-)		VENDIMI
	Testi	Sig.		Testi	Sig.		Testi	Sig.	
EX/IM (DEN)	1.81	0.369	Testo D(1)	-2.33	0.4	Testo D(1)	0.63	0.84	Testo D(1)
REER	-2.32	0.16	Testo D(1)	-1.97	0.58	Testo D(1)	-0.61	0.44	Testo D(1)
RPBB%	4.97	0.0001	Stacionare I (0)	5.19	0.0005	Stacionare I (0)	-3.11	0.002	Stacionare I (0)
RPBBPT%	-1.53	0.5	Testo D(1)	-1.49	0.81	Testo D(1)	-1.57	0.1	Testo D(1)
IHD%PBB	-6.25	0.00001	Stacionare I (0)	-6.65	0.00001	Stacionare I (0)	-3.7	0.0004	Stacionare I (0)
REM%PBB	0.15	0.96	Testo D(1)	-3.4	0.06	Testo D(1)	-1.5	0.12	Testo D(1)
TRPR%PBB	-1.8	0.33	Testo D(1)	-3.4	0.05	Testo D(1)	0.25	0.75	Testo D(1)
C%PBB	0.38	0.98	Testo D(1)	-3.3	0.07	Testo D(1)	-1.75	0.07	Testo D(1)
D/SBUXHET%PBB	-1.15	0.68	Testo D(1)	-7.5	0.00001	Stacionare I (0)	-0.62	0.43	Testo D(1)
G%PBB	-2.7	0.08	Testo D(1)	-2.8	0.2	Testo D(1)	-0.72	0.39	Testo D(1)
INF (CPI)	-2.78	0.069	Testo D(1)	-2.67	0.25	Testo D(1)	-1.14	0.22	Testo D(1)

Burimi: Autori

Në rastin e testimit të stacionaritetit për në secilën seri duke përfshirë vetëm konstanten ka rezultuar se vetëm seria e RPBB% dhe IHD%PBB janë stacionare, pra të integruara në nivelin zero. Në të gjitha rastet e tjera vlerat e rëndësisë statistikore të testeve kanë treguar se seritë duhet të testohen në diferencën e parë. Vlerësimi i ADF duke përfshirë konstante dhe trend në regresion ka treguar se

3 seri janë stacionare në nivel. Seritë stacionare janë RPBB%, IHD%PBB dhe D/SBUXHETOR%PBB-së. Në seksionin e fundit të tabelës paraqitet vlerësimi i testit kur nuk kemi përfshirë as konstante as trend.

Rezultatet e testimit të rrënjës unitare duke përdorur testin Phillips Perron.

Figure 26: Testi i rrënjës unitare në nivelin bazë me testin Phillips Perron

VARIABËLI	Phillips Perroni (C)		VENDIMI	Phillips Perroni (C,t)		VENDIMI	Phillips Perroni (-,-)		VENDIMI
	Testi	Sig.		Testi	Sig.		Testi	Sig.	
EX/IM (DEN)	-5.78	0.00001	Stacionare I(0)	-6.5	0.00001	Stacionare I(0)	0.36	0.78	Testo D(1)
REER	-2.29	0.17	Testo D(1)	-1.85	0.66	Testo D(1)	-0.63	0.43	Testo D(1)
RPBB%	-5	0.0001	Stacionare I(0)	-5.13	0.0006	Stacionare I(0)	-3.03	0.003	Stacionare I(0)
RPBBPT%	-1.99	0.28	Testo D(1)	-2.18	0.48	Testo D(1)	-1.93	0.0511	Testo D(1)
IHD%PBB	-6.25	0.00001	Stacionare I(0)	-6.65	0.00001	Stacionare I(0)	-3.6	0.0006	Stacionare I(0)
REM%PBB	-3.45	0.0132	Stacionare I(0)	-6.08	0.0001	Stacionare I(0)	-0.73	0.39	Testo D(1)
TRPR%PBB	-4.9	0.0002	Stacionare I(0)	-5.14	0.0006	Stacionare I(0)	-0.03	0.66	Testo D(1)
C%PBB	-3.84	0.0046	Stacionare I(0)	-10.49	0.00001	Stacionare I(0)	-1.44	0.13	Testo D(1)
D/SBUXHET%PBB	-5.7	0.00001	Stacionare I(0)	-7.5	0.00001	Stacionare I(0)	-4.63	0.00001	Stacionare I(0)
G%PBB	-4.9	0.0002	Stacionare I(0)	-4.85	0.0014	Stacionare I(0)	-0.28	0.57	Testo D(1)
INF (CPI)	-2.7	0.07	Testo D(1)	-2.68	0.24	Testo D(1)	-2.11	0.03	Stacionare I(0)

Burimi: Autori

Vlerësimet e testit Phillips Perroni janë vlerësues më të mira në rastet kur kemi mungesë të normalitetit në mbetje. Në këto kushte në seksionin e parë të tabelës shohim se kemi vetëm 3 seri që nuk janë stacionare në nivel dhe duhet të kontrollojmë për diferencën e parë ndryshe nga se paraqitet situatë me testin ADF. Në seksionin e dytë të tabelës kemi vlerësimin kur kemi përfshirë edhe konstante edhe trend në vlerësimin e stacionaritetit. Shohim po kështu se vetëm 3 seri nuk janë stacionare në nivel dhe duhet të testojmë për diferencën e parë. Seritë janë: REER, RPBBPT% dhe INF. Në seksionin e tretë të tabelës është paraqitur vlerësimi i testit kur nuk

është përfshirës konstant as trend në ekuacionin e vlerësimit. Shohim se vetëm 4 seri janë stacionare me këtë supozim duke lënë vend për të testuar stacionaritetin në seritë e tjera.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e diferencave të para të vlerësuara për secilin prej testeve të mësipërme.

Figure 27: Testet e diferencave të para me testin ADF

VARIABËLI	ADF (C,-)		VENDIMI	ADF (C,t)		VENDIMI	ADF (-,-)		VENDIMI
	Testi	Sig.		Testi	Sig.		Testi	Sig.	
D(EX/IM)	-9.34	0.00001	Stacionare I(1)	-9.25	0.00001	Stacionare I(1)	-9.37	0.00001	Stacionare I(1)
D(REER)	-6.05	0.00001	Stacionare I(1)	-6.45	0.00001	Stacionare I(1)	-6.02	0.00001	Stacionare I(1)
D(RPBBPT%)	-7.68	0.00001	Stacionare I(1)	-7.59	0.00001	Stacionare I(1)	-7.77	0.00001	Stacionare I(1)
D(REM%PBB)	-10.01	0.00001	Stacionare I(1)	-4.43	0.05	Stacionare I(1)	-9.82	0.00001	Stacionare I(1)
D(TRPR%PBB)	-4.14	0.0021	Stacionare I(1)	-4.16	0.01	Stacionare I(1)	-4.15	0.00001	Stacionare I(1)
D(C%PBB)	-12.6	0.00001	Stacionare I(1)	-12.99	0.00001	Stacionare I(1)	-4.67	0.00001	Stacionare I(1)
D(D/SBUXHET%PBB)	-10.88	0.00001	Stacionare I(1)	-10.78	0.00001	Stacionare I(1)	-10.97	0.00001	Stacionare I(1)
D(G%PBB)	-3.86	0.0045	Stacionare I(1)	-3.8	0.02	Stacionare I(1)	-3.85	0.0003	Stacionare I(1)
D(INF (CPI))	-6.69	0.00001	Stacionare I(1)	-6.74	0.00001	Stacionare I(1)	-6.74	0.00001	Stacionare I(1)

Burimi: Autori

Ajo që është qartësisht e dallueshme në tabelën e mësipërme është fakti se edhe për seritë të cilat ishin të pavendosur për stacionaritetin e tyre në nivel mund të konkludojmë se seritë janë te shumta stacionare në diferencën e parë. Të gjitha vlerësimet e testeve të performara me programin Eviews 9 paraqiten në aneksin e studimit.

Të njëjtin vlerësim kemi bërë edhe për testin Phillip Perroni për t'u siguruar që asnjë nga seritë tona nuk është e integruar e rendit të dytë.

Figure 28: Testet e diferencave të para me testin Phillips Perron

VARIABËLI	Phillips Perroni (C)		VENDIMI	Phillips Perroni (C,t)		VENDIMI	Phillips Perroni (-,-)		VENDIMI
	Testi	Sig.		Testi	Sig.		Testi	Sig.	
D(EX/IM)	-27.5	0.00001	Stacionare I(1)	-26.95	0.00001	Stacionare I(1)	-25.08	0.00001	Stacionare I(1)
D(REER)	-6.14	0.00001	Stacionare I(1)	-6.66	0.00001	Stacionare I(1)	-6.15	0.00001	Stacionare I(1)
D(RPBBPT%)	-11.96	0.00001	Stacionare I(1)	-11.85	0.00001	Stacionare I(1)	-12.09	0.00001	Stacionare I(1)
D(REM%PBB)	-16.16	0.00001	Stacionare I(1)	-15.89	0.00001	Stacionare I(1)	-15.11	0.00001	Stacionare I(1)
D(TRPR%PBB)	-12.72	0.00001	Stacionare I(1)	-13.01	0.00001	Stacionare I(1)	-12.6	0.00001	Stacionare I(1)
D(C%PBB)	-24.3	0.0001	Stacionare I(1)	-27.39	0.0001	Stacionare I(1)	-18.97	0.00001	Stacionare I(1)
D(G%PBB)	-13.57	0.00001	Stacionare I(1)	-13.37	0.00001	Stacionare I(1)	-13.66	0.00001	Stacionare I(1)
D(INF (CPI))	-4.48	0.0002	Stacionare I(1)	-4.82	0.0015	Stacionare I(1)	-4.92	0.00001	Stacionare I(1)

Burimi: Autori

Edhe vlerësimet e diferencave të para sipas testit Phillips-Perron kanë treguar se seritë tona janë e shumta të integruara të rendit të parë dhe asnjëra prej tyre nuk është e integruar e nivelit të dytë. Kjo edhe nëse kemi përfshirë vetëm konstanten, konstanten dhe trendin apo nuk kemi përfshirë asnjë prej tyre në ekuacionin e vlerësimit të rrënjës unitare.

Duke qenë se kushti për vlerësimin e modelit ARDL janë të përshtatshme ne kemi vlerësuar modelin e mëposhtme për të matur ndikimin dinamik të përcaktuesve të raportit të mbulimit të importeve nga eksportet.

5.3 Prezantimi i modelit ARDL

Në vijim do të prezantojmë modele të vlerësuara si edhe interpretimin e rezultateve të studimit. U vlerësuan dy modele për të eliminuar praninë e dy variablove remitancave dhe transfertave private të cilat janë shumë të korreluara me njëra tjetrën në të njëjtin model. Vlerësimi i modeleve u realizua duke përzgjedhur dy vonesa kohore si për variabëlin e varur ashtu edhe për variablat e pavarura. Kjo për shkak të numrit të vëzhgimeve që kishim të disponueshëm. Përzgjedhja e vonesave kohore për secilën variabël u realizua në mënyrë automatike. Të gjitha variablat e pavarura u përfshinë në regresion si regresant dinamik ndërkohë vetëm konstantja u vlerësua si regresante fikse. Kriteri për përzgjedhjen e modelit u vendos Akaike Information Criterion (AIC).

5.3.1 Modeli ARDL duke përfshirë remitancat

Rezultatet e modelit:

Variabëli i varur: EX_IM

Metoda: ARDL

Date: 07/12/16 Time: 02:29

Zgjedhja (axhustuar): 2003Q3 2015Q4

Vëzhgime të përfshira: 50 pas axhustimeve

Maksimumi i vonesave kohore: 2 (Zgjedhje automatike)

Metoda e përzgjedhjes së modelit: Akaike info criterion (AIC)

Regresantët dinamike (2 lags, automatic): REER RPBB_ RPBBPT_
IHD_PBB REM_PBB C_PBB D_SBUXHET_PBB G_PBB INF__CPI_

Regresantët fiks: C

Numri i modeleve të vlerësuara: 39366

Modeli i përzgjedhur: ARDL(1, 0, 1, 0, 0, 0, 1, 2, 0, 0)

Variabëli	Koefiçenti	Gabimi standard	Statistika t	Prob.*
EX_IM(-1)	-0.353513	0.145906	-2.422876	0.0207
REER	-0.006284	0.003120	-2.013778	0.0518
RPBB_	-0.000185	0.002322	-0.079666	0.9370
RPBB_(-1)	-0.004359	0.002282	-1.910718	0.0643
RPBBPT_	0.010539	0.004303	2.449379	0.0195
IHD_PBB	-0.002379	0.002374	-1.002093	0.3232
REM_PBB	0.112798	0.051370	2.195802	0.0348
C_PBB	-0.002881	0.002347	-1.227433	0.2279
C_PBB(-1)	-0.009814	0.001865	-5.263199	0.0000
D_SBUXHET_PBB	0.001606	0.002861	0.561562	0.5780
D_SBUXHET_PBB(-1)	-0.001797	0.002515	-0.714510	0.4797
D_SBUXHET_PBB(-2)	-0.005448	0.002728	-1.997203	0.0536
G_PBB	-0.016378	0.007515	-2.179421	0.0361

INF_CPI_	0.001889	0.003036	0.622290	0.5378
C	2.546985	0.424090	6.005759	0.0000
R-Katrori	0.705230	Mean dependent var	0.683658	
R-Katrori i rregulluar	0.587321	S.D. dependent var	0.069220	
G.S i regresionit	0.044467	Akaike info criterion	-3.144818	
Shuma e katrorit te mbe.	0.069206	Schwarz criterion	-2.571211	
Log likelihood	93.62046	Hannan-Quinn criter.	-2.926385	
F-statistic	5.981178	Durbin-Watson stat	2.278377	
Prob(F-statistic)	0.000009			

Burimi: Autori

Në tabelën e mësipërme është paraqitur vlerësimi i modelit dhe koeficientët e tij. Në total janë vlerësuar 39366 regresione dhe së fundmi është vlerësuar ARDL(1, 0, 1, 0, 0, 0, 1, 2, 0, 0) si modeli më i mirë.

Referuar koeficientëve të regresionit shohim se vlerat e EX/IM me një kohë vonesë kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm në vlerat aktuale të treguesit të mbulimit të eksporteve nga importeve. Ndikimi i tyre është negativ, pra një rritje me 0.01 të vlerave të EX/IM të periudhës paraardhëse shoqërohet me ulje të vlerave për periudhën pasardhëse me 0.0035. Ndikimi i kursit efektiv të këmbimit në nivelin e eksporteve është vlerësuar si negativ. Megjithatë efekti i saj nuk është statistikisht i rëndësishëm në nivelin e $\alpha=5\%$.

Rritja ekonomike është përfshirë në nivel si edhe me një kohë vonesë në model. Ndikimi i të dyjave ndryshoreve është negativ në të dyja rastet por asnjëra prej tyre nuk është statistikisht e rëndësishme në nivelin 95 % të besueshmërisë.

Vlerësimi i rritjes ekonomike të vendeve partnere është përfshirë vetëm në nivel në regresion. Shenja e ndryshores është pozitive dhe koeficienti është statistikisht i rëndësishëm referuar vlerës së $t=2.44$ dhe rëndësisë statistikore të saj $=0.01$. Rritja ekonomike e vendeve partnere me 1 pikë përqindje sjell rritje të raportit të mbulimit të importeve nga eksportet me 0.01 kur të gjitha variablat e tjera të përfshira në regresion mbahen të pandryshuara.

Ndikimi i investimeve të huaja direkte është vlerësuar negativ megjithatë koeficienti nuk është statistikisht i rëndësishëm. Modeli i përzgjedhur ka të përfshirë variabëlën vetëm në nivel dhe jo me vonesa kohore për matjen e ndikimit në periudhën afatgjatë të investimeve të huaja direkte.

Remitancat kanë ndikim pozitiv në bilancin tregtar. Rritja e remitancave me 1 pikë përqindje sjell rritjen raportit të mbulimit të importeve me 0.11.

Ndikimi i konsumit familjar është vlerësuar në tërësi me anë të dy periudhave kohore, në periudhën aktuale dhe në periudhën periodike me një kohë vonesë. Rritja me 1 pikë përqindje e konsumit familjar kundrejt prodhimit të brendshëm bruto sjell uljen e mbulimit të importeve nga eksportet me 0.0098 në periudhën pasardhëse. Vetëm ndryshorja me një kohë vonesë është statistikisht e rëndësishme.

Vlerësimi i defiçitit apo sufiçitit buxhetor kundrejt prodhimit të brendshëm bruto është realizuar në tre periudha kohore, në periudhën aktuale, me një dhe me dy vonesa kohore. Shenja e variabëlës në periudhën bazë është pozitive ndërsa ajo e dy periudhave të tjera është negative. Referuar rëndësisë statistikore të tyre mund të konkludojmë se vetëm ndryshorja e defiçitit/sufiçitit me dy kohë vonesë është statistikisht e rëndësishme përkatësisht me vlerën e $t = -1.99$ dhe rëndësi statistikore 0.05.

Ndikimi i shpenzimeve qeveritare është negativ dhe statistikisht i rëndësishëm. Vlera e statistikës t për këtë ndryshore është: -2.17 dhe rëndësia statistikore $0.036 < 0.05$. Vlerësimi i ndryshores është vetëm në periudhën t dhe jo me kohë vonesë. Rritja e shpenzimeve qeveritare si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto me 1 pikë përqindje sjell uljen e raportit të mbulimit të importeve nga eksportet me 0.0163. Pra rritja e shpenzimeve qeveritare si përqindje e PBB-së me 1 pikë përqindje sjell thellimin e defiçitit tregtar.

Vlerësimi i ndryshores së inflacionit është pozitive duke rënë ndesh me parimet e literaturës por kjo variabël nuk është statistikisht e rëndësishme.

Në tërësi modeli është statistikisht i rëndësishëm referuar vlerës së $F = 5.98$ dhe rëndësisë statistikore të saj $0.0000 < 0.05$. Të gjitha variablat së bashku kontribuojnë në shpjegimin e variacionit të defiçitit tregtar më shumë se vetëm mesatarja e këtij të fundit. Testi i F teston hipotezën e mëposhtme:

$$H_0: \beta_1 = \beta_2 = \dots = \beta_n = 0$$

H_a : të paktën njëri prej koeficientëve është i ndryshëm nga zero.

Në rastin tonë hipoteza zero bie poshtë në favor të hipotezës alternative. Pra, modeli jonë është statistikisht i rëndësishëm.


Koeficienti i përcaktimit të modelit ka vlerën 70.5 % ndërsa koeficienti i axhustuar me shkallët e lirisë është: 58.7 %. 70.5 % e variacionit të defiçitit tregtar shpjegohet nga variablat e pavarura.

Ky koefiçent është koefiçent i mirë referuar rregullit praktik që R katror duhet të jetë të paktën mbi 50 % megjithëse vlera e axhustuar e tij ka arritur në nivelin 58.7 %.

Vlera e Durbin-Watson është një matës paraprak i korrelacionit serial në mbetjet e regresionit. Shohim se vlera e tij është në nivelin 2.27. Vlera të dëshiruara të këtij treguesi janë shumë pranë afër vlerës 2. Në rast se vlerat janë më të vogla se 1.5 dhe më të mëdha se 2.5 atëherë kemi praninë e korrelacionit pozitiv dhe negativ respektivisht, në mbetjet e regresionit. Vlerat e treguesit tonë janë mbi vlerën 2 por nuk janë mjaftueshëm të mëdha për të konkluduar prezencën e autokorrelacionit pozitiv të mbetjeve.

Vlerësimi i modelit dhe mbetjeve të regresionit grafikisht paraqiten më poshtë:

Figure 29: Grafiku i vlerave aktuale, vlerave të vlerësuara dhe mbetjeve



Burimi: Autori

Tabela e mësipërme tregon se sa i afrohen vlerat e vlerësuara vlerave faktike të regresionit. Shohim se megjithëse kemi përputhje në shumicën e rasteve, ka mjaft raste kur vlerat e mbetjeve i kalojnë dy devijimet standarde. Megjithatë njëdiagnostikim më të saktë të modelit është paraqitur në seksionin e testeve.

Testi i lidhjes afatgjatë

Në vijim paraqitet testi i lidhjes afatgjatë të variablave të pavarura me variabëlin e varur deficieti tregtar. Për të testuar praninë apo jo të lidhjes afatgjatë modeli ARDL paraqet testin Bound. Rezultatet e testit paraqiten në vijim.

Hipoteza që testohet nga ky test është:

H_0 : Nuk ka lidhje afatgjatë midis variablave

H_a : Ka lidhje afatgjatë midis variablave

ARDL Bounds Test

Date: 07/12/16 Time: 02:30

Sample: 2003Q3 2015Q4

Included observations: 50

Null Hypothesis: No long-run relationships exist

Test Statistic	Value	k
F-statistic	7.488086	9

Critical Value Bounds

Significance	I0 Bound	I1 Bound
10%	1.88	2.99
5%	2.14	3.3
2.5%	2.37	3.6
1%	2.65	3.97

Burimi: Autori

Tabela e mësipërme paraqet statistikën F të testit Bound, vlerën e vlerësuar të tij, numrin e variablave të përfshira në vlerësim si edhe vlerat kritike të testit në nivelin bazë dhe në rendin e parë për secilin nivel besueshmërie.

Shohim se vlera e testit F në rastin tonë është 7.488. Vlera është më e madhe se të gjitha vlerat kritike të tabelës së mësipërme. Hipoteza zero bie poshtë në favor të hipotezës alternative. Pra ekziston lidhje afatgjatë midis ndryshoreve.

Vlerësimi i lidhjes afatgjatë dhe afatshkurtër paraqitet në modelin e mëposhtëm.

ARDL Cointegrating And Long Run Form

Dependent Variable: EX_IM

Selected Model: ARDL(1, 0, 1, 0, 0, 0, 1, 2, 0, 0)

Date: 07/12/16 Time: 02:30

Sample: 2003Q1 2015Q4

Included observations: 50

Cointegrating Form

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(REER)	-0.006284	0.003120	-2.013778	0.0518
D(RPBB_)	-0.000185	0.002322	-0.079666	0.9370
D(RPBBPT_)	0.010539	0.004303	2.449379	0.0195
D(IHD_PBB)	-0.002379	0.002374	-1.002093	0.3232
D(REM_PBB)	0.112798	0.051370	2.195802	0.0348
D(C_PBB)	-0.002881	0.002347	-1.227433	0.2279
D(D_SBUXHET_PBB)	0.001606	0.002861	0.561562	0.5780
D(D_SBUXHET_PBB(-1))	0.005448	0.002728	1.997203	0.0536
D(G_PBB)	-0.016378	0.007515	-2.179421	0.0361
D(INF_CPI_)	0.001889	0.003036	0.622290	0.5378
CointEq(-1)	-1.353513	0.145906	-9.276583	0.0000

Cointeq = EX_IM - (-0.0046*REER -0.0034*RPBB_ + 0.0078*RPBBPT_
-0.0018*IHD_PBB + 0.0833*REM_PBB -0.0094*C_PBB -0.0042
*D_SBUXHET_PBB -0.0121*G_PBB + 0.0014*INF_CPI_ + 1.8818)

Long Run Coefficients

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
REER	-0.004643	0.002263	-2.051749	0.0477
RPBB_	-0.003358	0.002311	-1.453101	0.1551
RPBBPT_	0.007787	0.003073	2.534220	0.0159
IHD_PBB	-0.001757	0.001756	-1.000867	0.3238
REM_PBB	0.083338	0.040476	2.058951	0.0470
C_PBB	-0.009379	0.001843	-5.090359	0.0000
D_SBUXHET_PBB	-0.004166	0.003252	-1.281198	0.2085
G_PBB	-0.012101	0.005321	-2.273934	0.0292
INF_CPI_	0.001396	0.002229	0.626237	0.5352
C	1.881759	0.223818	8.407544	0.0000

Burimi: Autori

Në tabelën e mësipërme shohim vlerësimin afatshkurtër dhe në peridhën afatgjatë të lidhjes së ndryshoreve me defiçitin tregtar.

Përpos vlerësimit në periudhën afatshkurtër paraqitur në seksionin e parë të tabelës kemi edhe vlerësimin e ekuacionit të kointegrimit.

Ekuacioni ka një vlerë të statistikës $t = -9.27$ dhe rëndësi statistikore $= 0.000 < 0.05$. Pra, lidhja afatgjatë është statistikisht e rëndësishme. Vlerësimi i koeficientëve për lidhjen afatgjatë është paraqitur në seksionin e dytë të tabelës.

Ndryshoret të cilat kanë lidhje afatgjatë statistikisht të rëndësishme me bilancin tregtar janë:

kursi real efektiv i këmbimit, rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare, remitancat, konsumi familjar dhe konsumi qeveritar.

Testet diagnostikuese të modelit

Testi i normalitetit

Testimi i normalitetit të mbetjeve të regresionit është realizuar duke përdorur testin Jarque Bera.


Testi Jarque Bera teston hipotezën e mëposhtme:

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale

H_a : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale

Paraqitja grafike e mbetjeve dhe të dhënat përshkruese të tyre paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Figure 30: Testi i normalitetit të mbetjeve të regresionit



Burimi: Autori

Më sipër shohim se testi i Jarque-Bera ka vlerën 1.34 dhe rëndësi statistikore $0.51 > 0.05$.

Hipoteza zero nuk mund të hidhet poshtë pra mbetjet e regresionit kanë shpërndarje normale.

Korrelacioni serial

Testimi i autokorrelacionit është realizuar duke përdorur testin LM të Breusch-Godfrey.

Hipoteza që ky test teston është:

H_0 : Nuk ka korrelacion serial në mbetjet e regresionit

H_a : Ka korrelacion serial në mbetjet e regresionit

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	2.029515	Prob. F(2,33)	0.1475
Obs*R-squared	5.476439	Prob. Chi-Square(2)	0.0647

Tabela tregon vlerën e testit e cila është 5.47 dhe probabiliteti i saj $0.0647 > 0.05$. Në këto kushte ne nuk mund të hedhim poshtë hipotezën zero e cila teston se mbetjet nuk kanë autokorrelacion midis tyre.

Heteroskedasticiteti

Heteroskedasticiteti është testuar nëpërmjet testit Breusch-Pagan-Godfrey. Hipoteza që ky test teston është:

H_0 : Mbetjet e regresionit janë homoskedastike

H_a : Mbetjet e regresionit janë heteroskedastike

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	0.889496	Prob. F(14,35)	0.5763
Obs*R-squared	13.12136	Prob. Chi-Square(14)	0.5170
Scaled explained SS	6.027547	Prob. Chi-Square(14)	0.9658

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur rezultatet e testit të heteroskedasticitetit. Vlera e Obs*R-squared është 13.12 dhe probabiliteti i saj $0.51 > 0.05$. Hipoteza zero nuk mund të bie poshtë. Pra mbetjet e regresionit janë homoskedastike.

Të gjithë testet e regresionit kanë rezultuar të favorshëm për vlerësimin e parametrave të vijës së regresionit.

Testi i stabilitetit

Testimi i stabilitetit të ekuacionit është realizuar duke përdorur testin RESET. Hipoteza zero që ky test teston është:

H_0 : Ekuacioni është stabil

H_a : Ekuacioni nuk është stabil

Ramsey RESET Test

Equation: UNTITLED

Specification: EX_IM EX_IM(-1) REER RPBB_ RPBB_(-1) RPBBPT_

IHD_PBB REM_PBB C_PBB C_PBB(-1) D_SBUXHET_PBB

D_SBUXHET_PBB(-1) D_SBUXHET_PBB(-2) G_PBB INF__CPI_C

Omitted Variables: Squares of fitted values

	Value	df	Probability
t-statistic	0.556132	34	0.5818
F-statistic	0.309283	(1, 34)	0.5818

F-test summary:

	Sum of Sq.	df	Mean Squares
Test SSR	0.000624	1	0.000624
Restricted SSR	0.069206	35	0.001977

Unrestricted SSR 0.068582 34 0.002017

Vlerësimi i këtij testi është: 0.309 dhe probabiliteti: $0.58 > 0.05$. Hipoteza zero s'mund të hidhet poshtë pra, parametrat e ekuacionit janë stabël.

5.3.2 Vlerësimi i modelit ARDL duke përfshirë transfertat private

Në vijim kemi paraqitur vlerësimin e modelit kur kemi hequr variabëlin remintaca dhe e kemi zëvendësuar atë me variabëlin: transfertat private.

Variabëli i varur: EX_IM

Metoda: ARDL

Data: 07/12/16 Time: 13:19

Zgjedhja (adjusted): 2003Q2 2015Q4

Included observations: 51 after adjustments

Maximum dependent lags: 2 (Automatic selection)

Model selection method: Akaike info criterion (AIC)

Dynamic regressors (2 lags, automatic): REER RPBB_ RPBBPT_

IHD_PBB TRPR_PBB C_PBB D_SBUXHET_PBB G_PBB INF__CPI_

Fixed regressors: C

Number of models evaluated: 39366

Selected Model: ARDL(1, 0, 1, 0, 0, 1, 1, 0, 1, 0)

Note: final equation sample is larger than selection sample

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.*
EX_IM(-1)	-0.181919	0.140354	-1.296148	0.2032
REER	-0.004695	0.002953	-1.590098	0.1206
RPBB_	0.000797	0.001974	0.403644	0.6889
RPBB_(-1)	-0.003450	0.002067	-1.669028	0.1038
RPBBPT_	0.011178	0.003807	2.936369	0.0058
IHD_PBB	-0.003188	0.002069	-1.540650	0.1321
TRPR_PBB	0.012344	0.002708	4.557975	0.0001
TRPR_PBB(-1)	-0.007254	0.002878	-2.520695	0.0163
C_PBB	-0.002491	0.001757	-1.417712	0.1649
C_PBB(-1)	-0.005293	0.001839	-2.878656	0.0067
D_SBUXHET_PBB	-0.001833	0.002642	-0.693832	0.4922
G_PBB	-0.005211	0.007610	-0.684831	0.4978
G_PBB(-1)	-0.008003	0.006173	-1.296427	0.2031
INF__CPI_	0.001153	0.002656	0.434072	0.6668
C	2.030053	0.446382	4.547792	0.0001
R-squared	0.765835	Mean dependent var		0.683002
Adjusted R-squared	0.674771	S.D. dependent var		0.068684
S.E. of regression	0.039170	Akaike info criterion		-3.401894
Sum squared resid	0.055234	Schwarz criterion		-2.833710

Log likelihood	101.7483	Hannan-Quinn criter.	-3.184774
F-statistic	8.409831	Durbin-Ėatson stat	1.899255
Prob(F-statistic)	0.000000		

Metoda e vlerësimit të modelit është e njëjtë me modelin e mësipërm në terma të vonesave kohore të përzgjedhura që në rastin tonë janë 2 vonesa kohore, të gjitha variablat janë konsideruar si regresant dinamik me përjashtim të konstantes së regresionit e cila është konsideruar regresant fiks. Kriteri i përdorur për të përzgjedhur modelin ka qenë kriteri AIC dhe në total janë vlerësuar 39366 regresione. Shohim se seritë të cilat janë statistikisht të rëndësishme, të indikuara me ngjyrë të zezë të theksuar janë: rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare, transfertat private, transfertat private me një kohë vonesës si edhe konsumi familjar me një kohë vonesë.

Ashtu edhe si rezultoj në regresionin e mëparshëm niveli i EX/IM i periudhës paraardhëse ka ndikim negativ në nivelin e EX/IM të periudhës aktuale. Megjithëse ndikimi i tij nuk është statistikisht i rëndësishëm në modelin e dytë, me një vlerë të $t=-1.29$ dhe rëndësi statistikore $0.2 > 0.05$.

Në të njëjtën mënyrë edhe ndikimi i kursit real efektiv i këmbimit është negativ por efekti i tij nuk është statistikisht i rëndësishëm sepse vlera e t statistikës $t= -1.59$ dhe rëndësia statistikore $= 0.12 > 0.05$.

Ndikimi i rritjes ekonomike të vendit është vlerësuar pozitiv në përmirësimin e bilancit tregtar por edhe ky ndikim nuk është statistikisht i rëndësishëm edhe për serinë në periudhën t edhe në periudhën me një vonesë kohore t-1.

Rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare ka ndikim pozitiv duke përmirësuar bilancin tregtar të Maqedonisë. Vlerësimi i modelit ka përfshirë vetëm vlerat në kohën t të serisë. Rritja me 1 pikë përqindje e rritjes ekonomike të vendeve partnere tregtare ndikon në rritjen me 0.01 të raportit të mbulimit të importeve nga eksportet. Pra, përmirëson defiçitin tregtar me 1 %.

Investimet e huaja direkte kanë ndikim negativ në bilancin tregtar megjithëse ndikimi i tyre nuk është statistikisht i rëndësishëm. Vlera e statistikës $t=-1.54$ dhe rëndësia statistikore e saj $= 0.13$.

Referuar ndryshores së transferatave private ajo është vlerësuar në periudhën t dhe në t-1 në regresion dhe efekti i të dy variablave është statistikisht i rëndësishëm. Ajo që është mjaft e

rëndësishme të vëzhgojmë vështë shenja e tyre, e cila është pozitive në periudhën bazë dhe negative për ndryshoren me një kohë vonesë. Rritja e transfertave private si përqindje e PBB-së me një pikë përqindje sjell përmirësimin e bilancit tregtar të periudhës aktuale me 0.0123 ndërkohë ndikon negativisht në bilancin tregtar të periudhës pasardhëse duke e përkeqësuar këtë raport me 0.00725.

Edhe variabëli i konsumit familjar është përfshirë në dy momente kohore në modelin e vlerësuar.

Konsumi i periudhës korrente dhe konsumi i periudhës paraardhëse. Të dy variablat ndikojnë negativisht në bilancin tregtar por vetëm konsumi me një kohë vonesë ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në bilancin tregtar. Rritja e konsumit kundrejt prodhimit të brendshëm bruto me 1 pikë përqindje sjell uljen e raportit të mbulimit të importeve nga eksportet për periudhën pasardhëse me 0.00529 në kushtet kur të gjitha variablat e tjera mbeten të pandryshuara.


Ndikimi i defiçitit/defiçitit buxhetor dhe shpenzimeve qeveritare është vlerësuar në përkeqësim të bilancit tregtar por asnjë prej variablave nuk ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm. Ndërsa ndikimi i inflacionit është pozitiv por edhe kjo ndryshore nuk është statistikisht e rëndësishme.

Rëndësia globale e modelit paraqitet e mirë me një vlerë të statistikës $F=8.4$ dhe rëndësi statistikore të saj $0.0000 < 0.05$. Pra, hipoteza zero që koeficientët e regresionit janë të barabartë me zero hidhet poshtë.

Koeficienti i përcaktimit të regresionit R-Katror ka rezultuar: 76.5 % dhe tregon se 76.5 % e variacionit tëvariabëlilit të varur shpjegohet nga variablat e pavarura. Koeficienti i axhustuar me shkallët e lirisë të regresionit ka rezultuar 67.4 %. Nëse krahasojmë këto dy tregues me treguesit e modelit të parë kur kemi përfshirë remitancat në vend të transfertave private mund të themi se modeli lë më pak variancë të pashpjeguar të bilancit tregtar. Pra kur të gjitha variablat e tjera janë të pandryshuara, futja e transfertave private si faktor shpjegues përmirëson rëndësishëm totalin dhe aftësinë shpjeguese të modelit.

Përmirësim kemi edhe për statistikën e Durbin-Watson e cila merr vlerën 1.89 në regresionin e dytë. Ashtu edhe si e përmendëm vlera më e mirë e kësaj statistike është vlera 2 megjithatë vlera e përfituar është mjaft pranë vlerës së dëshiruar dhe nuk kemi indicie të mjaftueshme për praninë e autokorrelacionit.

Figure 31: Grafiku i vlerave aktuale, vlerave të vlerësuara dhe mbetjeve të regresionit



Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm pasqyron vlerat aktuale të EX/IM, vlerat e vlerësuara nëpërmjet regresionit si edhe mbetjet e regresionit si diferencë e vlerave aktuale me vlerat e vlerësuara. Në tërësi shohim se vlerat e vlerësuara ndjekin vlerat reale megjithatë kemi raste kur vlerat e mbetjeve bëhen të rëndësishme si në disa tremujor në vitet: 2003-2005, 2007, 2011 dhe 2015.

Për të testuar lidhjen afatgjatë të variablave me deficitin tregtar është aplikuar testi i Bound. Rezultatet e testit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

ARDL Bounds Test

Date: 07/12/16 Time: 13:21

Sample: 2003Q2 2015Q4

Included observations: 51

Null Hypothesis: No long-run relationships exist

Test Statistic	Value	k
F-statistic	7.019770	9

Critical Value Bounds

Significance	I0 Bound	I1 Bound
10%	1.88	2.99
5%	2.14	3.3
2.5%	2.37	3.6

1%	2.65	3.97
----	------	------

Tabela pasqyron statistikën e vlerësuar F të testit Bound, numrin e variablae për të cilat është vlerësuar lidhja afatgjatë dhe vlerat kritike në rendin 0 dhe 1 për çdo nivel rëndësie statistikore.

Shohim se statistika e vlerësuar në rastin tonë është 7.019 dhe është më e madhe se të gjitha vlerat kritike për IO dhe I1. Pra hipoteza zero që teston se nuk ka lidhje afatgjatë midis variablae bie poshtë në favor të hipotezës alternative e cila përfshin ekzistencën e lidhjes afatgjatë midis variablae. Në testin e mëposhtëm të kointegrimit është vlerësuar lidhja afatgjatë e variablae dhe rëndësia statistikore e tyre.

ARDL Cointegrating And Long Run Form

Dependent Variable: EX_IM

Selected Model: ARDL(1, 0, 1, 0, 0, 1, 1, 0, 1, 0)

Date: 07/13/16 Time: 17:28

Sample: 2003Q1 2015Q4

Included observations: 51

Cointegrating Form				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(REER)	-0.004695	0.002953	-1.590098	0.1206
D(RPBB_)	0.000797	0.001974	0.403644	0.6889
D(RPBBPT_)	0.011178	0.003807	2.936369	0.0058
D(IHD_PBB)	-0.003188	0.002069	-1.540650	0.1321
D(TRPR_PBB)	0.012344	0.002708	4.557975	0.0001
D(C_PBB)	-0.002491	0.001757	-1.417712	0.1649
D(D_SBUXHET_PBB)	-0.001833	0.002642	-0.693832	0.4922
D(G_PBB)	-0.005211	0.007610	-0.684831	0.4978
D(INF_CPI_)	0.001153	0.002656	0.434072	0.6668
CointEq(-1)	-1.181919	0.140354	-8.420998	0.0000

Cointeq = EX_IM - (-0.0040*REER -0.0022*RPBB_ + 0.0095*RPBBPT_
-0.0027*IHD_PBB + 0.0043*TRPR_PBB -0.0066*C_PBB -0.0016
*D_SBUXHET_PBB -0.0112*G_PBB + 0.0010*INF_CPI_ + 1.7176)

Long Run Coefficients				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
REER	-0.003973	0.002482	-1.600543	0.1182
RPBB_	-0.002245	0.002369	-0.947545	0.3497
RPBBPT_	0.009458	0.003254	2.906350	0.0062
IHD_PBB	-0.002697	0.001802	-1.496793	0.1432
TRPR_PBB	0.004307	0.002776	1.551662	0.1295
C_PBB	-0.006585	0.001557	-4.228785	0.0002
D_SBUXHET_PBB	-0.001551	0.002251	-0.688805	0.4954


G_PBB	-0.011181	0.007147	-1.564379	0.1265
INF__CPI__	0.000975	0.002248	0.433834	0.6670
C	1.717591	0.326211	5.265280	0.0000

Tabela e mësipërme pasqyron formën e kointegrimit dhe lidhjen afatgjatë të variablave me EX/IM. Shohim se në periudhën afatshkurtër rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare si edhe transfertat private kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm. Në periudhën afatgjatë të vlerësuar nga ekuacioni i kointegrimit, e cila specifikon një ndikim statistikisht të rëndësishëm janë rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare dhe konsumi si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto.

Ekuacioni i kointegrimit ka një vlerë të statistikës $t=-8.4$ dhe rëndësi statistikore $0.000 < 0.05$.

Në periudhën afatgjatë vetëm rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare dhe konsumi familjar janë përcaktues të rëndësishëm të bilancit tregtar të Maqedonisë.

Figure 32: Grafiku i mbetjeve të regresionit



Burimi: Autori

Grafiku i mësipërm pasqyron statistikën e mbetjeve të regresionit. Shohim se testi i Jarque-Bera ka vlerën 4.5 dhe rëndësia statistikore e saj $0.1 > 0.05$. Pra hipoteza zero e cila teston normalitetin e mbetjeve nuk mund të hidhet poshtë. Në këto kushte konkludojmë se mbetjet e regresionit kanë shpërndarje normale dhe parametrat e vlerësuar nuk janë mbivlerësuar.

Testi i autokorrelacionit

Ashtu edhe si vepruam në modelin e parë do të përdorim testin LM të Breusch-Godfrey për të testuar autokorrelacionin në mbetjet e regresionit.

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	2.163249	Prob. F(2,34)	0.1305
Obs*R-squared	5.757150	Prob. Chi-Square(2)	0.0562

Vlera e Obs*R-katror është 5.75 dhe probabiliteti i saj është $0.0562 > 0.05$. Nuk kemi evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë hipotezën sero e cila teston se mbetjet nuk janë të korreluara.

Testi i heteroskedasticitetit

Heteroskedasticiteti është testuar duke përdorur testin Breusch-Pagan-Godfrey. Rezultatet e testit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	1.517422	Prob. F(14,36)	0.1544
Obs*R-squared	18.92672	Prob. Chi-Square(14)	0.1678
Scaled explained SS	15.11037	Prob. Chi-Square(14)	0.3707

Vlera e Obs*R-katror është 18.92 dhe probabiliteti i saj është $0.16 > 0.05$. Hipoteza zero që teston se mbetjet janë homoskedastike nuk mund të hidhet poshtë. Pra, konkludojmë se variancë e mbetjeve është konstante për çdo vlerësim të secilës periudhë kohore.

Testi i stabilitetit

Për vlerësimin e stabilitetit të modelit kemi përdorur testin Ramsey Reset. Rezultatet e testit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Ramsey RESET Test

Equation: UNTITLED

Specification: EX_IM EX_IM(-1) REER RPBB_ RPBB_(-1) RPBBPT_ IHD_PBB TRPR_PBB TRPR_PBB(-1) C_PBB C_PBB(-1) D_SBUXHET_PBB G_PBB G_PBB(-1) INF__CPI_C

Omitted Variables: Squares of fitted values

	Value	df	Probability
t-statistic	0.731374	35	0.4694
F-statistic	0.534909	(1, 35)	0.4694

F-test summary:

	Sum of Sq.	df	Mean Squares
Test SSR	0.000831	1	0.000831
Restricted SSR	0.055234	36	0.001534
Unrestricted SSR	0.054402	35	0.001554

Testi ka të vlerësuar statistikën $F=0.53$ dhe probabilitet $0.46>0.05$. Hipoteza zero e cila teston stabilitetin e regresionit nuk mund të hidhet poshtë. Pra, modeli jonë është stabil.

Referuar të gjitha testeve statistikore të mësipërme mund të pranojmë për interpretim të vlerësuesve të regresionit duke mos bërë gabim në vlerësimin e parametrave.

5.4 Përmbledhje e gjetjeve empirike

Në vijim është prezantuar në mënyrë të përmbledhur në tabelë rezultatet e të dy modeleve ekonometrik të mësipërm.

Table 8: Përmbledhje e vlerësimit të koeficientëve, rëndësisë statistikore dhe shenjës së tyre

Nr	Koefiçenti	Modeli 1				Modeli 2				Shenja
		ASH		AGJ		ASH		AGJ		
		β	p-value	β	p-value	β	p-value	β	p-value	
1	β_{REER}	-0.006	0.0518	-0.005	0.0477	-0.005	0.12	-0.004	0.118	-
2	$\beta_{RPBB\%}$	-0.0002	0.937	-0.003	0.1551	0.0008	0.6889	-0.002	0.349	-/+
3	$\beta_{RPBBPT\%}$	0.0105	0.0195	0.0078	0.0159	0.011	0.0058	0.009	0.006	+
4	$\beta_{IHD\%PBB}$	-0.0024	0.3232	-0.002	0.3238	-0.003	0.13	-0.003	0.14	-
5	$\beta_{REM\%PBB}$	0.1128	0.0348	0.0833	0.047					+
6	$\beta_{TRPR\%PBB}$					0.012	0.0001	0.0043	0.129	+
7	$\beta_{C\%PBB}$	-0.0029	0.227	-0.009	0.0002	-0.003	0.1649	-0.007	0.0002	-
8	$\beta_{G\%PBB}$	-0.0164	0.036	-0.012	0.0292	-0.005	0.49	0.0112	0.126	-/+
9	$\beta_{D/SBUXHET\%PBB}$	0.0016	0.57	-0.004	0.2	-0.002	0.4922	-0.002	0.495	-/+
10	$\beta_{INF\%PBB}$	0.0019	0.54	0.0014	0.535	0.0011	0.66	0.001	0.66	+

Burimi: Autori

Nga tabela e mësipërme shohim se vlerësuesit për REER-in kanë qenë negativ në të dy modelet por vetëm në modelin e parë në periudhën afatgjatë, efekti është vlerësuar si statistikisht i rëndësishëm.

Shenja e rritjes ekonomike të vendit ka ndryshuar nga një model në tjetrin për periudhën afatshkurtër por në të dy modelet është negative në periudhën afatgjatë. Në asnjë rast rritja ekonomike e vendit nuk ka pasur vlerësim statistikisht të rëndësishëm në efektin e saj ndaj bilancit tregtar.

Rritja ekonomike e vendeve partnere tregtare ka pasur ndikim pozitiv në bilancin tregtar të vendit si në periudhën afatshkurtër dhe në atë afatgjatë kjo e vlerësuar me të dy modelet. Rritja e prodhimit të brendshëm bruto për vendet partnere tregtare sjell përmirësim të raportit të mbulimit të importeve me 0.01.

Investimet e huaja direkte kanë pasur ndikim negativ në bilancin tregtar por efekti i tyre nuk ka qenë statistikisht i rëndësishëm. Investimet e huaja direkte nuk kanë qenë me intensitet të lartë teknologjik dhe kryesisht janë shoqëruar me rritje të importeve për shkak të tregjeve të reja të zbuluara nga kompanitë që kryejnë investimet dhe se një pjesë e importeve fasone shkon për konsumin e tregjeve të brendshme.

Remitancat kanë ndikim pozitiv në bilancin tregtar kur kontrollohet për nivelin e konsumit. Përkatesisht pjesa e remitancave që nuk shkon për konsum mund të investohet dhe krijimin e ekonomive të vogla që sjellin rrije të produkteve për eksport. E njëjta vlen edhe për transfertat private por këto të fundit janë të rëndësishme në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar në periudhën afatshkurtër.

Konsumi familjar ka ndikim negativ, statistikisht të rëndësishëm në periudhën afatgjatë por jo në periudhën afatshkurtër. Shenja e ndryshores është vlerësuar negativ në të gjitha rastet.

Shpenzimet qeveritare kanë pasur shenja të ndryshme për periudhën afatgjatë në dy modelet por në periudhën afatshkurtër shenja e tyre është negative. Shpenzimet qeveritare janë vlerësuar se kanë ndikim negativ të rëndësishëm në modelin e parë që përfshin remitancat si regresant.

Defiçiti/Sufiçiti buxhetor është vlerësuar me shenja të ndryshme në periudhën afatshkurtër por në periudhën afatgjatë shenjat e të dy regresioneve për këtë ndryshore janë negative, pra fenomeni i defiçitëve binjakë. Ndikimi i ndryshores nuk është statistikisht i rëndësishëm.

Niveli i inflacionit ka një vlerësim pozitiv ndryshe nga teoria si në periudhën afatshkurtër edhe në atë afatgjatë, megjithëse efekti i tij nuk është statistikisht i rëndësishëm.

Kapitulli 6: Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

Qëllimi i këtij studimi ishte së pari, të evidentonim nivelin e bilancit tregtar të Maqedonisë si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto, trendin kohorë të nivelit të eksporteve dhe importeve, strukturën e importeve dhe eksporteve dhe vendet partnere tregtare. Së dyti të vlerësonim përcaktuesit e bilancit tregtar në këndvështrimin makroekonomik.

